



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 52 regjistër (JR)  
Datë 07.11.2023

Nr. 44 i vendimit  
Datë 25.09.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e mërkurë, më datë 25.09.2024, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në datat 16.09.2024, 23.09.2024, dhe 25.09.2024, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, të paraqitura në ankim, parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa, shqyrtoi

prapësimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjo gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Saimir Hysa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.
2. Mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, hartuar nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionin të klasifikuar, aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), për kriterin e kontrollit të figurës, sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave ka rezultuar si vijon.
  - 2.1. ILDKPKI-ja, në raportin e hollësishëm e të arsyetuar të dërguar në Komision, ka konstatuar: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave<sup>1</sup>.
  - 2.2. AKSIK-u ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo elemente që cenojnë figurën e tij, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka konstatuar përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit<sup>2</sup>.
  - 2.3. KLP-ja, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe e ka dërguar në Komision një raport të hollësishëm<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.11.2018, ka dërguar “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Saimir Hysa”.

<sup>2</sup> Raporti i AKSIK-ut nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin e KDZh-së nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2022.

<sup>3</sup> Raporti i KLP-së, “Për analizimin e aftësive profesionale të prokurorit Saimir Hysa”, nr. {\*\*\*} prot., datë 27.04.2003, është bazuar në gjetje nga burimet e informacionit: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 4 dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitura prej subjektit; (iii) 5 dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) dokumentacionit arkivor pranë sektorit të protokoll-arkivës në Prokurorinë e Përgjithshme, të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

2.4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vëzhguesi ndërkombëtar i ka përcjellë Komisionit dy gjetje: (i) me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.6.2023; (ii) me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.6.2023, me qëllim vijueshmërinë e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Për këto gjetje, të cilat në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë, Komisioni ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Me vendimin nr. 693, datë 10.08.2023, Komisioni arsyetoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a”, nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi:

1. *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

2. *Transferimin e çështjeve që i korrespondojnë kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2019 dhe procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017 në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

4. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi me arsyetimin e përmbledhur si vijon.

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Saimir Hysa ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.*

## **III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

5. Më datë 31.10.2023, Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), bazuar në rekomandimin për paraqitje ankimi të një grupi prej tre vëzhguesish të Operacionit

Ndërkombëtar të Monitorimit<sup>4</sup>, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Saimir Hysa<sup>5</sup>.

6. Referuar ankimit, Komisioneri Publik çmon se vendimi nr. 693, datë 10.08.2023, i Komisionit, është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik, mbështetur në rekomandimin për ankim, ka evidentuar dhe parashtruar si çështje për shqyrtim, rrethanat dhe faktet ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me: (i) gjetjet e rezultuara nga dokumentacioni i administruar mbi vlerësimin profesional; (ii) gjetjet në drejtim të burimit të ligjshëm të vlerësimit të pasurive. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.
7. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4, pika 2, nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa.
8. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*A. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

9. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi: (i) gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>6</sup>; (ii) denoncimet e paraqitura dhe dokumentacionin e administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese, çmon se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës për çështjet si vijojnë.

**9.1. Lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë regjistrimi 27.06.2022, të shtetasve F. B. dhe A. P., subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë zvarritjen e hetimit të çështjes, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte identifikimin e përgjegjësive penale eventuale të subjekteve të përfshirë, rrethana që duhen**

---

<sup>4</sup> Shih rekomandimin e ONM-së nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në linkun: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/10/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%ABr-nr.693-dat%C3%ABr-10.8.2023.pdf>.

<sup>5</sup> Vendimi i Komisionit nr. 693, datë 10.08.2023, është njoftuar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në datë 16.10.2023, dhe ankimi ndaj këtij vendimi, i përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2023, është administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2023.

<sup>6</sup> Bazuar në nenin B, pika 3, germa "b" e Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vëzhguesi ndërkombëtar i ka përcjellë Komisionit 2 (dy) gjetje të ONM-së, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin profesional, të cilat përbëjnë provë në kuptim të nenit 10 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vijueshmërinë e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Konkretisht: (i) gjetje me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.6.2023; (ii) gjetje me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2023.

parë edhe në drejtim të standardeve të përcaktuara nga indikatorët e neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji 96/2016”), si një tregues domethënës i aftësisë profesionale dhe organizative, dhe mënyrës se si subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën, në referencë të rrethanave ligjore dhe faktike konkrete.

**9.2. Lidhur me kallëzimin penal të shtetasit K. D.**, subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efektivitet procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara, për të mbledhur provat e nevojshme, përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 74/4 i ligjit nr. 96/2016.

**9.3 Lidhur me denoncimin e shtetasit A. Z.**, gjetjet e rezultuara që lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021 - korrik 2022, duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**9.4 Lidhur me çështjen e aferës {\*\*\*}**, nga dosjet përkatëse të Prokurorisë së Tiranës, të administruara nga ONM-ja, në kuadër të procedimit penal kryesor të nisur, nr. {\*\*\*/2014, konstatohet përfshirja e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*}, në të cilin evidentohen problematika, lidhur me: (i) mosdokumentimin e kryerjes së veprimeve hetimore; (ii) mosspecifikimin për sa kohë e ka pasur nën hetim këtë çështje dhe moslëshimin e urdhrave për zgjatje të afateve të hetimit; (iii) interpretimin në mënyrë të kufizuar të nenit 186/3 të Kodit Penal. Gjetjet e konstatuara lidhur me këtë procedim penal, janë të tilla që nuk duhen transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera të kriterit të aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**9.5 Lidhur me denoncimin e shtetasit F. H.**, rrethanat e dala nga çështja konkrete, ndër të tjera, periudhat pa kryerje të veprimeve hetimore dhe pa nxjerrë akt të motivuar për shtyrjen e hetimit, koha e kryerjes së veprimeve hetimore, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera për vlerësimin e aftësive profesionale, lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore sipas nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016.

**9.6 Lidhur me denoncimin e shtetasit V. M.**, i cili pretendon për zvarritje procedurale dhe shkelje të rëndë të procedurës nga ana e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2019, gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë, janë të tilla që nuk duhet të ishin transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

*B. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

- 10** Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, vëren se mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ekzistojnë krahas gjetjeve në drejtim të burimit të ligjshëm të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, duhen vlerësuar në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke sjellë në pah sa vijon.

**10.1** Lidhur me pasurinë *apartament banimi me sipërfaqe 41 m<sup>2</sup>, i ndodhur në {\*\*\*}, Kavajë*, në gjendjen që janë aktet, veprimet e vëllait të subjektit të rivlerësimit, të mbështetura edhe prej subjektit, paraqesin në mënyrë të pasaktë rrethanat lidhur me këtë pasuri.

**10.2** Lidhur me pasurinë *apartament me sipërfaqe 71,2 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit: (i) për mbulimin me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, nuk ka paraqitur akte për të provuar përfitimin faktik të këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga personi i lidhur, nga punësimi pranë “{\*\*\*}” ShPK, dhe Institutit të Politikave Efektive Publike, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; (ii) lidhur me huanë në shumën 15.000 euro, marrë nga vëllai, nuk ka paraqitur ndonjë akt që të vërtetojë transaksionin e dhënies së kësaj huaje nga vëllai, ka depozituar kontratë huaje të datës 21.11.2011, që daton disa muaj pas kohës kur pretendohet se është dhënë kjo hua, duke ngritur kështu dyshime lidhur me vërtetësinë e këtij transaksioni.

**10.3** Lidhur me pasurinë *automjet, tip “Renault Megane”, me targë {\*\*\*}*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën “vetting”, huanë e marrë nga vëllai i tij, sikundër pretendon gjatë hetimit administrativ; nuk provoi të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni; nuk arriti të dokumentojë transaksionin monetar të pretenduar, duke mbetur në nivel deklarativ, si dhe në rastin e huasë në shumën 15.000 euro, deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament me sip. 72,1 m<sup>2</sup>.

**10.4** Komisioneri Publik, duke konstatuar të dhëna në aktet e administruara në dosje të Komisionit, në të cilat duket se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasur në shqyrtim në vitin 2008, një çështje me shtetasin A. L., vlerëson se mbetet e paqartë situata e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas, administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me të cilën ka lidhur kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2011, për apartamentin me sipërfaqe 71,2 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Tiranë.

## **VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

#### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

**11** Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

#### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

**12** Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

- 13 Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 16.09.2024, 23.09.2024 dhe 25.09.2024.
- 14 Në seancën gjyqësore publike të datës 16.09.2024, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, që do t'i shërbenin hetimit dhe shqyrtimit të plotë të çështjes, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me këtë kërkesë, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të lejojë marrjen e tyre në cilësinë e provës<sup>7</sup>, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar, në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe atë të pasurisë. Këto akte iu nënshtruan debatit gjyqësor, dhe u vlerësuan nga Kolegji në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.
- 15 Në lidhje me denoncimin e shtetasit Sh. N., të depozituar në Kolegj më datë 23.09.2024, duke konfirmuar mbërritjen e këtij denoncimi pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë po në datë 23.09.2024, Komisioneri Publik deklaroi se shkaqet e ankimit dhe provat në dosje janë të mjaftueshme për të dalë në konkluzionet përfundimtare për zgjidhjen e të çështjes, dhe i drejtoi një pyetje sqaruese subjektit të rivlerësimit, nëse është bërë ankim në gjykatë lidhur me procedimin penal të referuar në denoncim. Subjekti i rivlerësimit, të cilit iu vu në dispozicion kopja e denoncimit, deklaroi se vendimi i tij është bazuar në konfirmimin e mjekësisë ligjore dhe parashikimet e ligjit penal, dhe se nuk ka dijeni nëse vendimi është ankimuar, shpjegime të cilat u gjetën të bazuara nga pikëpamja profesionale nga Komisioneri Publik. Në këto rrethana, edhe duke konstatuar që denoncuesi nuk ka identifikuar numrin dhe datën e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, nëse eventualisht ky vendim është bërë ose jo objekt i kontrollit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi se denoncimi i depozituar nga shtetasi Sh. N. nuk sjell fakte dhe rrethana të cilat plotësojnë kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për të legjitimuar nevojën për hetime të mëtejshme.
- 16 Në seancën gjyqësore publike të datës 23.09.2024, në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 31.10.2023, kërkoi nga

---

<sup>7</sup> Subjekti i rivlerësimit paraqiti me parashtrimet: (i) vendim nr. {\*\*\*} regj. them, datë 07.06.2019, i Gjykatës të Shkallës të Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) vendim nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2022, i Gjykatës të Apelit Tiranë; (iii) vendim për mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. {\*\*\*} të 2019; (iv) shkresë njoftim vendimi nr. {\*\*\*} prot., datë 11.04.2019; (v) shkresë nr. {\*\*\*}, datë 22.01.2029, e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë; (vi) informacion për referimin e veprës penale, datë 15.01.2019; (vii) kallëzim për ndjekje penale L. M., datë 17.12.2017; (viii) procesverbal për kallëzimin e krimit, L. M., datë 11.01.2019; (ix) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 31.12.2018, e Departamentit të Policisë Kriminale/Drejtoria Hetimore Qendrore; (x) akte të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2005; (xi) fletë nga procesverbali i dorëzimit të dosjeve; (xii) urdhër nr. {\*\*\*}, datë 21.11.2005, i Prokurorit të Përgjithshëm; (xiii) Akte të kallëzimit nr. {\*\*\*} të vitit 2008; (xiv) Kopje nga regjistri i njoftimit të veprave penale të Prokurorisë Tiranë; (xv) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2024; (xvi) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2024; (xvii) vendim për mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. {\*\*\*}/2019; (xviii) vendim për mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. {\*\*\*}/2022; (xix) ekstrakt historik i "{\*\*\*}" ShPK; (xx) ekstrakt historik i "{\*\*\*}" ShPK; (xxi) vendim për mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. {\*\*\*}/2022.

Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 693, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- 17 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim, qëndrimet e palëve përgjatë procesit gjyqësor, si edhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegji, dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

*B. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

- 18 Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit për *kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë regjistrimi 27.06.2022*, subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë zvarritjen e hetimit të çështjes, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa më poshtë vijon.

**18.1** Bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>8</sup> dhe dokumentacionin e përcjellë prej tij, Komisioni ka hetuar mbi procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë regjistrimi 27.06.2022, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasve F. B. dhe A. P. dhe të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se nuk ka kompetencë në trajtimin e mëtejshëm të çështjes, me arsyetimin si vijon: *[..] Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të dokumentacionit të administruar, vëren se referuar përmbajtjes së kallëzimit të depozituar nga subjekti, të dhënat duken të jenë sipërfaqësore, nuk pasqyrojnë ndonjë të dhënë konkrete për t'i hapur rrugë hetimit të çështjes së kallëzuar. Trupi gjykues e çmon këtë çështje në raport edhe me vendimmarrjen e gjykatës, e cila e ka kthyer atë me qëllim regjistrimin e procedimit dhe vijimin e hetimeve, veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 12.06.2023, por edhe në raport me faktin se vërehet që në vendimin gjyqësor, në ndryshim nga kallëzimi i paraqitur në organin e akuzës, kallëzuesit kanë qartësuar veprën penale për të cilën akuzonin institucionet përkatëse “për neglizhencë dhe shpërdorim detyre”, si dhe kanë deklaruar të dhëna të tjera, më të detajuara, duke prezantuar një situatë të qartë për vendimmarrjen gjyqësore. Në këto kushte, duke vlerësuar faktet dhe rrethanat në harmoni me njëra-tjetrën, ku reciprokisht palët e përfshira, organi i akuzës/subjekti i rivlerësimit dhe gjykata pasqyrojnë vendimmarrje të bazuara në ligj, por edhe duke qenë se*

---

<sup>8</sup> Në gjetjen e administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023, vëzhguesi ndërkombëtar ka konstatuar: “(i) Në cilësinë e prokurorit, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2022, në bazë të kallëzimit penal të shtetasve F. B. dhe A. P. kundër maternitetit “{\*\*\*}”, spitalit pediatrik etj., me pretendimin se nga ana e këtyre institucioneve, janë kryer veprime që përbëjnë veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. (ii) Shkurtimisht, në kallëzimin penal pretendohej se një foshnje e porsalindur ishte infektuar me HIV për shkak të neglizhencës së spitalit e të tjerëve. Subjekti e ka pushuar çështjen pa filluar hetimin, me vendimin e datës 12.07.2022. (iii) Vendimi i subjektit është ankimuar me sukses në gjykatë. Në vendimin e saj, gjykata nënvizoi mangësitë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje dhe urdhërohet fillimi i hetimit. Vendimi u la në fuqi në Apel. (iv) Ky rast duhet të vlerësohet nga Komisioni dhe të përfshihet në rezultatet e hetimit, që subjekti të japë shpjegime për mangësitë e tij profesionale.



*tanimë çështja është ende nën hetim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë në trajtimin e mëtejshëm të saj dhe as nuk mund të shprehet proporcionalisht për penalizim të subjektit në këtë vlerësim, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, referuar vendimit nr. 33, datë 3.11.2021. [...]*

**18.2** Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet në Kolegj, kundërshtoi arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, duke sjellë në pah në mënyrë të përmbledhur si vijon.

(i) Në rrethanat konkrete, të ndryshme nga ato të vendimit të Kolegjit nr. 33(JR), datë 3.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka mbaruar shqyrtimin e kallëzimit të analizuar, në momentin që ai, *pa kryer veprime hetimore*, është shprehur me vendim *për mosfillimin e procedimit*, procedim i cili ndodhet në proces vetëm për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit kanë shfuqizuar vendimin e subjektit, kanë urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme sipas rregullave procedurale, moskryerja e të cilave në vetvete materializon mangësitë profesionale të subjektit.

(ii) Në kallëzim, prindërit e të porsalindurit kanë paraqitur aq informacion sa ata e kanë gjetur të mjaftueshëm, duke bashkëlidhur analizat e tyre të gjakut dhe të fëmijës së infektuar. Aftësia profesionale dhe detyra e prokurorit, ndër të tjera, vlerësohet pikërisht në tregues të tillë, si: aftësia për të drejtuar logjikisht hetimin, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, apo aftësia për të marrë në pyetje.

(iii) Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {\*\*\*} regj. them., datë 3.10.2022, duke passjellë vonesa të mëtejshme procedurale në trajtimin e rastit, sidomos në kushtet kur kemi të bëjmë me pasoja të pakthyeshme të shëndetit të një foshnje e kur, nga ana tjetër, identifikimi i përgjegjësive do të parandalonte ardhjen e pasojave të ngjashme në të ardhmen, gjatë trajtimit spitalor të të porsalindurve.

(iv) Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton përgjegjësinë penale individuale të personit, i cili, me veprimet ose mosveprimet e tij, kreu konkretisht veprën penale, përgjegjësi e cila i takon prokurorit të çështjes dhe organeve të specializuara për ta identifikuar. Pavarësisht se kallëzimi ishte bërë ndaj institucioneve dhe jo ndaj personave përgjegjës të identifikuar si të tillë, ligji nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, në nenin 25 të tij përcakton se: [...] *ndaj personit juridik që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin në hetim dhe të pandehurin [...]*.

(v) Pretendimi i subjektit se: [...] *vendimi i mosfillimit nuk mbyllte mundësinë që fakti të hetohej [...]*, tregon qasjen e tij, në drejtim të të kuptuarit dhe të vlerësimit të pasojave që sjellin veprimet apo mosveprimet e tij, në trajtimin e kallëzimeve penale dhe të drejtave procedurale të palëve.

**18.2.1** Në bisedimet përfundimtare, referuar sa subjekti ka pretenduar në Komision apo gjatë gjykimit në Kolegj, Komisioneri Publik vlerësoi se mbeten të provuara vonesat në hetimin e mëtejshëm, të lidhura me ankimin në Gjykatën e Apelit, në kushtet kur *iteri* i infektimit të foshnjës me HIV, apo pretendimet e kallëzuesve kishin gjetur pasqyrimin në vendimin përkatës nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, rrethanat duhen parë edhe në drejtim të standardeve të përcaktuara nga indikatorët e neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, si një tregues i aftësive profesionale dhe organizative, dhe mënyrës se si subjekti ka përballuar ngarkesën, në kuadër të rrethanave ligjore dhe faktike konkrete.

**18.3** Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrime dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimet e Komisionerit si të pabazuara, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

(i) Nuk është i vërtetë fakti se kallëzuesit kanë kërkuar që prokurori të nisë hetimet sa më shpejt për infektimin e fëmijës së tyre me HIV gjatë trajtimit në strukturat spitalore. Në kallëzim kërkohej që prokuroria të fillojë hetime për faktin *kush e dëmtoi djalin tonë pa nisur akoma jetën*, nuk përmendet fjala HIV e, me sa ka kuptuar, kërkohej fillimi i procedimit penal ndaj maternitetit “{\*\*\*}”, spitalit pediatrik, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për “zvarritje të informacionit dhe moskryerje hetimi në kohë”, “neglizhencë dhe shpërdorim detyre”. Analizat bashkëlidhur kallëzimit kanë qenë të pakuptueshme prej tij për t’u trajtuar si prova.

(ii) Nuk qëndron pretendimi se *kallëzuesit kanë paraqitur aq informacion sa ata e kanë gjetur të mjaftueshëm, duke bashkëlidhur analizat e tyre të gjakut dhe të fëmijës së infektuar*, në një kohë që kanë pasur të gjitha mundësitë të depozitonin kallëzim të plotë, ku më së paku të paraqitej fakti penal, me ndihmën e një mbrojtësi ose duke e bërë kallëzimin pa asnjë shpenzim pranë strukturave përkatëse shtetërore.

(iii) Mosfillimi i procedimit është kompetencë e prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, dhe merret kur konstatohet një nga shkaqet e parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale. Në kallëzim, nuk parashtrrohet asnjë e dhënë konkrete për të motivuar regjistrimin e një procedimi penal, nuk ka asnjë shpjegim se çfarë dëmtimi ka pësuar fëmija i kallëzuesve, në çfarë mënyre ka ndodhur dhe çfarë lidhje kanë institucionet e kallëzuara me atë që ka ndodhur, shkaqe për të cilat ka vendosur mosfillimin e procedimit, duke cilësuar në vendim se: “mungojnë provat apo indiciet e nevojshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm sa i përket pretendimit të kallëzuesve për kryerjen e veprës penale”. Gjykata duhej të vlerësonte nëse me dokumentacionin që kishte në dispozicion subjekti në momentin e marrjes të vendimit, duhej apo jo të fillonte një procedim penal për faktin e kallëzuar, dhe jo të merrte tagra të një gjykate me juridiksion rishikimi, duke marrë në dhomë këshillimi prova shkresore të padepozituara në momentin e bërjes së kallëzimit dhe, për më tepër, duke i cituar dhe në vendim.

(iv) Pretendimi për rrethana të ndryshme të këtij procedimi që ka qenë dhe është në hetim nga vendimi nr. 33/2021 (JR) i Kolegjit, është i padrejtë. Kushtetuta nuk lë shteg për interpretime si të Komisionerit Publik, dispozita është ndaluese dhe e qartë, mjafton që çështja të jetë në shqyrtim dhe nuk mund të përfshihet në procesin e rivlerësimit.

(v) Pretendimi se duke bërë ankim, ka passjellë vonesa të mëtejshme procedurale në trajtimin e rastit, më së pakti është një pasaktësi, pasi e drejta për ankim, në asnjë rast nuk konsiderohet si zvarritje e çështjes apo veprim në dëm të dhënies të drejtësisë, përkundrazi shqyrtimi i çështjes nga disa shkallë të drejtësisë, sjell një vendim më të bazuar në ligj.

(vi) Pretendimi se duhej të ishin filluar hetimet ndaj personave juridikë të kallëzuar, është i pabazuar. Referuar nenit 3 të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, organi procedues nuk mund të fillojë hetime vetëm ndaj personit juridik, pa përcaktuar më parë personat përgjegjës. Në rastet e parashikuara në këtë dispozitë, kur personi që merret i pandehur gëzon një nga tri cilësitë e parashikuara, mund të ushtrohet ndjekje penale ndaj personit juridik.

(vii) Pretendimi se “nxjerrja e përgjegjësive do të parandalonte ardhjen e pasojave të ngjashme në të ardhmen, gjatë trajtimit shëndetësor”, është tërësisht pa asnjë lidhje me rastin konkret, pasi në vendim është shprehur për mungesë të faktit penal në kallëzimin e paraqitur dhe jo për mungesë vullneti nga ana e tij për nxjerrje të përgjegjësive eventuale.

**18.4** Nga aktet e administruara në fashikuj lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë regjistrimi 27.06.2022, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

**18.4.1** Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar fillimisht materiali kallëzues nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2022, në bazë të kallëzimit penal të shtetasve F. B. dhe A. P. Kallëzimi ishte ushtruar kundër maternitetit “{\*\*\*}” dhe Spitalit Pediatrik QSUT për “Neglizhencë dhe shpërdorim detyrë”; Institutit të Shëndetit Publik për “Zvarritje të informacionit dhe moskryerje hetimi në kohë” dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si organi më i lartë përgjegjës për shkelje të rënda dhe dëmtim pacienti nga personeli shëndetësor. Në kallëzim, kallëzuesit shprehen: [...] *kërkojmë nga prokuroria të nisë sa më shpejt hetimet kush e dëmtoi djalin tonë pa nisur akoma jetën [...], dhe kanë paraqitur bashkëlidhur analizat e tyre të gjakut, të kryera nga Instituti i Shëndetit Publik Tiranë/Spektori i Laboratorëve Mikrobiologjikë të Referencës/Laboratori i Imunologjisë (HIV/AIDS/hepatite virale), si dhe analiza në gjuhën gjermane të fëmijës E. B. dhe të A. P.*

**18.4.2** Subjekti i rivlerësimit, më datë 12.07.2022, mbështetur në nenin 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “K.Pr.Penale”) ka marrë vendim “Për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*/2022”, duke arsyetuar, ndër të tjera: [...] *nga të dhënat e paraqitura, nuk rezulton se nga ana e të kallëzuarve të jenë kryer veprime të caktuara të cilat përfshihen në elementet e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe kallëzimi i bërë ka karakter deklarativ, për sa nuk cilësohet asnjë fakt konkret për vasa pretendohet. Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale dhe për kallëzimin e paraqitur duhet të vendoset mosfillimi [...]. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur pranimin e ankimit, si të bazuar në ligj e në prova, shfuqizimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve hetimore sipas rregullave procedurale.*

**18.4.3** Referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {\*\*\*} regj. themeltar, datë 03.11.2002, ndër të tjera, analizohet: [...] *Gjykata vëren se nga aktet e administruara në fashikullin hetimor që i përket materialit kallëzues të regjistruar me nr. {\*\*\*/1022, rezultoi e provuar se prokuroria nuk ka realizuar një hetim paraprak të plotë, të gjithanshëm e objektiv për verifikimin e pretendimeve të palës kërkuese [...] nga ana e akuzës nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe verifikimet e domosdoshme për të arritur në përfundimin nëse hetimi duhet të fillohet apo jo [...] Prokuroria nuk ka zbatuar parimin e ligjshmërisë, nuk ka kryer asnjë verifikim, nuk ka pyetur kallëzuesit, apo persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, duke arritur në përfundimin jo të bazuar në ligj se ekzistojnë kushtet për mosfillimin e një procedimi penal [...] vendimi “Për mosfillimin e procedimit penal” i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i bazuar në ligj edhe për shkak se në rastin objekt shqyrtimi, prokurori nuk ka kryer asnjë verifikim në lidhje me pretendimet e ankuesve, por gjithashtu nuk janë administruar asnjë nga aktet shkresore, akte këto që mund të ishin sqaruese të situatës faktike e ligjore të pretenduar nga ankuesit [...]. Kundër këtij vendimi, ka bërë ankim subjekti*

i rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.01.2022, ka vendosur lënien në fuqi të tij.

**18.4.4** Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit *nuk ka kryer veprime hetimore lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të kallëzuesve, si pasojë e të cilave gjykata ka vendosur kthimin e çështjes dhe regjistrimin e procedimit penal* dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit: (i) të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e konstatimit; (ii) të depozitojë vendimet përkatëse, të organit të akuzës, dhënë prej tij, si dhe vendimet gjyqësore.

**18.4.5** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet për barrën e provës së kaluar prej Komisionit, *paraprakisht* bën me dije se për këtë procedim, të regjistruar më datë 12.06.2023, ende në fazën e hetimit, ka pengesë ligjore sipas nenit E të Kushtetutës dhe qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 33/2021<sup>9</sup>. Në vijim, lidhur me materialin kallëzues, subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime sikundër në Kolegj [shih paragrafin 18.3], e gjithashtu ka pretenduar se për shkak të ngarkesës së punës për vitin 2022<sup>10</sup>, ka qenë tërësisht e pamundur marrja e rolit aktiv nga prokurori apo kryerja e veprimeve verifikuese me iniciativë brenda afatit 15-ditor të përcaktuar në nenin 291/1 të K.Pr.Penale.

**18.5** Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të prapësimeve të tij, se lidhur me hetimin e këtij procedimi penal, ka pengesë ligjore në kuptim të nenit E/2 të Aneksit të Kushtetutës, paraqiti në Kolegj në cilësinë e provës, shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2024, në të cilën, ndër të tjera, referohet se: [...] *Procedimi penal nr. {\*\*\*}, viti 2023, regjistruar për veprën penale “Vjedhja” dhe “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga nenet 134 dhe 96 të K. Penal, pa emër autori të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, vijon të jetë ende në fazë hetimi [...]*<sup>11</sup>.

**18.6** Trupi gjykues i Kolegjit, *së pari* mori në shqyrtim çështjen nëse në rrethanat e faktit, organet e rivlerësimit, Komisioni në dhënien e vendimit, dhe Kolegji në shqyrtimin e ankimit, kanë juridiksion kontrollues mbi vendimmarrjen e subjektit për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2022, në kushtet kur, bazuar në vendimin e gjykatës për prishjen e këtij vendimi, është kryer regjistrimi i procedimit penal për çështjen në fjalë me nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2023, dhe ka vijuar prej subjektit kryerja e veprimeve hetimore të caktuara nga gjykata, por jo vetëm.

---

<sup>9</sup> Nga vendimi nr. 33/2021 i Kolegjit, subjekti citon: “Ndalimi i vlerësimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ka synuar shmangien e paragjykitimit të organeve të rivlerësimit ndaj zgjidhjes së një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit e njëkohësisht dhe shmangien e paragjykitimit të çështjes e dhënies së zgjidhjeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit nën “presionin” apo ndikimin e procesit të rivlerësimit”.

<sup>10</sup> Subjekti ka paraqitur shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, lidhur me ngarkesën e punës për vitet 2019-2020-2022, dhe pasqyron ngarkesën e tij të punës për vitin 2022: “258 vendime mosfillimi, më shumë se një në ditë (258/234 ditë pune), 110 kërkesa për gjykim, 91 vendime pezullimi, 51 kërkesa për pushim çështje, 6 vendime pushimi dhe 4 vendime për shpalljen e moskompetencës; 765 kallëzime/procedime në total [550 kallëzime përmes shortit elektronik dhe manual, dhe 215 procedime penale të mbartura], pjesëmarrja në mbi 500 seanca gjyqësore (gjykim themeli, masa sigurimi, kërkesa penale, ankime ndaj vendimeve të mosfillimit, pushimit apo pezullimit etj.), janë përpiluar konkluzione përfundimtare (gjyqe të përfunduara) për 66 çështje gjyqësore”.

<sup>11</sup> Pas vendimit të gjykatës, procedimi është regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2023.

**18.7** Duke sjellë në vëmendje se në ankim, Komisioneri Publik nuk ka interpretuar normën kushtetuese, por ka vlerësuar në analizë të krahasuar të rrethanave konkrete me rrethanat në vendimin (JR) nr. 33, datë 3.11.2021, trupi gjykues ndan të njëjtin vlerësim për rrethana të ndryshme në rastin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2022, nga ato të vendimit të Kolegjit referuar prej subjektit. Konkretisht, në vendimin (JR) nr. 33, datë 3.11.2021, Kolegji ka mbajtur qëndrim se Komisioni *ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”*, në vlerësim të faktit se kërkesa e subjektit të rivlerësimit/prokurorit për pushimin e çështjes penale ishte në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni. Kolegji ka vlerësuar se kjo situatë faktike pengonte organet e rivlerësimit të merrnin qëndrime mbi aftësitë profesionale të subjektit për një vendimmarrje të caktuar, sa kohë kjo vendimmarrje ishte nën shqyrtimin gjyqësor të një gjykate më të lartë, e cila mund të kthente çështjen për hetime të mëtejshme tek i njëjti prokuror, duke ndjekur në këtë logjikë interpretimin qëllimor të kufizimit të sipërcituar, i cili synon të garantojë mosndërhyrjen e institucioneve të rivlerësimit në çështje që janë në shqyrtim e sipër, dhe ruajtjen e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor. Në rastin konkret, si edhe në raste të tjera të ngjashme, trupi gjykues konstaton se vendimi i mosfillimit të prokurorit, i cili është objekt analize në kuadër të kriterit të aftësive profesionale mbi ankimin e Komisionerit Publik, i është nënshtruar kontrollit gjyqësor, i cili ka disponuar për prishjen e tij dhe hetimi penal që zhvillohet ndërkohë, lidhet me veprime hetimore në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të tyre, ndërsa objekt vlerësimi në këtë proces, mbetet veprimtaria e subjektit deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit, veprimtari e cila nuk mund të afektohet tashmë nga asnjë qëndrim potencial i trupit gjykues, meqenëse kontrolli gjyqësor mbi këtë vendim ka përfunduar në mënyrë përfundimtare. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se kjo çështje duhet të shtrihet nën efektin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është i pambështetur në ligj si pasojë e një leximi të ngushtë të dispozitës, si edhe në një thirrje jorelevante për zbatim të jurisprudencës së Kolegjit.

**18.8** Në vijim, trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit të lidhura më këtë kallëzim, në drejtim të aftësive profesionale dhe organizative të subjektit të rivlerësimit, parë në drejtim të indikatorëve të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, sikundër pretenduar prej Komisionerit Publik, si më poshtë.

**18.8.1** Trupi gjykues konstaton se pavarësisht mungesës së informacionit të plotë për rrethanat e faktit penal të pretenduar në aktin e kallëzimit të paraqitur prej shtetasve F. B. e A. P. dhe dokumentacionit bashkëlidhur atij, ekzistonin mjaftueshëm të dhëna që duheshin vlerësuar nëpërmjet një qasjeje proaktive, konsideruar edhe sensitivitetin e rastit. Konkretisht, në analizat e gjakut të kallëzuesve, që ata ia kanë bashkëlidhur kallëzimit, evidentohet lloji i analizës *HIV 1+2 Ag/AB, rezultati negativ* e, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit në Kolegji, se: *nuk mund t'i lexojë këto analiza; në Komision, se: nga kallëzuesit nuk ishte dhënë asnjë sqarim se për çfarë ish-in kryer këto analiza, nuk duken të bazuara. Paraqitja me kallëzimin e analizave të tyre dhe të fëmijës E. B., ku termi HIV shquhet qartë, duket të jetë çmuar prej kallëzuesve si një indikator për referimin e faktit për të cilin po ushtronin ankim. Kjo e dhënë, në kontekst të shprehjes së përdorur prej kallëzuesve në kallëzim, për shkelje të rënda dhe dëmtim pacienti nga personeli shëndetësor, duhej të ishte vlerësuar prej subjektit, pavarësisht se kallëzimi nuk ishte i plotë.*

**18.8.2** Prapësimi i subjektit se ai nuk mund të kryente veprime me iniciativë, për shkak të ngarkesës së lartë në punë, u konsiderua nga trupi gjykues se nuk justifikon mangësitë e shfaqura në drejtim të aftësive organizative, sipas nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016<sup>12</sup>. Trupi gjykues vlerëson se ngarkesa në punë, e cila duket një rrethanë evidente në rastin konkret, nuk mund të justifikojë cenimin e të drejtave të individëve dhe as të afektojë në mënyrë cilësore veprimtarinë e prokurorit, në të kundërt, ai do të duket se nuk i ushtron efektshëm funksionet e tij, në kuptim të dispozitës së mësipërme. Për më tepër, në kuadër të të dhënave që rezultojnë nga kallëzimi, subjekti mund të kishte kryer disa veprime verifikuese për të kuptuar natyrën e faktit të pretenduar se përbënte fakt penal dhe personat përgjegjës sipas këndvështrimit të kallëzuesve. Në vendimin unifikues nr. 2 datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës të Lartë theksohet se: *Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Veprimet verifikuese duhen kryer në drejtim të verifikimit të shkaqeve të mosfillimit, por jo të hetimit me themel të ekzistencës të faktit penal dhe të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë.* Në kontekst të këtij qëndrimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara rreth natyrës së veprimeve që mund të kryhen përpara se të vendoset për regjistrimin ose mosfillimin e një procedimi penal, pyetja e kallëzuesve me qëllim sqarimin e rrethanave të faktit, do të ishte një hap që do të mundësonte marrjen e një vendimi më të drejtë në këtë fazë paraprocedurale. Për sa më sipër analizuar, mënyra si kallëzuesit kanë ndërtuar kallëzimin, për shkak të mungesës së njohurive ligjore të tyre apo edhe ngarkesës psikologjike të shkaktuar nga ngjarja e cila ka dëmtuar shëndetin e fëmijës së tyre, nuk mund të përbëjë shkak për t'u atribuar atyre mosfillimin e procedimit penal, duke i bërë të pabazuara pretendimet e subjektit, pasqyruar dhe në vendimmarrjen e tij, se: “mungojnë provat apo indiciet e nevojshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm sa i përket pretendimit të kallëzuesve për kryerjen e veprës penale”.

**18.8.3** Trupi gjykues e gjeti të pabazë edhe prapësimin e subjektit se vendimi i gjykatës që ka prishur vendimin e tij të mosfillimit të procedimit, është marrë në kundërshtim me arsyetimin dhe përshkrimin që bën vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr. 2/2013, sipas të cilit gjykata që shqyrton ankimin për vendimin e mosfillimit, vendos mbi aktet që ka pasur në dispozicion edhe prokurori, ndërsa në rastin konkret dukshëm gjykata ka administruar akte të tjera, që provojnë pretendimet e ankuesve/kallëzuesve për pabazueshmërinë e mosfillimit të vendimit. Trupi gjykues konstaton se referimi që subjekti bën tek arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara në vendimin e sipërcituar, duket se nuk është i saktë përderisa me ndryshimet që ka pësuar K.Pr.Penale me ligjin nr. 37/2017, pra pas dhënies së vendimit unifikues dhe specifikimeve që janë bërë në dispozitat përkatëse që rregullojnë edhe shqyrtimin e ankimeve të mosfillimit, duket se në këndvështrim të nenit 291, pika 3 e Kodit<sup>13</sup>, për gjykatën që shqyrton

---

<sup>12</sup> Ligji nr. 96/2016, në nenin 74, të titulluar “Aftësitë organizative”, në pikën 1 parashikon: “1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative, vlerësohet aftësia e magistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit”.

<sup>13</sup> K.Pr.Penale, në nenin 291, të titulluar “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, në pikën 3, parashikon: “3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30

një ankim të tillë, përcakton që e drejta e saj për të vendosur në këto raste, mund të mbështetet mbi aktet e paraqitura para saj, pa kufizuar se ato duhet t'i përkasin detyrimisht edhe fazës para marrjes së vendimit objekt ankimi. Në këtë kontekst, duket se gjykata ka administruar akte shtesë, të cilat e kanë shtyrë drejt një vendimmarrje të ndryshme nga ajo e prokurorit, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të mëtejshme dhe duke konfirmuar në këtë mënyrë edhe argumentin që nëse këto veprime do të kryheshin prej vetë subjektit, edhe qëndrimi i tij rreth procedimit, me shumë gjasa, do të kishte qenë i ndryshëm.

**18.9** Trupi gjykues vlerëson se paraqitja prej subjektit e ankimit ndaj vendimit të gjykatës që prishi vendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal, nuk përbën një sjellje të gabuar procedurale, përderisa mjeti i përdorur parashikohet nga ligji dhe mbështetet në interpretimin dhe logjikën e magjistratit. Në kushtet që në fashikujt e Komisionit, nuk rezultojnë të administruar ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, mbeten të paqarta shkaqet për të cilat subjekti i rivlerësimit ka vendosur të ushtrojë ankim. Në parashtrime dhe në seancë gjyqësore, subjekti ka prapësuar se, në shkellje të nenit 291 të K.Pr.Penale, gjykata ka vlerësuar jo në bazë të akteve që përmbante fashikulli i procedimit penal, por duke marrë në dhomë këshillimi prova shpresore të padepozituara me kallëzimin, të cilat kanë qartësuar se çfarë konkretisht kishte ndodhur, situatë faktike që mund të ketë nxitur veprimin e subjektit për paraqitje ankimi, për sa deklaroi: *ligji më jep të drejtën e ankimit, të cilën e kam ushtruar sepse kam qenë dhe jam i bindur se vendimi i gjykatës ishte i gabuar*. Për rrjedhojë, referuar në parashikimin e nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016: “Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”, pretendimi i Komisionerit Publik që e analizon ankimin e subjektit jo në kontekst të të drejtave të tij procedurale si palë në proces, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar. Në vlerësimin e trupit gjykues, vetëm ushtrimi i një të drejte procedurale ndaj vendimit të gjykatës, i pashoqëruar me elemente të tjera që do të provonin keqdashje apo qëllim të ndryshëm nga ushtrimi i funksioneve prej subjektit, nuk mjafton për të gjykuar si të gabuar paraqitjen e ankimit, për sa kohë që, sipas vlerësimit të subjektit/magjistratit, rrethanat konkrete të rastit diktonin paraqitjen e tij.

**18.10** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti duhej të kishte kryer verifikime në kuadër të vlerësimit të kallëzimit objekt analize, edhe për shkak të faktit se në të dukej se adresohet përgjegjësia penale te personat juridikë, pasi vlerësoi edhe prapësimin e subjektit se përgjegjësia e personit juridik nuk mund të adresohet në mënyrë hipotetike, pa u atribuar përgjegjësia e një individi të caktuar brenda tij që ushtron funksionet që ligji nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, ka përcaktuar, trupi gjykues arriti në konkluzionin se edhe ky pretendim i Komisionerit Publik duhet trajtuar në kuadër të mangësive të konstatuara drejt mungesës së kryerjes së veprimeve verifikuese për rastin. Edhe nga ky këndvështrim, ndonëse në kallëzimin e paraqitur nuk pasqyrohet asnjë e dhënë për ndonjë prej individëve të cilët pretendohet se kishin kryer veprimeve të kundërligjshme që bënin përgjegjës personin juridik pranë të cilit ata ushtronin detyrën, përmendja e disa institucioneve shtetërore që mendohej se kishin trajtuar rastin në drejtime të ndryshme,

---

*ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura”.*

kërkonte edhe në këtë rast, marrjen e informacionit rreth ngjarjes apo fakteve të ndodhura, për të gjykuar më pas edhe sjelljen e individëve të caktuar që mund të krijonin përgjegjësi për personin juridik brenda të cilit ata ushtronin veprimtarinë. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se kjo veprimtari e munguar e subjektit, përfshihet në mangësitë e konstatuara për kryerjen e veprimtarisë së nevojshme për vlerësimin e materialit kallëzues në këtë rast.

**18.11** Trupi gjykues, në vlerësimin e aftësive profesionale, e vlerësoi pa peshë qëndrimin e subjektit se vendimi i mosfillimit të procedimit nuk kishte cenuar në mënyrë përfundimtare të drejtën e kallëzuesve për përcaktimin e përgjegjësisë së autorëve. Kjo qasje e tij nuk vlerësohet se ka afektuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe as ka prekur të drejtat e kallëzuesve, por duket si një vijë mbrojtjeje e vendimmarrjes së tij, duke tentuar të relativizojë peshën e përgjegjësisë së këtij vendimi.

**18.12** Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shkaqet e ngritura në ankim qëndrojnë sa u përket mangësive të shfaqura nga subjekti i rivlerësimit në aftësinë e tij ligjore, sipas parashikimit të nenit 73, pika 1 e ligjit 96/2016, përderisa ka dështuar në këtë rast të ndërmarrë veprimet e nevojshme verifikuese përpara se të konkludonte se nuk ekzistojnë rrethanat për regjistrimin e procedimit penal sipas parashikimit të nenit 291 të K.Pr.Penale, konfirmuar kjo edhe në mënyrë përfundimtare nga kontrolli gjyqësor.

- 19** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit në rastin e *kallëzimit penal të shtetasit K. D.*, subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efektivitet procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara, për të mbledhur provat e nevojshme, përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi sa më poshtë.

**19.1** Nga dokumentacioni i administruar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ<sup>14</sup>, ka rezultuar se më datë 08.03.2021, shtetasi K. D. ka paraqitur një kallëzim penal kundër subjektit të rivlerësimit dhe disa shtetasve të tjerë në Prokurorinë e Përgjithshme. Kallëzuesi ka pretenduar se i është vjedhur prona që shtetasja S. K. i kishte shitur atij në vitin 1995, duke u rishitur dhe regjistruar në ZVRPP, nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme të të kallëzuarve, mashtrimit, përdorimit të dokumenteve të falsifikuara dhe shpërdorimit të detyrës. Duke referuar procedimin penal nr. {\*\*\*}/2008, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, kallëzuesi ka pretenduar se ai ka shpërdoruar detyrën pasi ka vendosur pushimin e çështjes pa kryer hetime të plota, por pa prezantuar veprimet apo mosveprimet konkrete të subjektit, si dhe ka pretenduar se dosja që i përket këtij procedimi penal, është zhdukur. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dalë në përfundimin se: [...] *nuk rezulton që shtetasit e kallëzuar të kenë kryer ndonjë veprim në mospërmbyllje të rregullt të detyrës, si prokuror dhe gjyqtar [...]*, dhe në datën 1.04.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të paraqitur nga shtetasi K. D. Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ fillestar për këtë

---

<sup>14</sup> Nga korrespondenca e Komisionit me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.01.2023, ka rezultuar se ndaj subjektit të rivlerësimit ka pasur material kallëzues nga shtetasi K. D. Ky material është dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për vlerësim se cilat nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm do të jetë kompetente për trajtimin e tij. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kallëzimin e shtetasit K. D., për vlerësim.



çështje, të trajtuar edhe në raportin profesional në kuadër të kallëzimit të shtetasit K. D. për “Shpërdorim detyre”, ka çmuar se nuk evidentohen problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**19.1.1** Në vijim, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar<sup>15</sup> dhe kërkesës që: [...] *Komisioni duhet të hetojë nëse subjekti ka respektuar dhe vepruar në përputhje me dispozitat procedurale penale gjatë trajtimit/hetimit të çështjes siç pretendon z. D. dhe të konsiderojë kryerjen e një analize të thellë të mangësive të treguara nga subjekti në kriterin e aftësive profesionale [...]*, Komisioni ka administruar kopje të fashikullit penal dhe ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime dhe të dokumentojë lidhur me konstatimet paraprake respektivisht: (i) zhvillimin e hetimit në tejkallim të afatit ligjor të përcaktuar në K.Pr.Penale; (ii) nëse ka disponuar me urdhërime/vendime për shtyrje të afatit të hetimit pas datës 18.12.2008; (iii) kishte paqartësi nëse ish-in kryer veprime të tjera hetimore pas datës 18.01.2009, në raport me kohën e gjatë deri në marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal shtator 2009; (iv) dukej tepër i vonuar në kohë njoftimi i vendimit të pushimit të hetimit, në mars 2010, ndërsa çështja ishte pushuar në shtator 2009; (v) nuk kishte të dhëna nëse është ankimmuar vendimi i pushimit të procedimit penal, dhënë nga subjekti, dhe nëse po, çfarë ka ndodhur me rastin; (vi) si dhe lidhur me pretendimet e z. D. për njoftimin e vonuar të vendimit të pushimit, si dhe për përgjigjen e dhënë për humbjen e dosjes. Në analizë të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit, duke i vlerësuar ato të plota, Komisioni ka konkluduar se nuk konstaton ndonjë problematikë që mund të ndikojë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

**19.2** Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet në dosje, duke sjellë në pah, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

(i) Referuar akteve në dosje të Komisionit, duket se gjejnë mbështetje pretendimet e z. K. D. se nuk është njoftuar për ecurinë e procedurave hetimore, që filluan në shtator 2008 dhe u përfunduan me aktin e marrjes së njoftimit, në mars të vitit 2010. Akti i vetëm me të cilin subjekti i rivlerësimit i është drejtuar z. K. D. gjatë hetimit, është procesverbali i datës 29.09.2008, për marrjen e të dhënave nga ai si kallëzues, si person që ka dijeni për veprën penale, dhe akti tjetër drejtuar z. D., duket se është njoftimi për pushimin e çështjes, datë 17.03.2010.

(ii) Referuar rezultateve të hetimit, duket se subjekti i rivlerësimit, në periudhën janar - korrik 2009 nuk duket se ka ndërmarrë ndonjë veprim hetimor, nga korriku 2009 deri në vendimmarrjen për pushimin e çështjes të datës 1.09.2009, ka përpiluar vetëm dy akte.

(iii) Vendimi nr. {\*\*\*} akti, datë 17.11.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referon faktin se ankimi i z. K. D. ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit, për pushimin e çështjes

---

<sup>15</sup> Në gjetjen nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023, lidhur me këtë rast, vëzhguesi ndërkombëtar shprehet se për momentin, subjektit të rivlerësimit mund t'i kërkohej të japë shpjegime mbi pretendimet dhe prova mbështetëse, duke konstatuar se: “(i) duket, prima facie, se hetimi (nëse ka pasur një të tillë) është zhvilluar për më shumë se 3 muaj, që është afati kohor normal i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale; (ii) nuk është e qartë nëse vendimet e shtyrjes, hetimi gjithëpërfshirës apo njoftimi i palës së dëmtuar/D. janë nxjerrë/kryer gjatë periudhës tetor 2008 - shtator 2009; (iii) njoftimi i pushimit të hetimit, i marsit 2020, duket tepër i vonuar në kohë; (iv) pretendimet për humbjen e dosjes dhe mosinformimin e të dëmtuarit për hapat hetimorë do të mund të vlerësoheshin vetëm në qoftë se administrohej dosja e plotë”.

{\*\*\*}/2008, [...] është paraqitur jashtë afateve procedurale për paraqitjen e kërkesave në gjykatë, pasi ankuesi nuk provoi marrjen në dijeni për këtë vendim me prova shkresore [...]. Kjo pasojë procedurale lidhet ngushtë dhe me dërgimin me vonesë të akteve të njoftimit nga organi i prokurorisë.

(iv) Subjekti i rivlerësimit, në vendimin për pushimin e çështjes, ndër të tjera, ka referuar se pyetja e personit kryesor, shtetasit A. N., që ka qenë i autorizuar më anë të një prokure për kryerjen e kontratave të shitblerjes, ka qenë e pamundur, pasi personi prej shumë vitesh ndodhet jashtë vendit, dhe pamundësia e pyetjes së tij bën të pamundur vërtetimin e faktit. Komisioneri Publik nënvizon se qenia jashtë vendit e një subjekti me status procedural të caktuar, nuk përbën një justifikim ligjor për moshetimin e plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste, gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

**19.2.1** Në përfundim të procesit gjyqësor në Kolegj, pasi dëgjoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe u njoh me provat e paraqitura prej tij, të cilat u administruan në cilësinë e provës, Komisioneri Publik, në bisedimet përfundimtare vlerësoi se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

**19.3** Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrime dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimet e Komisionerit si të pabazuara, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

(i) Pretendimi i shtetasit K. D. se nuk ka marrë njoftim për vendimin e pushimit të procedimit penal, është i pavërtetë; e kundërta provohet me disa akte shkresore. Në dosje gjendet shkresa përcjellëse e nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë, me objekt “Njoftim vendim pushimi” drejtuar K. D. në adresën e dhënë prej tij, me përpilimin e së cilës mbaron detyrimi ligjor i prokurorit për njoftimin e palëve, veprimet e mëtejshme kryhen nga sekretaria e prokurorisë. Referuar kopjes së kësaj shkrese dhe kopjes së librit të protokollit/dorëzimit, ku në numrin {\*\*\*} prot., datë 08.10.2009, figuron i regjistruar njoftimi që i është dërguar K. D., rezulton se shkresa është dërguar dy ditë pas arkivimit të dosjes.

(ii) Mosdeklarimi prej shtetasit K. D. para gjykatës, i datës kur ka marrë njoftim për vendimin e pushimit të procedimit penal, ndërkohë që ka qenë detyrim të dokumentonte kohën e marrjes dijeni, lidhet me faktin se ankimi është bërë prej tij jashtë afatit 10-ditor, shkak për të cilin gjykata nuk ka pranuar të vazhdojë gjykimin dhe ka pushuar çështjen. Vonesa është pakujdesi e vetë shtetasit, pasi në vendimin e gjykatës citohet deklarimi i tij se “*ka marrë dijeni për vendimin e pushimit në muajin tetor 2009*”, në një kohë që ankimi prej tij është bërë më 24.03.2010.

(iii) Hetimi për këtë procedim penal nuk ka zgjatur në periudhën 2008-2010, por nga dita e regjistrimit deri në ditën e marrjes së vendimit për pushimin e tij, 01.10.2008 - 01.09.2009, në total 11 muaj, duke përfshirë dhe një muaj të pushimeve vjetore, një periudhë e arsyeshme hetimi për një çështje që lidhet me krimin ekonomiko-financiar dhe ka nevojë për shumë veprime hetimore. Pauzat ndërmjet veprimeve hetimore vijnë për shkak se prokurori duhet të punojë me të gjitha dosjet njëkohësisht.

(iv) Referuar nenit 324 të K.Pr.Penale, vendimi për të zgjatur afatin e hetimeve lidhet domosdoshmërisht me momentin e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe jo me momentin e regjistrimit të procedimit penal. Prej tij nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave

penale si autor i ndonjë vepre penale, pasi hetimet janë kryer në drejtim të vërtetimit të ekzistencës së veprës penale. Pushimi i çështjes është bërë sipas nenit 328, shkronja “b” e K.Pr.Penale, që parashikon rastin kur fakti nuk parashikohet si vepër penale.

(v) Çështja është pushuar për shkaqe që lidhen me mungesën e elementeve të veprës penale, dhe jo për mospyetjen e shtetasit A. N. Në vendim ka konstatuar se *pyetja e këtij shtetasi nuk është bërë e mundur pasi prej shumë vitesh, ndodhet jashtë shtetit*, dhe jo se ky person nuk mund të hetohej për këtë shkak. Marrja në pyetje dhe hetimi janë koncepte të ndryshme. Vendimi mbështetet në shumë prova shkresore dhe deklarime të gjithë personave të përfshirë në këtë hetim.

**19.4** Në shqyrtim të sa më sipër, nga aktet në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

**19.4.1** Me vendimin e datës 01.09.2009, prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, të regjistruar për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Mashtrimi”, parashikuar nga nenet 186/3 dhe 143/2 të Kodit Penal. Ky procedim ishte regjistruar në bazë të kallëzimit të bërë nga shtetasi K. D. në datën 02.10.2008. Në vendimin e pushimit të procedimit penal, citohet se *me vendimin e datës 31.08.2009, ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2009, i filluar në bazë të kallëzimit të K. D. për të njëjtin fakt*<sup>16</sup>.

**19.4.2** Trupi gjykues evidentoi veprimet hetimore të kryera nga prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit në kuadër të analizës së pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me to, nga ku rezultoi se: (i) më datë 29.9.2008, ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi K. D., si personi që ka dijeni për veprën penale; (ii) në datën 9.10.2008, ka vendosur për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve të ndodhura në ZVRPP dhe zyrën e noteres; (iii) ka urdhëruar oficeren e policisë gjyqësore për kryerje të veprimeve hetimore, të dokumentuar prej saj në procesverbalet përkatëse<sup>17</sup>, e cila, më datë 15.01.2009, ka përpiluar relacionin për

---

<sup>16</sup> Nga aktet në fashikuj, konstatohet se regjistrimi i procedimit penal nr. {\*\*\*} i vitit 2009, për veprat penale “Mashtrim” dhe “Falsifikim i dokumenteve”, është urdhëruar nga një prokuror tjetër për shkak të kthimit nga gjykata të po së njëjtës çështje të regjistruar e vënë në lëvizje nga kallëzuesi K. D. në vitin 2007, për të cilën një prokuror tjetër kishte vendosur mosfillimin e procedimit në datën 19.12.2007.

<sup>17</sup> - Më datë 14.10.2008, OPGj-ja dokumenton në procesverbale marrjen në dorëzim të kopjeve të disa dokumenteve nga shtetasja E. V. (vajza e S. V./shitëses së pasurisë në mënyrë të përsëritur); si dhe marrjen e të dhënave nga shtetasja E. V. si personi që ka dijeni për veprën penale.

- Më datë 16.10.2008, është mbajtur procesverbal nga OPGj-ja në ZVRPP, për këqyrje dhe marrje dokumentacioni.
- Në nëntor 2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal në ZVRPP Tiranë, për të marrë kopje dokumentacioni.
- Më datë 17.11.2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi D., si personi që ka dijeni për veprën penale.
- Më datë 26.11.2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi Q. D., si personi që ka dijeni për veprën penale.
- Më datë 1.12.2008, OPGj-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasja S. V.
- Më datë 12.12.2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për ballafaqimin e shtetasve K. D. dhe Q. D.
- Më datë 15.12.2008, janë këqyrur dhe marrë kopje të dokumentacionit të vlerësuar nga OPGj-ja pranë zyrës noteriale.

përfundimin e hetimeve, duke sugjeruar pushimin e çështjes, pasi fakti nuk parashikohet si veprë penale.

**19.5** Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se për periudhën 15 janar - korrik 2009, për këtë çështje nuk janë kryer veprime hetimore, për rrjedhojë për këtë periudhë kohore e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me mungesën e veprimtarisë hetimore pa një shkak të arsyeshëm. Në kuptim të K.Pr.Penale, nenit 327, “Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit”, që parashikon: “1. Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. 2. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë” – pas dërgimit prej OPGj-së, më datë 15.01.2009, të relacionit për dokumentimin e veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim penal, ku është sugjeruar pushimi i çështjes pasi fakti nuk parashikohet si veprë penale, periudha pothuaj 7-mujore deri më datë 31.08.2009, duket e paarsyeshme për marrjen e një vendimi edhe në kushtet e angazhimit në çështje të tjera, sikundër pretendon subjekti. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik se, për mbylljen e hetimit të kësaj çështjeje, evidentohen mangësi në drejtim të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, si një nga nënindiktorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

**19.6** Lidhur me mosnjohimin e kallëzuesit për ecurinë e procedurave hetimore, mungesës së bashkëpunimit mes tij dhe organit të akuzës përgjatë hetimit të çështjes, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim të gjitha aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ lidhur me këtë çështje penale, nuk konstatoi asnjë dokumentacion që provon përpjekjen e kallëzuesit për marrjen e informacionit për ecurinë e procedimit penal të iniciuar prej tij. Gjithashtu, nuk u konstatua as ndonjë e dhënë që sugjeron për mungesën e dosjes penale që lidhet me këtë procedim, sikundër ka pretenduar kallëzuesi, përkundrazi dokumentacioni i administruar provon të kundërtën, pasi konfirmon drejtpërdrejt ekzistencën e dosjes penale prej nga ai është ekstraktuar. Gjithashtu, nuk rezulton ndonjë dispozitë ligjore e kohës, K.Pr.Penale përpara ndryshimeve, e cila të legjitimonte në mënyrë të posaçme të drejtën e kallëzuesve për marrjen e informacionit për zhvillimin e hetimeve penale mbi kallëzimet e tyre, të drejta të cilat duket se janë ligjëruar posaçërisht për viktimën si subjekt procedural përgjatë procesit penal, pas

- 
- Më datë 18.12.2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për marrje të kopjes së dokumenteve zyrtare nga regjistrat kadastralë, nga shtetasi K., si dhe është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga ky shtetas, me detyrë agronom në Komunën {\*\*\*}, si personi që ka dijeni për veprën penale.
  - Në dhjetor 2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi T., si kryeplak i fshatit {\*\*\*}, si personi që ka dijeni për veprën penale.
  - Në dhjetor 2008, nga OPGj-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga notere V. S. si personi që ka dijeni për veprën penale.
  - Më datë 18.12.2008, OPGj-ja ka urdhëruar paraqitjen e regjistrueses së {\*\*\*} dhe përgjegjësit të zonës kadastrale në Prokurori më datë 23.12.2008.
  - Më datë 09.01.2009, OPGj-ja ka dokumentuar në procesverbal marrjen e të dhënave nga shtetasja E. R., me detyrë topografe pranë {\*\*\*}, shtetasja D. S., me detyrë regjistruese në {\*\*\*}, si persona që kanë dijeni për veprën penale.
  - Më datë 14.01.2009, OPGj-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi B. P., si personi që ka dijeni për veprën penale.

ndryshimeve që pësoi K.Pr.Penale me ligjin nr. 37/2017, pra pasi hetimi i çështjes kishte përfunduar. Në këtë kontekst, pretendimi se kallëzuesi nuk ka pasur informacion për ecurinë e procedurave hetimore, përveçse gjendet i paprovuar të jetë ngritur përgjatë hetimit penal, por gjendet edhe i pabazuar në dispozitat ligjore të kohës. Lidhur me pretendimin se kallëzuesi K. D. nuk është pyetur dhe nuk ka qenë pjesë aktive e hetimit, siç presupozonte të ishte, në analizë të akteve të administruara, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se kallëzuesi ka qenë pjesë e hetimit në datat 29.9.2008 dhe 17.11.2008, sipas procesverbaleve për marrjen e të dhënave prej tij, si personi që ka dijeni për veprën penale, dhe më datë 12.12.2008, sipas procesverbalit për ballafaqimin mes tij dhe shtetasit Q. D. [i vëllai]; *së dyti*, vlerëson se thirrja, pyetja apo çdo lloj ndërveprimi me kallëzuesin në një procedim penal, nuk është një veprimtari e paracaktuar apo e matshme numerikisht, por ajo diktohet nga nevojat e hetimit, të cilat përcaktohen nga prokurori i çështjes, si drejtues i tij. Në rastin konkret, rezulton se kallëzuesi jo vetëm është pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, por ai i është nënshtruar edhe procedurës për marrje së provës me anë të ballafaqimit sipas nevojës që ka rezultuar gjatë hetimit, për shkak të kundërshtive mes thënieve të tij dhe vëllait të tij për faktet objekt hetimi. Në përfundim, kallëzuesi rezulton që është njoftuar me vendimin për pushimin e hetimit, si një moment procedural i paracaktuar nga ligji. Në këtë kontekst, as prej kallëzuesit apo Komisionerit Publik nuk evidentohet ndonjë veprim hetimor në të cilin kallëzuesi duhej të ishte bërë pjesë dhe që nuk është përfshirë për shkak të sjelljes së subjektit si prokuror i çështjes, por as nga analiza e akteve nuk rezulton ndonjë i tillë, që do të ngarkonte subjektin me përgjegjësinë e moskryerjes logjikshëm të hetimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik rreth përfshirjes së kallëzuesit në hetimin e çështjes vetëm me dy akte, procesverbalit të datës 29.09.2008, për marrjen e të dhënave nga ai si kallëzues, si person që ka dijeni për veprën penale, dhe njoftimit për pushimin e çështjes, datë 17.03.2010, qoftë referuar situatës faktike por edhe për shkak të vlerësimit ligjor të pretendimit.

**19.7** Lidhur me pretendimet për njoftimin me vonesë të vendimit të pushimit të procedimit penal, trupi gjykues konstaton se ato nuk gjejnë pasqyrim në aktet e dosjes, përpos që edhe duke abstraguuar këtë konstatim, nuk provohet që vonesa në njoftim të kenë pasur ndikim mbi humbjen e afatit të ankimit ndaj këtij vendimi prej kallëzuesit, e cila duket se ka ndodhur për shkaqe që nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit.

**19.7.1** *Së pari*, trupi gjykues vlerëson të ndalet në parashikimet e ligjit procedural penal të kohës, i cili parashikonte detyrimin e njoftimit menjëherë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, si edhe njoftimin e vendimit nga sekretaria gjyqësore, përmes shërbimit postar<sup>18</sup>. Në këtë kuadër, për kohën kur është hetuar çështja, mbahet në vëmendje edhe fakti se, bazuar në organizimin dhe funksionimin e prokurorisë si një organ i centralizuar dhe

---

<sup>18</sup> Kodi i Procedurës Penale, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit prej subjektit të rivlerësimit, në nenin 291, të titulluar "Vendimi për mosfillimin e procedimit", parashikonte: "1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit"; dhe në nenin 134, të titulluar "Njoftimi i akteve të prokurorit", parashikonte: "1. Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar në format e parashikuara nga neni 133. 2. Dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga ana e sekretarisë, ka vlerën e njoftimit. Dorëzuesi shënon në origjinalin e aktit faktin e dorëzimit dhe datën".

hierarkik, mënyrë funksionimi e materializuar në nenet 24 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por edhe në akte normative të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm<sup>19</sup>, mbi të cilat ushtrohej kontrolli i brendshëm, vendimet e prokurorit i nënshtroreshin kontrollit nga prokurori më i lartë për nevojë të miratimit të tyre dhe, pas kryerjes së kësaj procedure, mund të njoftohej vendimi. Në këndvështrim të sa më sipër, njoftimi i vendimit të prokurorit, përfshinte në procedurë disa struktura, për rrjedhojë vonesa të mundshme apo distanca nga dita e marrjes së vendimit me atë të njoftimit, nuk mund t'i atribuohen vetëm atij.

**19.7.2** *Së dyti*, ndryshe nga sa vlerëson Komisioneri Publik, se *kjo pasojë procedurale lidhet ngushtë dhe me dërgimin me vonesë të akteve të njoftimit nga organi i prokurorisë*, trupi gjykues vlerëson se mosparaqitja prej shtetasit K. D. e shkresës/lajmërimit postar, përmes të cilit i është njoftuar vendimi, në kontekst të detyrimit të tij për të provuar përpara gjykatës respektimin e afatit procedural të paraqitjes së ankimit, është shkaku për mospranimin e ankimit të tij. Në shkresën për njoftimin e vendimit të pushimit, nënshkruar prej drejtuesit të prokurorisë, është shtypshkruar: *datë, ... , shtator 2009*, si një projeksion i subjektit të rivlerësimit/përpiluesit të shkresës për përcjellje të vendimit të pushimit brenda muajit shtator 2009. Referuar kopjes së librit të protokollit/dorëzimit të prokurorisë, paraqitur si provë prej subjektit, figuron i regjistruar njoftimi që i është dërguar K. D. me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2009, që tregon se njoftimi i vendimit është kryer në muajin tetor, diferencë kohore e shpjegueshme me procedurën e përmendur më lart. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka gjykuar ankimin e z. D. me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të këtij procedimi penal, në vendimin e saj, datë 17.11.2010, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, shprehet se: *[...] Nga ana e ankuesit nuk u paraqit ndonjë provë për të provuar se kur ka marrë dijeni për këtë vendim [...]. Ankuesi, duke mos provuar marrjen dijeni për këtë vendim me prova shkresore, e ka paraqitur këtë ankim jashtë afatit ligjor [...].* Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e z. K. D., i cili as nuk ka referuar ndonjë të dhënë konkrete dhe as ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues lidhur me njoftimin e vendimit me vonesë për arsye që lidhen me subjektin e rivlerësimit, mbeten në kuadrin e pretendimeve. Edhe për sa i përket pretendimit se kjo vonesë ka shkaktuar humbjen e afatit të ankimit, trupi gjykues çmon se është i pabazuar, për sa kohë që nëse ankuesi K. D. do të provonte marrjen dijeni me vonesë, por do të provonte gjithashtu se ai ishte në afat në kohën e paraqitjes së ankimit qoftë edhe nga dita e marrjes dijeni, gjykata do të detyrohej të shqyrtonte ankimin e tij sipas përcaktimeve ligjore. Sa më sipër analizuar, nuk rezulton se rrëzimi prej gjykatës i kërkesës së z. K. D., me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2008, të ketë ardhur si pasojë e dërgimit me vonesë të akteve të njoftimit të këtij vendimi.

**19.8** Lidhur me pretendimin se me moskryerjen e pyetjes së shtetasit A. N., subjekti ka treguar mangësi në aftësitë profesionale për hetimin e çështjes, trupi gjykues çmon se, përveçse nuk rezulton që mospyetja e tij të ketë kushtëzuar marrjen e vendimit të pushimit prej subjektit,

---

<sup>19</sup> *Akte të Prokurorit të Përgjithshëm: udhëzimi i datës 08.01.2008 mbi ushtrimin e funksioneve drejtuese në prokuroritë e shkallës së parë, si dhe urdhri nr. 147, datë 09.05.2008, "Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë", i cili në pikën 3 parashikonte që përpara nënshkrimit të shkresave për kalimin e akteve të prokurorit në gjykatë ose te subjektet e tjera të procedimit penal dhe para se të vendoset akrvimi i fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara apo të përfunduara, drejtuesit e prokurorive kanë detyrimin për të kontrolluar bazueshmërinë në ligj të akteve të prokurorit dhe të procedimit penal, dhe marrjen e përgjegjësisë për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët.*

aplikimi i ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare në fushën penale, në rrethanat ligjore dhe faktike të rastit, nuk duket se do t'i shërbente efikasitetit të hetimeve, konsideruar interpretimin dhe logjikën e subjektit mbi të cilën çështja është vlerësuar se ishte e natyrës civile.

**19.8.1** Lidhur me këtë pretendim, ndonëse nuk identifikohet posaçërisht rregulli ligjor i cili nuk është zbatuar prej subjektit, por që mundësonte pyetjen në distancë të këtij shtetasi, trupi gjykues vlerëson se dispozitat që mund të gjenin zbatim në këtë rast, janë ato që lidhen me pyetjen në distancë të shtetasve, të cilat në fazën e hetimit mund të realizohen vetëm nëpërmjet kërkesës për ndihmë juridike ndërkombëtare, në zbatim të dispozitave procedurale penale që rregullojnë atë. Në këtë kuadër, trupi gjykues vlerësoi nëse do të ishte e domosdoshme kryerja e këtij veprimi hetimor për zgjidhjen e procedimit penal, në raport edhe me të gjitha të dhënat e tjera që kishin rezultuar nga hetimi e që janë pasqyruar në vendimin e pushimit. Nga leximi i vendimit të pushimit të marrë prej subjektit, vihet re se janë kryer një sërë veprimesh hetimore të konsideruara të nevojshme për t'i dhënë përgjigje kallëzimit të paraqitur, në përfundim të të cilave subjekti, me cilësinë e prokurorit, ka arritur në konkluzionin se konflikti i shtruar si një fakt penal në kallëzim, ka natyrën e një konflikti civil dhe, si i tillë, do të duhet t'i shtrohet për zgjidhje gjykatës, në bazë të rregullave që normojnë të tilla konflikte. Në thelb të konfliktit, sipas arsytimit të vendimit, por edhe të dhënave që vijnë nga aktet e administruara, është deponimi i një sipërfaqeje toke e cila duket se ka debat lidhur me të drejtën e pronësisë mbi të, nëse i takon kallëzuesit apo vëllait të tij, si edhe veprimet juridike të kryera për shitjen e kësaj pasurie, të cilat diktohen në thelb nga ky debat mbi pronësinë. Në këtë kuadër, vlerësimi i subjektit se kjo çështje ka natyrë civile dhe do të duhej të zgjidhej si e tillë, nuk rezulton të ketë mundësi të ndikohet nga deklaratimet që do të jepte në çdo version shtetasi A. N., i cili është personi që ka realizuar shitjen e parë të pronës të kallëzuesit, nëpërmjet një prokure të dhënë nga pronarja e mëparshme e saj. Në këto kushte, duket se përdorimi i kërimit të provës nëpërmjet letërporosisë, përveç se duket i pamundur sepse për këtë shtetas, përveç se deklarohet që është jashtë Shqipërisë, nuk ka asnjë të dhënë rreth vendbanimit të tij, qoftë edhe shtetit ku ai qëndron, të cilat në çdo rast janë të nevojshme për të lokalizuar personin e përcaktuar zyrën homologe kompetente në të cilën do të kërkohej pyetja e tij nëpërmjet letërporosisë, por mbi të gjitha, vlerësohet se informacioni i marrë nuk do të mund të ndryshonte cilësimin e konfliktit si civil, konkluzion i cili ka përcaktuar zgjidhjen e çështjes.

**19.9** Në përfundim të analizës së shkaqeve që i adresohen kallëzimit të shtetasit K. D., trupi gjykues konkludon se subjekti ka shfaqur vetëm mangësi të natyrës organizative, që lidhen me faktin e regjistrimit me vonesë të procedimit penal, si edhe periudhës janar - shtator 2009, përgjatë së cilës nuk ka kryer veprimtari hetimore dhe as ka konkluduar për zgjidhjen e saj. Këto mangësi që do të mund të afektonin nënindikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, do të vlerësohen për peshën e tyre në analizën e përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të trupit gjykues, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- 20** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura në denoncim nga shtetasit A. Z. *për zvarritje të çështjes penale me nr. {\*\*\*/2020 prej subjektit, pasi në tetë shtator ka qenë i pranishëm vetëm dy herë*, dhe se pretendimet e subjektit nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura prej tij, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi sa më poshtë.

**20.1** Komisioni, pas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me sa pretenduar prej denoncuesit, nuk ka vërejtur ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbënte provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive të tij profesionale. Referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar<sup>20</sup>, me rezultatet e hetimit administrativ shtesë, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit: (i) të sqarojë pozicionin e tij në gjykatë, nëse mungesat ishin të justifikuara, dhe të depozitonte dokumente mbështetëse; (ii) të dokumentojë shpjegimin lidhur me kërkesat e denoncuesit për zëvendësimin e gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes; (iii) të shpjegojë në mënyrë bindëse kohën e gjatë që u nevojiti për të paraqitur kërkesën në gjykatë (korrik 2021 - mars 2022); (iv) të renditë hapat/veprimet hetimore të ndërmarra për hetimin e kësaj çështjeje në përputhje me K.Pr.Penale dhe t'i provojë ato me dokumentacion (urdhra, vendime apo procesverbale).

**20.2** Duke vlerësuar shteruese shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera se procedimi penal është ende në fazën e hetimit paraprak dhe gjen zbatim neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe se pretendimet e denoncuesit janë tërësisht të pabazuara, Komisioni ka arritur në përfundimin se *nuk vëren fakte apo rrethana që ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit, por në këtë vlerësim, mban në konsideratë edhe faktin se çështja është nën hetim dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka kompetencë të mëtejshme trajtimi.*

**20.3** Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet në Kolegj, kundërshtoi arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, duke sjellë në pah, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

(i) Dokumentet e paraqitura tregojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i pranishëm në shumicën e seancave gjyqësore, gjatë periudhës 4.10.2021 - 18.7.2022, pa paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm.

(ii) Në seancën e datës 15.4.2022, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] këtë çështje e ka marrë në dorëzim nga prokurori E.K., dhe ende nuk ka tërhequr fashikullin dhe nuk është njohur me aktet [...].* Aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, në konsideratë dhe të pretendimeve të denoncuesit, më së paku duket se tregojnë mungesën e veprimeve të efektshme nga ana e subjektit të rivlerësimit për një kohë të gjatë.

(iii) Sa i përket qëndrimit të subjektit të rivlerësimit se: *[...] nuk ushtroi ankim ndaj vendimit të gjykatës, duke qenë i vetëdijshëm se kjo do të vononte rastin për më shumë 2 vjet [...],* rezultatet e hetimit administrativ nuk tregojnë të njëjtën qasje të subjektit, në raste dhe më

---

<sup>20</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar, në gjetjen e tij, referon se: *“Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse për mungesën e tij në seancat gjyqësore, ai i referohet vetëm një dispozite të procedurës penale që lejon gjykatën që të vazhdojë seancat në rastet e mungesave të pajustificuara të palëve. Subjekti i rivlerësimit ka përmendur edhe kërkesat e denoncuesit për zëvendësimin e gjyqtarit të caktuar për çështjen, por nuk ka paraqitur asnjë provë për këtë. Subjekti duhet të sqarojë pozicionin e tij, nëse mungesat ishin të justifikuara, si dhe të sigurojë dokumente mbështetëse.*

*Çështja i është caktuar subjektit që nga korriku 2021, pasi ish-prokurori është shkarkuar nga detyra. Subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur kërkesën në gjykatë në mars të vitit 2022. Në këtë seancë, ai vetë nuk ka qenë i pranishëm. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë në mënyrë të besueshme kohën kaq të gjatë që iu desh për të paraqitur kërkesën në gjykatë (korrik 2021 - mars 2022) dhe nëse ai kishte ndërmarrë ndonjë hap hetimor ndërkohë. Gjithashtu, subjekti duhet të shpjegojë nëse veprimet e tij kanë qenë në përputhje me dispozitat e K.Pr. Penale”.*



sensitive, siç ishte rasti i trajtuar në shkaqet e ankimit, lidhur me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2022.

(iv) Çështja nuk mund të konsiderohet si *rast në shqyrtim*. Gjetjet e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021 - korrik 2022. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*} regj. them., datë 18.7.2022 (dt. regj. 24.5.2021), ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, pasi organi i prokurorisë nuk ka hetuar në lidhje me kallëzimin për *dokument të falsifikuar*, i vetmi moment procedural për të cilin mund të konsiderohet se çështja është akoma në shqyrtim.

**20.3.1** Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara dhe shpjegimeve të subjektit, vlerësoi se edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit mbi shkaqet e arsyeshme lidhur me mungesat në seancat e trajtuara dhe mbi mungesën e veprimeve hetimore, gjatë kohës që çështja është trajtuar prej tij. Duke u qëndruar shkaqeve të ankimit, lidhur me rrethanat konkrete të aplikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, duke konstatuar se mbetet e provuar se gjetjet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit në ushtrimin e ndjekjes penale prej subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021 - korrik 2022, Komisioneri Publik vlerësoi se këto gjetje duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**20.4** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në seancë gjyqësore, kundërshtoi këtë shkak ankimi, me pretendimet se prej Komisionerit Publik nuk janë saktësuar shkeljet e pretenduara të kryera prej tij, referuar treguesve të neneve 71-76 të ligjit nr. 96/2016, ku konkretisht konstatohet “mungesa e veprimeve të efektshme”, për sa kjo çështje i është caktuar pasi një prokuror tjetër kishte përfunduar hetimet dhe kishte përpiluar kërkesën për pushim. Duke referuar nenin E të Aneksit të Kushtetutës: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”, pasi procedimi penal është ende në fazën e hetimit paraprak, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ankesa e shtetasit A. Z. është tërësisht e pabazuar, duke renditur argumente, në mënyrë të përmbledhur, për sa vijon.

(i) Për shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore, dhe jo 8 seanca, sikundër pretendon ankuesi, në datat: 18.11.2021, 07.01.2022, 15.04.2022, 11.05.2022, 08.06.2022, 18.07.2022. Sipas procesverbaleve, për seancat gjyqësore të datave 18.11.2021 dhe 07.01.2022, nuk ka pasur dijeni pasi njoftimet ishin bërë për prokurorin e mëparshëm. Në seancën gjyqësore të datës 11.05.2022, nuk është paraqitur pasi ishte vënë në dijeni për kërkesën e bërë nga A. Z. për shtyrjen e saj. Në seancat gjyqësore të datave 15.04.2022 dhe 08.06.2022, ka marrë pjesë, shkak i shtyrjes ka qenë vetë shtetasi A. Z. Seanca e datës 08.06.2022 është shtyrë nga vetë gjyqtari për shkak të angazhimeve të tij. Ka munguar vetëm në seancën gjyqësore të datës 08.06.2022, nuk është në gjendje të shpjegojë për çfarë arsyeje, por mungesa e tij nuk është bërë shkak për shtyrjen e seancës, referuar parashikimeve të K.Pr.Penale, nenit 329/b/2: “kur palët nuk paraqiten ndonëse janë njoftuar rregullisht [...] pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj”.

(ii) Pretendimet e denoncuesit lidhen me faktin se për dy kallëzime të tjera të tij, ka marrë vendim mosfillimi, të cilët të arsyetuar, brenda afatit ligjor 15-ditor, i janë njoftuar në rrugë

postare në adresën e depozituar<sup>21</sup>. Shtetasi A. Z. nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj dy vendimeve të mosfillimit për kallëzimet e tij, por duke i konsideruar vendimmarrjet si njëanshmëri, ka kërkuar përjashtimin e tij nga ky procedim penal, kërkesë që nuk është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë, pavarësisht se prej tij është dhënë pëlqimi me shkrim.

(iii) Krahasimi i këtij rasti me kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2022, nuk qëndron, rastet nuk kanë simetri mes tyre dhe është në të drejtën e plotë të prokurorit që rast pas rasti të ushtrojë ose jo të drejtën e ankimit. Në këtë rast, kërkesa për pushimin e procedimit penal nuk ishte bërë prej tij, nuk përfaqësonte bindjen e tij, dhe në thelb ka qenë dakord me vendimin e gjykatës, sipas të cilit prokurori i mëparshëm që kishte paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal, nuk kishte kryer fare hetime dhe nuk kishte disponuar për një nga veprat penale për të cilat ishte bërë regjistrimi i procedimit penal, atë të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016<sup>22</sup>, në çdo rast ka shprehur bindjen e tij të brendshme, e cila nuk mund të jetë shkak për shkarkim nga detyra, pa u shoqëruar me sjellje të papërshtatshme apo në kundërshtim me nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016.

**20.5** Trupi gjykues, nga aktet në fashikullin e Komisionit, konstaton se subjekti ka deklaruar se sipas të dhënave të sistemit CAMS, kjo çështje i është shortuar atij më 24.7.2021, pas shkarkimit nga detyra të prokurorit të mëparshëm prej Komisionit në datën 9.7.2021. Lidhur me prezencën e subjektit të rivlerësimit në seancat gjyqësore me kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe objekt “Pushim i çështjes penale nr. {\*\*\*/2020”, nga aktet në fashikull, konstatohet si vijon.

(i) Për seancën e datës 18.11.2021, në procesverbal pasqyrohet: *[...] u thirr, nuk u paraqit organi i Prokurorisë, njoftuar nga gjykata. Gjykata shtyn seancën gjyqësore për të njoftuar organin e prokurorisë për zëvendësimin e prokuror E. K. [...]. Gjithashtu, shkresa drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për njoftimin e zhvillimit të seancës gjyqësore më datë 18.11.2021, ka objekt “Caktim prokurori” dhe, në përmbajtje, kërkohet: [...] merrni masa për caktimin e një prokurori për t’u paraqitur në gjykatë (dosje prokuror E. K.) [...]. Nga sa më sipër, nuk provohet që subjekti të ketë qenë në dijeni për seancën gjyqësore të datës 18.11.2021 e, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi të mospjesëmarrjes në të.*

(ii) Për seancën e datës 17.01.2022<sup>23</sup>, në procesverbal pasqyrohet: *u thirr, nuk u paraqit prokuror Saimir Hysa, me dijeni. Duke konstatuar që prokurori në dijeni për zhvillimin e seancës, nuk është paraqitur pa asnjë arsye të përlegjur, gjykata ka vazhduar shqyrtimin e çështjes mbi aktet e paraqitura nga organi i prokurorisë [prokurori i mëparshëm]. Siç pasqyrohet në procesverbal, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës dhe caktimin e seancës së ardhshme tej afateve ligjore, për t’u njohur dhe administruar aktet [në këtë seancë, A. Z. ka paraqitur pretendimet e tij lidhur me vendimin e prokurorisë], për shkak të ngarkesës në punë, si dhe me kërkesë të vetë A. Z.*

<sup>21</sup> Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet në Kolegi, paraqiti vendimet për mosfillim të procedimeve penale nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2019, dhe nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2022, respektivisht të datave 20.03.2019 dhe 20.05.2022, dhe shkresat për njoftimin e tyre, për të cilat rezulton se shtetasi A. Z. ka marrë dijeni.

<sup>22</sup> Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3, të titulluar “Vlerat themelore”, në pikën 2, parashikon: “2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye”.

<sup>23</sup> Subjekti referon si datë të seancës 07.01.2022, ndërkohë që nga aktet në fashikuj në këtë datë, nuk rezulton të jetë caktuar/njoftuar apo zhvilluar seancë.

(iii) Për seancën e datës 15.04.2022, në procesverbal pasqyrohet: *u thirr, u paraqit prokuror Saimir Hysa*. Rezulton se kallëzuesi A. Z. është shprehur se nuk është dakord me gjykatën [gjyqtar G. H., caktuar si gjyqtar i çështjes më datë 02.03.2022], pasi për të nuk ka qenë bindës procesi i hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarit. Gjyqtari nuk ka çmuar të arsyeshme të japë dorëheqjen pasi rrethana e parashtruar nuk parashikohet nga K.Pr.Penale si shkak për dorëheqje, dhe ka informuar kallëzuesin për të drejtën për paraqitje të kërkesës me shkrim brenda 3 ditëve. Gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorit/subjektit të rivlerësimit për dhënie kohe për të njohur materialin, pasi çështjen e ka marrë në ngarkim nga prokuror tjetër dhe ende nuk e ka tërhequr fashikullin hetimor, dhe ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore më datë 11.05.2022, duke mos pranuar kërkesën e kallëzuesit për ta caktuar seancën rreth fundit të muajit maj, me argumentin *se ka qenë prezent në çdo seancë gjyqësore, por prokurori nuk ka qenë prezent*.

(iv) Për seancën e datës 11.05.2022, në procesverbal pasqyrohet se: *u thirr, nuk u paraqit prokuror Saimir Hysa*, dhe se kërkesa e kallëzuesit për përjashtimin e gjyqtarit G. H. është rrëzuar me vendimin nr. {\*\*\*}/2022, e po këtë ditë, në sekretarinë gjyqësore është depozituar një kërkesë e kallëzuesit A. Z. për shtyrje të seancës gjyqësore<sup>24</sup>, për shkak të një problemi personal, ndërkohë që ky i fundit ka qenë i pranishëm në seancë. Kallëzuesi A. Z., në seancë ka deklaruar lidhur me përfaqësimin prej avokates B. N., zgjedhur prej tij, e se është paraqitur vetëm për të dhënë këtë njoftim dhe e ka të pamundur për të vijuar gjykimin për shkak të një problemi personal. Sa më sipër, duket bindës pretendimi i subjektit se nga vënia në dijeni paraprakisht për kërkesën e kallëzuesit A. Z. për shtyrje të seancës, ka vlerësuar se do të përbënte shkak për shtyrjen e seancës.

(v) Për seancën e datës 08.06.2022, sipas shkresës/shënimit, nënshkruar nga gjyqtari G. H. dhe sekretare J. S., rezulton se seanca gjyqësore është shtyrë për në datë 18.07.2022, për shkak *se gjyqtari është i angazhuar për përgatitjen e dokumenteve për gjykimin në KPA*. Në këtë shënim pasqyrohet: *prokurori dhe kërkuesi prezent, mori dijeni*.

(vi) Për seancën e datës 18.07.2022, në procesverbal pasqyrohet: *u thirr, nuk u paraqit prokuror Saimir Hysa, me dijeni për gjykimin, shkak për mosparaqitjen nuk ka*. I pyetur nga gjykata nëse dëshiron të vijojë gjykimi pa praninë e prokurorit apo kërkon shtyrjen e gjykit për njoftimin e tij, kallëzuesi është shprehur se kërkon vazhdimin e gjykit në mungesë të prokurorit, ka ripërsëritur/riparaqitur kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit G. H., dhe i pyetur nga gjykata nëse kërkon ndërprerjen e gjykit për të paraqitur këtë kërkesë, ka deklaruar se kërkon vijimin e gjykit. Gjykata, duke konstatuar se vendimi i prokurorit E. K. kishte disponuar vetëm për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, ndërkohë që kallëzimi ishte edhe për “Falsifikim dokumentesh”, ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vijimin e hetimeve sipas orientimeve në pjesën arsyetuese të vendimit.

**20.6** Sa më sipër, mungesat e prokurorit/ subjektit të rivlerësimit, të pamotivuara me ndonjë arsye vetëm në dy seanca gjyqësore, të datave 17.01.2022 dhe 18.07.2022, konsideruar ngarkesën e shtuar të punës në prokurori përgjatë kësaj periudhe, faktin që procedimi penal për të cilin po shqyrtohej kërkesa për pushim, nuk ishte hetuar prej subjektit, por prej një prokurori tjetër, situatë e cila në kontekstin e të gjitha rrethanave të rastit, e bën objektivisht jo shumë të natyrshme prezencën dhe mbrojtjen e kërkesës, veçanërisht kur ajo nuk është e detyrueshme

---

<sup>24</sup> Në dosje është administruar kërkesa e kallëzuesit A. Z. për shtyrje të seancës gjyqësore, e cila mban datën 10.05.2022

sipas ligjit, u vlerësuan nga trupi gjykues në kontekstin e parashikimeve të nenit 329, germa “b” e K.Pr.Penale, që normon edhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës që nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht. Në këtë kuptim, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë pasojë të ardhur në dëm të interesave të denoncuesit për shkak të mosparaqitjes së subjektit në këto dy seanca gjyqësore.

**20.7** Lidhur me sa pretendon Komisioneri Publik, se mbetet e provuar se gjetjet e rezultuara nga hetimi administrativ, lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit në ushtrimin e ndjekjes penale prej subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021 - korrik 2022, trupi gjykues vlerëson se përpos që subjekti është përfshirë në këtë çështje pasi hetimet ishin kryer nga një prokuror tjetër dhe prej tij ishte kërkuar pushimi i procedimit penal në gjykatë, nga sa më lart pasqyruar, duket se shtyrja e seancave gjyqësore deri në datë 19.04.2022, e po ashtu edhe e seancave gjyqësore të datave 11.05.2022 dhe 18.06.2022, ka ardhur si pasojë e veprimeve/vendimeve të vetë gjykatës, por dhe kërkesave të vetë kallëzuesit. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, trupi gjykues nuk çmon se subjekti ka treguar mungesë efikasiteti në ushtrimin e ndjekjes penale dhe që sjellja e tij procedurale të ketë afektuar vetë hetimet e zhvilluara në këtë periudhë, aq më tepër kur periudha e pretenduar, ka si subjekt procedural vendimmarrës jo më prokurorin, por gjykatën.

**20.8** Trupi gjykues i gjeti të arsyeshme dhe bindëse shpjegimet e subjektit se për mosushtrimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës që ka refuzuar kërkesën e prokurorisë për pushim të këtij procedimi penal dhe ka urdhëruar vijimin e hetimeve, është mbështetur në vlerësimin e tij se hetimet e kryera nga një prokuror tjetër, nuk ishin të plota, e për këtë shkak ishte dakordësuar me disponimin e bërë nga gjykata në këtë rast. Pretendimet në ankimin e Komisionerit Publik se, me mosushtrimin e ankimit ndaj këtij vendimi gjyqësor, subjekti ka zbatuar standarde të ndryshme krahasuar me trajtimin e kallëzimit penal nr. {\*\*\*/2022, u gjetën pa relevancë për vlerësimin e sjelljes profesionale të subjektit. Trupi gjykues vlerëson se ankimi është një mjet procedural që ushtrohet rast pas rasti, sipas vlerësimit që bën prokurori si mbartës i kësaj të drejte, dhe situatat e referuara, të marra në shqyrtim në këtë vendim, paraqesin raste krejtësisht të ndryshme e që nuk sugjerojnë për zbatim të njëjtë të kësaj të drejte.

**20.9** Në përfundim, lidhur me denoncimin e shtetasit A. Z., sa i përket procedimit penal nr. {\*\*\*/2020 [regjistruar me nr. {\*\*\*/2021 pas vendimit të gjykatës], në kuptim të indikatorëve të parashikuar në ligjin nr. 96/2016, trupi gjykues nuk gjen problematika në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për t'i vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikundër pretendon Komisioneri Publik.

**21** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *për procedimin penal nr. {\*\*\*/2020 [e cilësuar si çështja e aferës {\*\*\*/2021}], të vitit 2014, gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit administrativ shtesë janë të tilla që nuk duhen të transferohen pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.*

**21.1** Vëzhguesi ndërkombëtar, me gjetjen e datës 27.06.2023, ka përcjellë në Komision edhe fashikujt e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, duke çmuar se të dhënat e konstatuara për këtë procedim penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, i cili është nisur në kuadër të procedimit

kryesor nr. {\*\*\*}/2014 për aferën {\*\*\*}, duhet të jenë pjesë e procesit të rivlerësimit për subjektin<sup>25</sup>.

**21.2** Komisioni, pas riçeljes së hetimit administrativ, ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime bindëse dhe të dokumentojë lidhur me sa konstatuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, në mënyrë të përmbledhur, ka shpjeguar se:

Procedimi penal nr. {\*\*\*}, i cili nuk ka asnjë lidhje me shoqërinë tregtare çeke “{\*\*\*}” dhe as me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, bën fjalë për marrëdhëniet mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK me katër shoqëri tregtare shqiptare, lidhur me disa marrëveshje blerje/shitje apo edhe shërbimi mes tyre. Për këtë shkak, prokurorët që e kanë pasur çështjen në ngarkim, me vendimin e datës 27.02.2017, kanë vendosur ndarjen e akteve lidhur me këtë fakt nga dosja e procedimit penal nr. {\*\*\*} apo {\*\*\*}, në ngarkim të të pandehurve K. I., J. H. dhe J. I., në çështje penale më vete, duke qenë se nuk lidhej fare me faktet, objektin e akuzës ndaj të këtyre të pandehurve.

Për veprimet juridike mes tyre, shoqëritë tregtare private/jopublike kanë përpiluar fatura tatimore për të cilat shteti ka përfituar taksat përkatëse dhe, ndryshe nga sa theksohet në gjetje, shteti nuk ka pësuar dëm nga veprimtaria e tyre. Ky fakt theksohet edhe në kërkesën e tij: *pagesat në drejtim të katër shoqërive të sipërpërmendura janë kryer nga “{\*\*\*}” ShPK, përmes faturave tatimore të deklaruara rregullisht në organet tatimore dhe për të cilat janë paguar detyrimet fiskale.*

Në momentin që ka marrë dosjen për veprim, ish-in kryer hetime të shumta lidhur edhe me këtë fakt, dëshmuar edhe nga volumi i dosjes dhe veprimet e kryera nga prokurori paraardhës. Provat e mbledhura nga hetimi kanë të njëjtën vlerë procedurale për prokurorin që vazhdon hetimin dhe nuk ka nevojë që të ripërsëriten.

---

<sup>25</sup> Gjetja nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2023, me të cilën vëzhguesi ndërkombëtar ka depozituar edhe dosjen e procedimit penal, përcjellë ONM-së nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.06.2023. Në gjetjen e tij, vëzhguesi ndërkombëtar ka sjellë në pah si vijon.

“- Në dosjen e siguruar nga prokuroria, të vetmet akte të nxjerra nga subjekti i rivlerësimit janë kërkesa për pushim dhe ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Nuk është e qartë nëse ai ka kryer ndonjë veprim hetimor përpara paraqitjes së kërkesës për pushim, siç përmendet në kërkesën e tij (marrja në pyetje e përfaqësuesve të shoqërive, sigurimi i dokumenteve, kontratave etj.). Vendimi i gjykatës së shkallës së parë i referohet mungesës së veprimeve hetimore për gati 2 vite (2017-2019).

- Në kërkesën e tij për pushim, subjekti i rivlerësimit duket se u është referuar në mënyrë kontradiktore, të dy neneve 186/2 dhe 186/3 të Kodit Penal, duke konkluduar më pas për pushim sipas nenit 186/2 për shkak të parashkrimit të veprës penale, nuk përmend dhe nuk duket të ketë hetuar nëse kushtet e parashikuara në nenin 186/3 janë plotësuar, pavarësisht dosjeve voluminoze të siguruara gjatë hetimeve të mëparshme dhe faktit të qartë se këta persona ishin përfaqësues të shoqërive të përfshira.

- Subjekti i rivlerësimit është jokonsistent në identifikimin e falsifikimit të dokumenteve, përdorimit të tyre, përfituesve dhe mungesës së veprimeve si nga shoqëritë e kontraktuara, ashtu edhe nga {\*\*\*} ShPK, duke mos identifikuar apo hetuar përgjegjësinë e atyre që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet (e falsifikuara), siç parashikohet qartë në nenin 186/3 të Kodit Penal. Çështja në fjalë duket më e rëndësishme në funksion të profilit të lartë publik, ku përfshihen interesa monetare përkatëse të shtetit shqiptar, të cilat janë dëmtuar nga veprimtaria e {\*\*\*} ShPK dhe shoqërive të tjera të kontraktuara.

- Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë dhe provojë në mënyrë të besueshme mangësitë e sipërpërmendura të aftësive personale. Për veprimet e kryera gjatë viteve 2010-2011, afati për ndjekje penale sipas nenit 186/3 të Kodit Penal (10 vjet nga kryerja e veprës penale), ka qenë në fuqi deri në vitin 2021. Subjekti duhet të sqarojë nëse aktualisht hetimi është pushuar për shkak të parashkrimit të veprës penale, apo për arsye të tjera”.

Në gjetje nuk përmendet që çështja ka përfunduar me vendim të formës të prerë. Pas apelimit të tij, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.05.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*} akti, datë 21.11.2019, të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pranimin e kërkesës së tij për pushimin e çështjes, duke vlerësuar se: *organi i prokurorisë ka hetuar në mënyrë të drejtë për sa i përket kallëzimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, dhe se: organi i prokurorisë i ka kryer të gjitha verifikimet e duhura.*

Ka konstatuar dhe e pranon, se në kërkesën e tij ka një lapsus në faqen 2, paragrafi 4, kur shkruhet se: *Në kuadër të hetimeve paraprake të këtij procedimi, është bërë dhe ndarja e çështjes penale {\*\*\*} për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, që nuk lidhet me vlerësimin e tij, por i është referuar në mënyrë të gabuar një vendimi të marrë nga një prokuror tjetër. Në urdhrin e dy prokurorëve për ndarjen e çështjes, për procedimin penal me nr. {\*\*\*} për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nuk përcaktohet paragrafi. Në kërkesë, është shkruar: *kanë kaluar edhe afatet e parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale, për të cilat është bërë regjistrimi i procedimit penal, të parashikuara nga neni 186/2 i Kodit Penal, nisur nga fakti se të gjitha këto veprime janë kryer në periudhën 2010-2011, pra qartazi bëhet fjalë për një afat 5-vjeçar të parashkrimit që i korrespondon nenit 186/2 të Kodit Penal. Për paragrafin e tretë të nenit 186 të Kodit Penal, afati i parashkrimit është 10 vjet dhe nuk mund të kërkonte pushimin e çështjes për këtë shkak. Duke evidentuar se cilësimi ligjor i veprës penale është atribut i prokurorit, subjekti ka shpjeguar se personat e dyshuar nuk ishin persona me funksione shtetërore apo publike, kanë vepruar si administratorë apo ortakë të shoqërive tregtare, prandaj ka vlerësuar se nuk janë subjekt i paragrafit të tretë të nenit 186 të Kodit Penal. Në kërkesën e tij, të paktën në 4 raste, kualifikimi ligjor është sipas nenit 186/2 të Kodit Penal, edhe duke u shprehur “Falsifikimi i dokumenteve, kryer në bashkëpunim”, nëse kualifikimi do të ishte sipas paragrafit të tretë, do të shkruhej “Falsifikimi i dokumenteve nga personi që ka për detyrë ta lëshojë dokumentin”. Për sa shpjeguar, subjekti ka pretenduar se nuk qëndron dyshimi se nuk ka identifikuar apo hetuar përgjegjësinë e atyre që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet (e falsifikuara), siç parashikohet qartë në nenin 186/3 të Kodit Penal.**

Sa i takon kohës së marrjes së vendimit, subjekti ka pranuar se çështja mund të ishte përfunduar më shpejt, por ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe materialit voluminoz, si dhe ka shpjeguar se këtë vendim mund ta kishin marrë edhe vetë prokurorët që kanë bërë veçimin e çështjes, pasi që në momentin kur është bërë ndarja, kishin kaluar afatet e parashkrimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

**21.4** Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit të administruar, duke konsideruar këtë çështje komplekse, pavarësisht vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka vlerësuar se parashtrimet e subjektit në kërkesën e tij për pushimin e çështjes, nën veprën penale të nenit 186/2 të Kodit Penal, në raport me vendimet e gjykatave, t'i nënshtrohen kontrollit nga organi kompetent, me qëllim çmuarjen e provave, si dhe logjikën e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në analizën juridike mbi kualifikimin e saj. Për sa më sipër dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin/logjikën e prokurorit, Komisioni ka konkluduar se mangësitë e gjetura mund të përbëjnë shkaqe për t'u vlerësuar më tej nga organi kompetent, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016.

**21.5** Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit administrativ shtesë, lidhur me këtë procedim penal, janë të tilla që nuk duhen të transferohen

pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera lidhur me kriterin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në zbatim të rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura, dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në aktet e paraqitura, për sa vijon.

(i) Subjekti i rivlerësimit nuk dokumentoi kryerjen e veprimeve hetimore nga momenti që i është caktuar çështja penale. Në vendimin për ndarjen e çështjes penale në vitin 2017, prokurorët e mëparshëm i referohen specifikisht nevojës për të kryer veprime hetimore për falsifikim dokumentesh.

(ii) Nga aktet në dosje, nuk duket se subjekti i rivlerësimit të ketë lëshuar urdhra për zgjatjen e afateve të hetimit dhe nuk specifikoi sa kohë ai ka pasur nën hetim këtë çështje.

(iii) Subjekti i rivlerësimit interpreton në mënyrë të kufizuar nenin 186/3 të Kodit Penal, si të zbatueshëm vetëm për persona zyrtarë ose me funksion publik të njohur nga ligji që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentin, duke legjitimuar kështu mosushttrimin e ndjekjes penale për persona të tjerë që ushtrojnë këtë detyrë.

**21.6** Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtroi se gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura nga Komisioni në vendim dhe në shkaqet e ankimit, dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura. Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, duke vlerësuar kompleksitetin e çështjes, parashtroi edhe prej subjektit në prapësime, ritheksoi të njëjtin vlerësim, për mostransferim pranë ILD-së për inspektim të gjetjeve, por vlerësimin e tyre në kuadër të procesit të rivlerësimit, së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**21.7** Subjekti i rivlerësimit prapësoi lidhur me këtë shkak ankimi, me të njëjtat argumente sikundër në Komision. Lidhur me pretendime të ngritura prej Komisionerit, lidhur me afatin e hetimeve dhe interpretim të ngushtë të nenit 186/3 të Kodit Penal, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit parashtroi si vijon.

(i) Nuk ka pasur asnjë arsye për të marrë vendim për të zgjatur afatin e hetimeve sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, veprim që lidhet domosdoshmërisht me momentin e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe jo me momentin e regjistrimit të procedimit penal. Prej tij nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si autor i ndonjë veprave penale, sipas parashikimeve të nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në vitin 2008: *Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Ndërsa neni 323/1 i po këtij Kodi parashikonte: Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj.*

(ii) Pretendimi i Komisionerit për interpretim të ngushtë të nenit 186/3 të Kodit Penal, nuk qëndron pasi teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore përcakton se paragrafi i tretë i nenit 186 zbatohet ndaj subjekteve të posaçme me detyra shtetërore apo funksione publike, ku nuk bëjnë pjesë drejtuesit e shoqërive tregtare.

**21.8** Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik lidhur me këtë procedim penal, si edhe i analizoi ato në këndvështrim të të gjitha akteve të administruara në fashikullin e hetimit të Komisionit, konstaton dhe arsyeton si vijon.

**21.8.1** Në vendimin e datës 27.02.2017, “Për ndarjen e çështjes penale”, të prokurorëve të çështjes, pasqyrohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, viti 2014, fillimisht në ngarkim të të pandehurit K. I., i akuzuar për veprat penale të “Mashtimit me pasoja të rënda”, “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 143/2 dhe 287/2 i Kodit Penal. Me këtë procedim, janë bashkuar edhe procedimet penale nr. {\*\*\*}/2008, e nr. {\*\*\*}/2012, regjistruar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimet penale të sipërcituara, të bashkuara në vitin 2015 në procedimin penal me nr. {\*\*\*}/2014, janë regjistruar mbi bazë të informacione të vetë organeve ligjzbatuese, nga ku kanë rezultuar dyshime se nëpërmjet shoqërive të krijuara dhe të administruara nga i pandehuri K. I., janë kryer transaksione financiare, pa logjikë ekonomike, me burime të ardhurash të dyshuara nga aktivitete kriminale. Nga hetimet e zhvilluara në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2014, ka rezultuar se i pandehuri, duke përdorur të dhëna të rreme dhe dokumente të falsifikuara apo fiktive, ka arritur të vjedhë nga llogaritë e shoqërisë “{\*\*\*}”, i ndihmuar nga i pandehuri J. H. dhe J. I., 649.803.520 lekë, duke konsumuar veprën penale të “Mashtimit me pasoja të rënda, të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 143/2 [togfjalëshi i fundit] i Kodit Penal. Nga ana objektive, vepra penale nga i pandehuri është kryer me veprime të kundërligjshme, të cilat konsistojnë në vjedhjen e pasurisë së kompanisë “{\*\*\*}”, në të cilën në momentin e kryerjes së veprës penale, ka qenë aksioner edhe shteti shqiptar, me 24% të aksioneve. Me vendimin e datës 15.12.2015, është vendosur ndarja e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit K. I., i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Mashtimit” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, e cila është dërguar për gjykim dhe kanë vazhduar hetimet për shtetasit J. H. dhe J. I. e tjerë, me qëllim të kryheshin njoftimet procedurale për ta, dhe pasi përshkruhen veprimet e kryera, prokurorët shprehen se hetimi për ta ka përfunduar dhe të pandehurit janë njohur me akuzat. Më tej, në vendim, prokurorët shprehen: *[...] Hetimet në këtë çështje penale vazhdojnë, për të verifikuar shkaqet e lëshimit të disa faturave të dyshuara si fiktive, në bazë të të cilave janë transferuar paratë nga shoqëria “{\*\*\*}”. Për këtë arsye, çmohet e domosdoshme ndarja e çështjes penale, me qëllim dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve dhe vazhdimin e hetimeve lidhur me fiktivitetin e faturave [...].* Në mbështetje të fakteve dhe provave të administruara, si dhe në mbështetje të nenit 93/ç të K.Pr.Penale, prokurorët kanë vendosur ndarjen e çështjes penale nr. {\*\*\*} në dy procedime penale: (i) në procedimin penal nr. {\*\*\*}, në ngarkim të të pandehurve J. H. dhe J. I., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mashtimit me pasoja të rënda, të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal; dhe (ii) në procedimin penal {\*\*\*}, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

**21.8.2** Procedimi penal i veçuar si më sipër, me nr. {\*\*\*}, i është ngarkuar për hetim subjektiv të rivlerësimit. Në kërkesën “Për pushimin e çështjes”, datë 08.06.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *[...] pasi studiova aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2017, që bën fjalë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, konstatova [...].* Në vijim, pas pasqyrimin të ecurisë së procedimit penal nr. {\*\*\*}/2014, subjekti shprehet se: *[...] Në*



*kuadër të hetimeve paraprake të këtij procedimi, është bërë dhe ndarja e çështjes penale {\*\*\*} për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Objekti i hetimit të kësaj çështjeje penale të ndarë, ka të bëjë me shkaqet e lëshimit të disa faturave të dyshuara si fiktive, në bazë të të cilave janë transferuar paratë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për shoqëritë “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK [...]. Në kërkesë, referohen të dhëna për kontratat përkatëse, ato të rezultuarat nga pyetja e përfaqësuesve të shoqërive, si dhe të dhënat faktike të rezultuara nga hetimi i kryer. Prokurori/subjekti i rivlerësimit analizon se: [...] Nga sa u arsyetua më sipër, del se të katra kontratat e sipërpërmendura kanë të përbashkët faktin se nuk janë realizuar, megjithëse për pjesën më të madhe, pagesat në drejtim të shoqërive të sipërpërmendura, janë kryer nga “{\*\*\*}” ShPK, përmes faturave tatimore të deklaruara rregullisht në organet tatimore dhe për të cilat janë paguar detyrimet fiskale [...] ka dyshime të arsyeshme se dokumentacioni i përpiluar për veprimet financiare, është fiktiv, që konsiderohet si vepër penale sipas nenit 186 të Kodit Penal dhe meqenëse është kryer në bashkëpunim, kualifikohet sipas paragrafit të dytë të kësaj dispozite. Në rastin konkret, kanë kaluar edhe afatet e parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale për të cilat është bërë regjistrimi i procedimit penal, të parashikuara nga neni 186/2 i Kodit Penal, nisur nga fakti se të gjitha këto veprime janë kryer në periudhën 2010-2011, dhe sipas afateve të parashikuara në nenin 66/b të Kodit Penal, nuk mund të ushtrohet ndjekje penale për këtë vepër [...].*

**21.8.3** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka shqyrtuar kërkesën e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, ka disponuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.11.2019, ku analizon se qëndrimi i prokurorit nuk përputhet me aktet hetimore të paraqitura bashkëlidhur kërkesës për gjykim, të administruara në dosjen hetimore, për shkak se procedimi penal nr. {\*\*\*} i vitit 2014, është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe jo veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, se edhe pse nga vetë prokurorët është urdhëruar kryerja e një sërë veprimesh hetimore, për gati dy vjet nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe është kërkuar në gjykatë pushimi për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën është regjistruar procedimi penal. Në përfundim, gjykata ka vendosur kthimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2014, *për plotësimin e hetimeve paraprake sipas përcaktimeve të cituara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi gjyqësor.*

**21.8.4** Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 21.11.2019, është kundërshtuar prej subjektit të rivlerësimit, i cili, në ankimin e tij, ka ngritur pretendime se gjykata ka tejkalluar tërësisht argumentet e kërkesës së tij, duke evidentuar, ndër të tjera: (i) ka njoftuar dhe në gjykim ka marrë pjesë *si person ndaj të cilit zhvillohen hetime*, shtetasi K. I., i cili nuk e gëzon këtë cilësi në këtë procedim pasi emri i tij nuk është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Për objektin e këtij procedimi, *nuk ka asnjë kallëzim ndaj K. I.*, pasi ky është një hetim i nisur kryesisht nga organi i prokurorisë, dhe ky shtetas është i dënuar në kuadër të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2011; (ii) ka konstatuar në mënyrë abuzive se regjistrimi i procedimit është bërë për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, dhe jo veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Në vendimin për ndarjen e këtij procedimi, referohet neni 186, pa cituar paragraf, dhe nga organi i akuzës është vlerësuar se qoftë K. I., qoftë personat e tjerë janë subjekt i nenit 186/2 të Kodit Penal, pasi asnjë prej tyre nuk gëzon cilësinë e “personit që ka për detyrë të lëshojë dokumentin”, shoqëritë janë me kapital 100% privat dhe administratorët e tyre nuk janë subjekte të paragrafit të tretë

të nenit 186; (iii) marrëdhëniet juridike mes “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqërive të tjera nuk kanë lidhje lëndore me veprat penale për të cilat shtetasi K. I. është dërguar për gjykim; (iv) sa u takon detyrave të lëna për t’u kryer, konstatohet se gjykata nuk është njohur me dosjen hetimore pasi pjesa më e madhe e këtyre veprimeve janë kryer dhe aktet ndodhen në dosjen hetimore. Janë analizuar të gjitha transaksionet bankare për të katra kontratat, janë administruar të gjitha faturat dhe krahasuar me librat kontabël të shoqërive, është marrë informacion pranë organeve tatimore etj. Procedimi penal nr. {\*\*\*} ka si objekt verifikimin e shkaqeve të lëshimit të disa faturave të dyshuara si fiktive, në bazë të të cilave janë transferuar paratë nga “{\*\*\*}” ShPK, që në total janë vetëm katër transfertat e sipërcituara.

**21.8.5** Gjykata e Apelit Tiranë ka shqyrtuar ankimin e subjektit të rivlerësimit<sup>26</sup>, dhe në vendim, në pjesën “Vlerësimi i Gjykatës së Apelit”, shprehet, ndër të tjera, se: [...] çmon se në rastin e ankimit ndaj vendimit të pushimit të çështjes, detyrim i gjykatës është të verifikojë nëse organi ka zhvilluar hetime të plota e të gjithanshme, pa marrë atributë mbi të drejtën e ndjekjes penale e cila mbetet e drejtë ekskluzive e prokurorisë. [...] Organi i prokurorisë ka hetuar në mënyrë të drejtë për sa i përket kallëzimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. [...] Organi i prokurorisë ka kryer të gjitha verifikimet e duhura, nga ku ka rezultuar se dokumentacioni i përpiluar financiar, është fiktiv, dhe që për këtë, shtetasi K. I. është dënuar më parë me vendim penal të formës së prerë [...]. Gjykata e Apelit Tiranë, në përfundim, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2014.

**21.9** Në këndvështrim të fakteve të mësipërme, trupi gjykues analizoi shkaqet e ankimit të paraqitura prej Komisionerit Publik. Së pari, lidhur me pretendimin se nga aktet në dosjen gjyqësore, nuk provohet koha kur subjekti i rivlerësimit ka marrë në dorëzim dosjen e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, që i është caktuar atij pas veçimit të saj nga procedimi penal nr. {\*\*\*}/2014, konstatohet se ky pretendim është i drejtë. Nga aktet e administruara, nuk rezulton asnjë informacion i vlefshëm që të hedhë dritë saktësisht mbi kohën e marrjes në dorëzim të kësaj çështjeje prej subjektit të rivlerësimit dhe as ai vetë nuk jep ndonjë të dhënë më shumë në këtë drejtim. Së dyti, pavarësisht konstatimit si më sipër, dhe për pasojë pamundësisë për të përcaktuar një kohë ekzakte përgjatë së cilës subjekti ka pasur për trajtim këtë procedim penal, rezulton i provuar pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor gjatë kohës që çështja ishte në ngarkim të tij. Së treti, ndërsa konsideron pa relevancë pretendimin për mungesë të vendimeve për zgjatje afatesh, përderisa asnjë emër nuk ishte regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, premisë që do të prodhonte nevojën e marrjes së vendimeve të tilla konform nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues vlerëson se mosveprimi i subjektit të rivlerësimit përgjatë gjithë kohës që ai ka pasur çështjen në ngarkim, qoftë edhe nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për pushimin e procedimit për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, siç ai pretendon, nuk

---

<sup>26</sup> Në vendimin e Gjykatës së Apelit, në pjesën “Faktet e çështjes”, pasqyrohet: “[...] në datën 27.02.2017, është vendosur ndarja e procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2014, objekt gjykimi, ku kanë vazhduar hetimet për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe, në vijim, në bazë të akteve hetimore të procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, objekt i këtij gjykimi, rezulton se janë zhvilluar hetime paraprake të cilat kanë të bëjnë me verifikimin e shkaqeve të lëshimit të faturave të dyshuara si fiktive, në bazë të të cilave janë transferuar shuma të ndryshme parash [...].

është një sjellje që mund të justifikohet në këndvështrim të nënindikatorëve që lidhen me aftësitë organizative të subjektit. Pretendimi për ngarkesën në punë apo pasja, sipas tij, e qartësisë për faktin se ndjekja penale ishte parashkruar dhe, në këtë kuptim, asnjë veprim hetimor nuk do të kishte sens, vlerësohet se nuk është një arsye e mjaftueshme për të zhveshur subjektin nga përgjegjësia qoftë edhe në versionin që ai prezanton për lënien pa veprime të çështjes.

**21.10** Pavarësisht kësaj analize, trupi gjykues nuk konstaton se kjo kohë e paarsyeshme ka prodhuar ndonjë efekt në zgjidhjen e çështjes, apo se mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore ka kushtëzuar zgjidhjen e saj, përderisa, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkesa e prokurorit/subjektit për pushimin e procedimit penal, për shkak të parashkrimit të ushtrimit të ndjekjes penale, ka qenë e drejtë, fakt që konfirmon qëndrimin e subjektit se kjo rrethanë, parashkrimi, ekzistonte që në vitin 2017, kur ky procedim u veçua nga procedimi mëmë me vendim të prokurorëve të mëparshëm të çështjes. Në këtë kuptim, kjo mangësi mbetet për t'u vlerësuar sipas nënindikatorëve të aftësisë organizative të subjektit, në kuptim të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

**21.11** Lidhur me pretendimin për interpretim të kufizuar të nenit 186/3 të Kodit Penal prej subjektit, trupi gjykues vlerësoi disa elemente të ngritura në ankim, që dukej se përcaktonte se kualifikimi i duhur i faktit penal për të cilin është regjistruar procedimi, do të ishte ai i përcaktuar prej nenit 186/3 të Kodit Penal e, për pasojë, instituti i parashkrimit nuk dukej se ekzistonte në kohën e paraqitjes së kërkesës për pushimin e këtij procedimi prej subjektit.

**21.11.1** *Së pari*, trupi gjykues konstaton se në vendimin e datës 27.02.2017, të marrë prej prokurorëve të çështjes që kishin kryer hetimet për procedimet penale nr. {\*\*\*/2014 dhe {\*\*\*/2015, prej të cilave ka derivuar së fundmi në vitin 2017 edhe procedimi penal nr. {\*\*\*}, që i është ngarkuar për hetim subjektit të rivlerësimit, është përcaktuar se procedimi që veçohet për hetime të mëtejshme i atribuohet regjistrimit të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pa përcaktuar paragrafin konkret të dispozitës, i cili do të përcaktonte edhe kualifikimin e duhur të faktit penal prej tyre, për sa paragrafët e dispozitës përmbajnë rrethana cilësuese të veprës penale që meritojnë kualifikimet ligjore respektive. *Së dyti*, rezulton se të njëjtin përcaktim ligjor kanë bërë prokurorët e kësaj çështjeje edhe në vendimin e marrë në vitin 2015 për veçimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, duke përdorur të njëjtin argument edhe në pjesën përshkuese të këtij vendimi. Në këtë kuptim, trupi gjykues konstaton se edhe në veprimet hetimore të kryera e të urdhëruara prej prokurorëve që trajtonin çështjen mëmë, synohej evidentimi përgjegjësish ligjore të katër shoqërive të cituara në këto akte, të cilat dyshoheshin se kishin kryer kontrata fiktive me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, veprimtari e cila ishte kualifikuar se duhej të hetohej nën dritën e nenit 186 të Kodit Penal.

**21.11.2** Në dritën e këtyre rrethanave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vlerësuar se faktet penale për të cilat ishte urdhëruar kryerja e veprimtarisë së mëtejshme hetimore, duheshin kualifikuar sipas nenit 186/2 të Kodit Penal, meqenëse dyshohej se kontratat fiktive apo të falsifikuara ishin kryer në bashkëpunim, mes përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe përfaqësueseve të katër shoqërive të tjera të futura në marrëdhënie juridiko-civile me të. Për sa kohë që ky ishte kualifikimi i duhur i fakteve penale, sipas vlerësimit të subjektit, prej tij është konstatuar se ushtrimi i ndjekjes penale për

këto fakte të kryera në vitet 2010-2011, ishte parashkruar në kuptim të nenit 66, pika 1, germa “c” e Kodit Penal. Pavarësisht përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka refuzuar kërkesën e subjektit për pushimin e procedimit penal në fjalë, nën argumente të parashkrimit të ndjekjes penale dhe arsytimit që ky vendim bën lidhur me nevojën për veprime të tjera hetimore drejt identifikimit të ndonjë veprimtarie tjetër kriminale, shkak i ankimit të Komisionerit Publik lidhet me interpretimin e kufizuar të bërë prej subjektit për nenin 186/3 të Kodit Penal, për të cilin duket se kanë relevancë edhe qëndrimet/arsyet e përdorura nga ky vendim gjyqësor. Në këtë kuptim, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues e fokusoi analizën sipas shkakut të ankimit, dhe për kufijtë e interpretimit të dispozitës penale, vlerësoi se analiza duhej të mos ndikohej nga ajo e bërë gjatë kontrollit gjyqësor sipas të cilit kishte vlerësime të ndryshme rreth saj – *vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është ndryshuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka disponuar në favor të kërkesës së subjektit për pushimin e procedimit* – por të ishte një vlerësim origjinar i trupit gjykues.

**21.11.3** Në këtë kontekst, *së pari*, trupi gjykues vlerësoi të japë qëndrimin e tij rreth argumentit se subjekti në kërkesën për pushimin e procedimit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por edhe në ankimin ndaj vendimit të dhënë prej saj, në pjesën përshkruese të këtyre akteve, të pasqyruara më lart në këtë vendim, ka përmendur nenin 186/2 të Kodit Penal, duke treguar në këtë mënyrë se ai vetë besonte/vlerësonte se ky ishte kualifikimi i duhur i faktit penal. Trupi gjykues çmon se shpjegimi që subjekti ka dhënë rreth këtij elementi, se ai përfaqëson thjesht një lapsus/gabim në shkrim të dispozitës, është i arsyeshëm dhe mbështetet nga e gjithë pjesa përshkruese e këtyre dokumenteve. Në kërkesën për pushimin e procedimit, subjekti ka argumentuar se faktet penale parashikoheshin si vepra penale e “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, duke përshkruar edhe me fjalë këtë përcaktim, për më tepër që, mbështetur në këtë kualifikim, ai ka paraqitur para gjykatës kërkesën për pushim të procedimit, bazuar në kalimin e afatit të parashkrimit, i cili i korrespondon masës së dënimit që parashikon kjo dispozitë. Nëse subjekti do të kishte vlerësuar ndryshe, kërkesa për pushim mbi faktin e parashkrimit të veprës penale nuk do të mund as objektivisht të artikulohej. Po e njëjta logjikë dominon analizën edhe në drejtim të përmendjes së kësaj dispozite në ankimin e paraqitur, në të cilin sërish besohet se ajo përfaqëson një lapsus, madje logjikisht në këtë rast të mbartur prej përdorimit në shkrim të kopjes së kërkesës për pushimin e procedimit, dhe nuk mund të konsiderohet se ajo përfaqëson në një mënyrë apo tjetër, koshiencën/subkoshiencën e subjektit për ekzistencën e kësaj vepre, duke qenë se ankimi i paraqitur, mbështetet kryekëput mbi argumentin e kundërt me atë që insinuoonte shkak i ankimit. Trupi gjykues vlerëson se përtej të gjithë arsytimit të mësipërm, nxjerrja e konkluzioneve mbi ndërgjegjësimin e subjektit për kualifikimin e duhur ligjor të fakteve penale, mbi elemente të tilla që nuk mbështeten nga logjika dhe qëllimi i hartimit të vetë dokumenteve, nuk është e saktë dhe e bazuar dhe, si e tillë, nuk ka peshë mbi vlerësimin që i bëhet vetë interpretimit të pretenduar si i kufizuar i nenit 186/3 të Kodit Penal.

**21.11.4** Në vijim të kësaj analize, pasi analizoi pretendimin për interpretim të kufizuar të nenit 186/3 të Kodit Penal, trupi gjykues arriti në përfundimin se një konkluzion përfundimtar lidhur me interpretimin e kësaj dispozite, nuk bën pjesë në juridiksionin kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Nga sa u debatua në seancat gjyqësore, rezultoi se praktika gjyqësore ka qëndrime të ndryshme rreth interpretimit të kësaj dispozite dhe, për më tepër, nuk evidentohet një qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë, si një gjykatë ligji, rreth kuptimit dhe elementeve

përbërëse të saj. Për sa nuk rezulton një qëndrim i qartë dhe i konsoliduar rreth interpretimit të dispozitës së sipërcituar, referimi tek i cili do të mund të nxirrte në pah mangësi të subjektit në mënyrën si ai e ka interpretuar atë, për rrjedhojë nuk ka një formë të qartë që do të përcaktonte nëse interpretimi i subjektit ka mangësi në kuptim të aftësive profesionale. Në këto rrethana faktike, analiza dhe diskutimi do të mbeteshin së paku empirikë dhe të diskutueshëm, dhe thirrja e subjektit për përgjegjësi në këtë nivel ambiguiteti, do të ishte joproporcionale.

**21.11.5** Pavarësisht trajtimit teorik të situatës, si më sipër, trupi gjykues, *a prima facie*, ndonëse në një logjikë dhe lexim të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit të kësaj dispozite, vlerëson se, sipas saj, përgjegjësia penale duhet t'u ngarkohet personave që lëshojnë dokumentacion të falsifikuar, në zbatim të një tagri të derivuar nga një përcaktim statutor, qofshin këta funksionarë publikë apo përfaqësues të enteve private. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se do të përfaqësonte një interpretim të zgjeruar të dispozitës nëse përgjegjësia penale do t'u ngarkohej këtyre individëve, për shkak të falsifikimit të akteve me të cilat ata përfshihen në marrëdhënie juridike civile, me qëllim ndërveprimin në qarkullimin civil. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se kufijtë e interpretimit të dispozitës do të duhej t'i nënshtroheshin me dilijencën e duhur kontrollit gjyqësor, ndërsa marrja e qëndrimeve kategorike për këta kufij, e tejkalon gamën e çështjeve që mund të përfshihen në vlerësimin profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këtë konkluzion, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje edhe parashikimin e nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016<sup>27</sup>, e cila duket se kufizon kontrollin disiplinor pikërisht për situata të tilla.

**21.12** Në përfundim, për sa më sipër analizuar, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2014, trupi gjykues gjen të drejtë vetëm pretendimin që lidhet me mosveprimin e subjektit për një kohë të paarsyeshme, e cila mbetet një tregues që mund të konsiderohet në kuadër të nënindikatorëve të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016.

- 22** Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit për *denoncimin e shtetasit F. H.*<sup>28</sup>, rrethanat e dala, ndër të tjera, periudhat pa kryerje të veprimeve hetimore dhe pa nxjerrë akt të motivuar për shtyrjen e hetimit, koha e kryerjes së veprimeve hetimore, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore sipas nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues konstaton si vijon.

**22.1** Shtetasi F. H., në denoncimet e paraqitura në Komision, i referohet një çështjeje penale të regjistruar mbi bazë të kallëzimit të tij, me të cilin ka pretenduar se shkak i vdekjes së nënës së tij në vitin 2007, ka qenë aksidenti nga një automjet dhe jo hemorragjia cerebrale si shkak i rrëzimit të saj në shkallë. Çështja është hetuar fillimisht nga një prokuror tjetër, i cili me vendimin e datës 19.07.2007, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 25.05.2007, të regjistruar për veprën penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes” parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal. Ky vendim, pas ankimit të kallëzuesit, është shfuqizuar me vendimin e datës

---

<sup>27</sup> Ligji nr. 96/2016, në nenin 73, të titulluar “Aftësitë profesionale të prokurorit”, në pikën 4 parashikon: “Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.

<sup>28</sup> Denoncimet e paraqitura nga shtetasi F. H., janë administruar në Komisionin me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.04.2019; nr. {\*\*\*} prot., datë 25.04.2019; nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2019.

29.05.2009 të Drejtorisë së Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, duke konstatuar se hetimet ishin të paplota dhe është urdhëruar vijimi i hetimeve. Në zbatim të këtij vendimi, çështja i është ngarkuar subjektit të rivlerësimit, i cili, me vendimin e datës 25.05.2010, ka vendosur të pushojë procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2007, pasi nga deklaratimet e marra, akti i ekspertimit, por edhe diagnoza e qendrës spitalore, nuk kanë identifikuar ndodhjen e një aksidenti si shkak të vdekjes të së ndjerës. Vendimi i subjektit të rivlerësimit, mbi ankimin e kallëzuesit, është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 21.07.2011, e cila ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, ripyetjen e tre shtetasve për shkak të kontradiktave në thëniet e tyre, ballafaqimin nëse sërish do të rezultojnë kontradikta, ripyetjen e mjekes Sh. S. që ka përpiluar kartelën e vdekjes të së ndjerës, dhe konkludimin për shkakun e vdekjes mbi rezultatet e veprimeve të mësipërme. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 15.01.2012, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2007, duke arsyetuar se në tërësinë e fakteve të mbledhura, nuk ka asnjë lloj prove ligjore që të vërtetojë faktin se dëmtimet e znj. F. H. janë shkaktuar nga një aksident automobilistik.

**22.2.** Komisioni, bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, ka kërkuar prej subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë lidhur me: (i) veprimet konkrete të kryera përgjatë hetimit të çështjes (duke depozituar kopje të akteve procedurale të administruara në fashikullin penal), zgjatjen e hetimeve (mbi tre muaj) për një vit deri në vendimmarrjen e parë të vitit 2010 dhe për 4,5 muaj deri në vendimmarrjen e datës 25.01.2012; (ii) arsyet e mosmarrjes në pyetje të shtetasit F. S., pasi duket se është një nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë në këtë çështje penale (për shkak të detyrave të lëna prej gjykatës); (iii) përse nuk ishte pyetur (nuk janë marrë deklaratime) shkaktari i dyshuar i aksidentit automobilistik, A. B., sikurse përmend denoncuesi se ka qenë ky shtetas; (iv) nëse ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal të vitit 2012, është ushtruar ankim dhe cili është statusi aktual i tij.

**22.3.** Në shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: (i) Lidhur me zgjatjen e hetimeve mbi 3 muaj – nuk ka pasur arsye të marrë vendim për zgjatje të hetimeve sipas nenit 324 të K.Pr.Penale, veprim që lidhet me regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale, ndërkohë prej tij nuk është përpiluar asnjë urdhër i tillë. (ii) Lidhur me ecurinë e hetimit – procedimi penal është marrë prej tij më datë 11.06.2009, sipas shënimit të zv/drejtuesit të prokurorisë; në datën 08.10.2009, është përpiluar urdhri për kryerje të veprimeve hetimore për të cilat është ngarkuar OPGj-ja; pas relacionit të OPGj-së më datë 29.11.2009 dhe sjelljes së akteve në prokurori me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.12.2009, prej tij, më datë 29.03.2010, është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor me grup ekspertësh, në zbatim të të cilit është kryer ekspertimi mjeko-ligjor me nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2010. Më datë 31.03.2010, është përpiluar një urdhër tjetër për kryerje të veprimeve hetimore, marrje informacioni nga DRSHTRR Tiranë, pyetje të disa shtetasve. Pasi janë kryer veprimet hetimore dhe materialet janë sjellë në prokurori me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2010, në datën 25.05.2010 është vendosur pushimi i çështjes dhe është përpiluar shkresa nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2010, për njoftimin e këtij vendimi shtetasit F. H. Pas mbërritjes në prokurori të vendimit të formës së prerë të gjykatës, i cili i është kaluar për veprim më datë 5.09.2010, janë kryer disa veprime të tjera hetimore lidhur me pyetjen e disa shtetasve, dhe në datën 12.01.2012 është vendosur pushimi i çështjes, i cili i është njoftuar shtetasit F. H. në adresën e tij në ShBA, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë

02.02.2012. (iii) Lidhur me mosmarrjen në pyetje të shtetasit A. (A.) B. si autor i dyshuar i aksidentit – subjekti ka shpjeguar se pyetja e tij nuk është bërë e mundur pasi sipas informacioneve zyrtare, kishte dalë nga territori i vendit më datë 1.08.2009, pa u kthyer më, dhe nga verifikimi aktual në sistemin TIMS, rezulton që pas vitit 2008, për herë të parë ka hyrë në Shqipëri më datë 13.08.2013, pasi ishte pushuar procedimi penal. (iv) Lidhur me pyetjen e shtetasit F. S., subjekti ka shpjeguar se rezulton i pyetur nga OPGj-ja më datë 04.11.2009, i cili në deklaram ka pohuar se: *nuk ka parë ndonjë makinë aty pranë në momentin e rrëzimit*, dhe se: *F. ishte e moshuar dhe ka rënë disa herë nga shkallët*. (v) Subjekti ka parashtruar se ka bërë hetime të plota, ka pranuar çdo kërkesë të kallëzuesit për kryerje veprimesh hetimore apo marrje provash, por pretendimet e tij kanë qenë kontradiktore, me fjalë të dëgjua apo sajuara që nuk kanë rezultuar të vërteta. Asnjë prej deklaruesve nuk jep ndonjë informacion me vlerë për hetimin, duke u justifikuar me shprehjet se “kam dëgjuar” apo se “flitet në lagje”, me të cilat është e pamundur që të ngrihet akuzë dhe, për këtë arsye, pushimi i çështjes për mungesë të provave ka qenë e vetmja zgjidhje e duhur.

**22.4** Në analizë të shpjegimeve të subjektit për veprimet hetimore të kryera, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar se: (i) çështja është regjistruar pa autor dhe ka mbetur e tillë, për pasojë subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor të zgjasë afatin e hetimit, e konteksti i zvarritjes së çështjes duket se nuk qëndron për kompleksitetin e hetimit; (ii) në vendimin e gjykatës nr. {\*\*\*} akti, datë 21.07.2011, nuk ishte lënë detyrë pyetja e shtetasit A. B., si i dyshuar për kryerjen e aksidentit, ndërkohë konstatohet që në vendimin e subjektit për pushimin e procedimit penal, të datës 25.05.2010, ishte pasqyruar informacioni që ky shtetas ndodhej jashtë vendit; (iii) të gjithë të pyeturit, të kërkuar prej denoncuesit për t’u pyetur, nuk kanë deklaruar se kanë qenë të pranishëm në vendngjarje, kanë deklaruar në forma dhe mënyra të ndryshme për rastin, sikurse dhe kishin dëgjuar, vëllai i denoncuesit nuk ishte në koherencë me të, dhe vetë denoncuesi kishte deklarime kontradiktore; (iv) denoncuesit i është njoftuar vendimi i datës 12.01.2012 për pushimin e procedimit penal, por nuk ka ushtruar ankim. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se në lidhje me hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat kanë rezultuar në vendimin për pushim, nuk vlerëson të penalizojë subjektin për faktin e rikthimit të çështjes për hetime të mëtejshme, për sa kohë rrethanat konkrete të çështjes nuk kanë prodhuar një situatë ku të detyrohej organi i akuzës të regjistronte emrin e personit dhe të ngrinte për të akuzën.

**22.5** Komisioneri Publik, lidhur me këtë shkak të ankimi, sjell në pah, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

(i) Subjektit të rivlerësimit i është caktuar kjo çështje në datën 11.6.2009 dhe ka bërë veprimin e parë hetimor vetëm pas 4 muajsh, konkretisht më datë 8.10.2009. Nga data 22.12.2009 deri në datë 28.03.2010, dhe për 3 muaj të tjerë, nuk ka hetuar dhe as ka nxjerrë ndonjë akt të motivuar për shtyrjen e hetimit.

(ii) Më datë 29.03.2010, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për të kryer ekspertimin mjeko-ligjor me grup ekspertësh, për të përcaktuar shkakun e vdekjes, kërkesë kryesore kjo e Prokurorisë së Përgjithshme, veprim i bërë 7 muaj pasi i është caktuar hetimi i çështjes.

(iii) Çështja është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, “Shkaktimi i vetëvrasjes”, ku në asnjë rast nuk rezultojnë fakte apo rrethana që të lidhen me këtë vepër penale.

(iv) Subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar të dyshuarin kryesor, me pretendimin që ai ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, nënvizon se qenia jashtë vendit e një subjekti me një status procedural të caktuar, nuk përbën një justifikim ligjor për moshetimin e plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste, gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

**22.5.1.** Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrroi se duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, vlerëson se rrethanat e rastit mbeten të njëjta si gjatë hetimit administrativ në Komision dhe duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në kriterin e aftësive profesionale, lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore sipas nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016.

**22.6.** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, për këtë shkak të ankimit, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar si vijon.

(i) Lidhur me zgjatjen e hetimeve, vlen i njëjti shpjegim si në rastet e procedimeve të tjera, objekt shqyrtimi, nuk ka pasur arsye pasi nuk ishte regjistruar emri i autorit të veprës penale dhe hetimet kryheshin së pari për të provuar nëse ekzistonte vepra penale apo jo.

(ii) Regjistrimi i procedimit për nenin 99 të Kodit Penal, është bërë nga një prokurore tjetër, sqaruar dhe e provuar me prova shkresore në Komision, duke depozituar dhe kopjen e urdhrin të regjistrimit. Pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të marrë nga prokurori i mëparshëm, i cili e kishte cilësuar si ngjarje aksidentale, hetimet, së pari, janë fokusuar në drejtim të vërtetimit të faktit nëse dëmtimet e shtetasës F. H. ishin rrjedhojë e një ngjarjeje automobilistike apo aksidentale, rrëzim nga shkallët. Vetëm pasi me prova të plota do të provohej se shtetasja ishte dëmtuar nga përplasja me një mjet, si rrjedhojë e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor të kryera nga drejtuesi i mjetit dhe, pas identifikimit të saktë të tij, në regjistrin e njoftimeve të veprave penale do të regjistrohej emri i autorit të veprës penale, dhe pas tre muajsh do të merrej vendimi për të zgjatur afatin e hetimit nëse do të ishte e nevojshme.

(i) Në të kundërt sa pretendohet lidhur me zvarritjen e hetimit të çështjes, prej tij rasti është vlerësuar maksimalisht, ka disponuar me dy urdhra për kryerjen e veprimeve hetimore, të datës 08.10.2009 dhe të datës 31.03.2010, disa prej veprimeve hetimore janë kryer prej vetë atij<sup>29</sup>.

---

<sup>29</sup> Subjekti ka referuar veprimet hetimore të kryera për këtë çështje:

- Në datën 08.10.2009, ka përpiluar urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGj-ja pranë Komisarariatit të Policisë nr. 6 Tiranë, i cili ka dokumentuar në procesverbale kryerjen e veprimeve hetimore të mëposhtme: (i) deklarin e shtetasit H. H. më datë 05.11.2009; (ii) deklarin e shtetasit F. S. më datë 04.11.2009; (iii) deklarin e shtetasit V. R. më datë 14.11.2009; (iv) këqyrje pranë INSTAT-it më datë 03.12.2009; (v) këqyrje në kartotekën e Spitalit Ushtarak, datë 29.10.2009; (vi) këqyrje marrje dokumentesh, datë 09.11.2009.
- Në datën 29.11.2009, OPGj-ja ka përpiluar relacionin, dhe me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.12.2009, janë sjellë aktet në Prokurori.
- Në datën 29.03.2010, ka marrë vendim për të kryer ekspertimin mjeko-ligjor me grup ekspertësh, në zbatim të të cilit është kryer akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2010.
- Në datën 31.03.2010, është përpiluar urdher tjetër për kryerje të veprimeve hetimore, në zbatim të të cilit: (i) është përpiluar shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2010, drejtuar DRSHTRR Tiranë, me të cilën kërkohet informacion për disa mjete, informacion i përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.04.2010; (ii) në datën 09.04.2010, janë pyetur shtetasit Xh. R., L. Y., P. M.; në datën 11.04.2010, është pyetur shtetasja E. G.; në datën 14.04.2010, është pyetur shtetasja B. M.; në datën 18.04.2010, është pyetur shtetasi A. B.; në datën 12.03.2010, është administruar pranë ZGJC-së të NJ. Bashkiake nr. 6 Tiranë, certifikata e vdekjes së shtetasit Nj. D., që duhej të merrej në pyetje.



(ii) Vendimi i tij për pushimin e çështjes, marrë më datë 25.05.2010, shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 21.07.2010, e cila ka vendosur dhe vazhdimin e hetimeve, duke lënë si detyrë pyetjen e shtetasve K. dhe A. B., Sh. Y. dhe F. S., si dhe ripyetjen e shtetasve Sh. Y. Vendimi i gjykatës i formës së prerë i ka kaluar për veprim më datë 05.09.2010, më pas ka kryer veprime të tjera hetimore<sup>30</sup>. Më datë 12.01.2012, ka vendosur pushimin e çështjes, vendim i njoftuar shtetasit F. H. në adresën e tij në ShBA<sup>31</sup>, i cili ka marrë dijeni dhe nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të pushimit, i cili konsiderohet përfundimtar.

(iii) Hetimet kanë qenë të plota dhe në asnjë rast nuk u provuan pretendimet e kallëzuesit, por të gjitha provat, si deklarimi i mjekut V. R. pa asnjë interes në çështje etj., të çonin në konkluzionin se rrëzimi i F. H. ishte aksidental. Prej Komisionerit Publik citohet në mënyrë të gabuar se: *nuk ka hetuar të dyshuarin kryesor, me pretendimin që ai ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë, në një kohë që në vendim ka konstatuar: ky shtetas (A. B.) nuk është bërë e mundur të pyetet për shkak se ndodhet jashtë shtetit, fakt që konfirmohet dhe nga të dhënat e sistemit TIMS, sipas të cilit A. B. ka dalë nga Shqipëria në datën 01.03.2008, nëpërmjet PKK Rinas. Lidhur me shkakun e pushimit të çështjes, në vendim është shprehur se: Në tërësinë e fakteve të mbledhura, nuk ka asnjë lloj prove ligjore që të vërtetojë faktin se dëmtimet e F. H. janë shkaktuar nga një aksident automobilistik. Në rast se do të ishin mbledhur prova për fajësinë e këtij shtetasi, do të ishte proceduar në mungesë, si ka bërë në shumë çështje të tjera.*

**22.7** Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, *së pari*, trupi gjykues vlerëson se qëndron konstatimi lidhur me kohëzgjatjen e kryerjes së veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, që tregon se trajtimi i çështjes nuk ka pasur ritmin e duhur. Në këtë kontekst, rezulton se në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 08.10.2009, veprimi i parë i kryer pasi çështja i ka kaluar më datë 11.06.2010, subjekti duket se ka pasqyruar detyrat e lëna në vendimin e datës 29.05.2009, për rihetimin e kësaj çështjeje. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, konsumimi i një periudhe 4-mujore për nxjerrje të një urdhri për kryerje të veprimeve hetimore të urdhëruara, tregon mungesë efikasiteti në kryerjen e procedurave hetimore. Të njëjtin vlerësim ndan trupi gjykues për periudhën nga data 22.12.2009, kur mbërrijnë aktet në prokurori nga policia gjyqësore, pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara, deri më datë 28.03.2010, gjatë së cilës nuk evidentohet kryerja e asnjë veprimi hetimor prej subjektit të rivlerësimit.

**22.8** Trupi gjykues konstaton se qëndron pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me marrjen e vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor me grup ekspertësh për të përcaktuar shkakun e vdekjes, shtatë muaj pasi çështja i ishte caktuar subjektit, ndërsa ky urdhërim ishte pjesë e detyrave të lëna sipas vendimit të prokurorit më të lartë. Kjo situatë ka prodhuar një shtyrje të mëtejshme të hetimeve, duke qenë se subjekti ka urdhëruar kryerjen e aktit mjeko-ligjor në datën 29.03.2010, pasi veprimet hetimore të urdhëruara në datën 18.10.2009, duket se ishin kryer prej policisë gjyqësore.

---

*Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2010, janë sjellë materialet në Prokurori.*

<sup>30</sup> *Marrjen e deklaramëve të disa shtetasve të dokumentuar në procesverbalet përkatëse: të shtetasve K. B. më datë 16.11.2011; të shtetasve N. D. më datë 10.11.2011, të shtetasve Sh. S. më datë 04.11.2011.*

<sup>31</sup> *Përpiluar shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.02.2012.*

**22.9** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për mungesë të ndonjë akti të motivuar për shtyrjen e hetimit, trupi gjykues risjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në paragrafin 21.8 të këtij vendimi lidhur me një pretendim të së njëjtës natyrë në çështjen e procedimit nr. {\*\*\*} të vitit 2014, duke potencuar qëndrimin se pretendimi për marrjen e një vendimi që zgjat afatin hetimor, nuk ishte i zbatueshëm në rrethanat konkrete të rastit, përderisa nuk kishte një emër të regjistruar në regjistrim e njoftimeve të veprave penale që të kushtëzonte ecjen e një afati hetimor. Përmendja prej subjektit e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar<sup>32</sup>, duket se ligjëron diskrecionin e prokurorit lidhur me momentin e shënimit të emrit të personit të dyshuar në regjistrin përkatës, diskrecion i cili rezulton të përcillet edhe prej frymës së dispozitave procedurale, por edhe prej qëndrimeve të mbajtura deri më sot nga jurisprudenca e gjykatave të vendit. Në këtë kuptim, duke konstatuar se prej Komisionerit Publik nuk është ngritur ndonjë pretendim lidhur me mosregjistrimin në regjistër të emrit të ndonjë personi të dyshuar, dhe duke konsideruar se ky është një atribut diskrecional i prokurorit të çështjes, i cili është relevant me pjesën vijuese të hetimit, trupi gjykues e vlerëson si një moment konstatues, i cili zhvesh nga përgjegjësia subjektin e rivlerësimit për sa i përket pretendimit për mosmarrjen e vendimeve për zgjatje të afatit të hetimit, për sa ky afat nuk kishte filluar të ecte sipas ligjit.

**22.10** Lidhur me regjistrimin e njoftimit për këtë ngjarje nën kualifikimin e veprës penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, “Shkaktimi i vetëvrasjes”, trupi gjykues çmon se gjendet i paarsyeshëm dhe pa relevancë me rrethanat e njoftuara të faktit, ashtu siç edhe pretendon Komisioneri Publik. Pavarësisht këtij vlerësimi, përderisa rezulton se ky kualifikim dhe regjistrimi i këtij procedimi penal, sipas tij, është kryer nga një tjetër prokuror dhe për shkak të nevojës së referimit të regjistrimit fillestar të kryer, subjekti vetëm e ka risjellë atë në aktet e tij të mëpasshme, pa bërë ai vetë një vlerësim lidhur me të, trupi gjykues nuk vlerëson se përgjegjësia për kualifikim të gabuar duhet t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit.

**22.11** Lidhur me mospyetjen e shtetasit A. B., *së pari*, trupi gjykues konstaton se nga analiza dhe arsyetimi i vendimit të pushimit të procedimit penal, rezulton që ai të jetë marrë bazuar në një vlerësim të të gjitha të dhënave të përfuara prej hetimit, pas një procesi tipik analitik, bazuar edhe në logjikën individuale dhe bindjen e prokurorit. Nga aktet e administruara në dosje, rezultojnë një sërë veprimesh hetimore të kryera, nga të cilat nuk duket se ka rezultuar ndonjë e dhënë që përcaktonte faktet në një mënyrë të ndryshme nga ajo që ka bërë subjekti i rivlerësimit. Insistimi i vazhdueshëm i djalit të së ndjerës, z. F. H., duket se lidhet me perceptimin/bindjen e tij për një aksident automobilistik si shkak për humbjen e jetës së nënës së tij, por që nuk ka rezultuar e mbështetur nga të dhënat që kanë dalë prej hetimit. Pretendimi se shtetasi A. B. nuk është pyetur megjithëse ai ishte i dyshuari kryesor i ngjarjes, vlerësohet nga trupi gjykues si i pambështetur në ligj e në faktet që kanë rezultuar prej hetimit. Deklarimi si i dyshuar i një personi, apo atribuimi i veprës penale ndaj dikujt, i pambështetur në prova, nuk i jep automatikisht atij statusin e personit të dyshuar, status procedural i cili merret vetëm

---

<sup>32</sup> Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, në pikën 3.1 parashikon: “Në rastet e kallëzimeve, fillimisht regjistrohet njoftimi për veprën penale nëse janë kushtet e pikës 2. Pasi administrohen akte procedurale që i atribuojnë kryerjen e veprës penale personit, prokurori merr vendim për regjistrimin e emrit. Përmendja e emrit të një personi në kallëzim, nuk mund të shërbejë për regjistrimin e menjëhershëm të emrit në regjistër, pa u administruar më parë akte procedurale në të cilat gjenden burime për personin konkret”.

pas vendimit të prokurorit të çështjes për regjistrimin e emrit të tij në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Ky moment procedural konsiderohet si tepër i rëndësishëm, pasi, referuar dispozitave procedurale, ai lidhet me një sërë të drejtash dhe detyrimesh që i burojnë shtetasit, barazuar me ato që gëzon i pandehuri në procesin penal sipas nenit 34/a të K.Pr.Penale. *Së dyti*, nga kjo analizë nuk rezulton se pyetja/mospyetja e këtij shtetasi ka kushtëzuar vendimmarrjen e subjektit, e cila bazohet në të dhënat e tjera që janë konsideruar të mjaftueshme për arritjen e marrjes së një vendimi. Për pasojë, edhe në këtë rast, thirrja për ndihmë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, nuk konstatohet se do të kishte një vlerë të shtuar mbi hetimin, aq më tepër kur denoncuesi pretendon se ky individ ishte personi i dyshuar për ngjarjen, rrethanë e cila nuk sugjeron për deklarime të tij për vetëpërgjegjësi apo kontribut të vlefshëm për hetimin.

**22.12** Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2007, trupi gjykues vlerëson se periudhat për të cilat rezulton moskryerje e veprimeve hetimore që kanë ndikuar në ritmin e kryerjes së procedurave hetimore, të vetme, janë të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka dëshmuar mangësi të aftësive organizative në kuptim të parashikimeve të nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Për sa provohet se subjekti ka përmbushur indikatorët e tjerë të përcaktuar në këtë parashikim, si kryerjen e veprimeve hetimore dhe mbledhjen e provave të nevojshme, nuk mund të konkludohet në mënyrë bindëse se subjekti ka ceduar në kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore.

- 23** Lidhur me denoncimin e shtetasit V. M., i cili pretendon për zvarritje dhe shkelje të rënda të procedurës nga ana e subjektit të rivlerësimit, në procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2019, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë, lidhur me këtë procedim penal, janë të tilla që nuk duhet të ishin transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me këtë shkak të ankimit, trupi gjykues konstaton si vijon.

**23.1.** Denoncuesi V. M., në denoncimin e tij<sup>33</sup> ankohet mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2019, i cili i referohet veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Sipas denoncuesit, në takimin e datës 16.01.2020 me palën e interesuar, subjekti ka shfaqur qëndrimin se veprimet e kallëzuara në përmbajtje të materialit kallëzues, nuk përmbajnë elemente të veprës penale. Denoncuesi pretendon se ka kërkuar përjashtimin e prokurorit, se nuk është pajisur me aktet e dosjes dhe kopje të vendimit të mosfillimit të këtij procedimi, duke penguar e vonuar qëllimisht kundërshtimin e vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit.

**23.2.** Nga verifikimi i denoncimit, Komisionit i ka rezultuar se bazuar në referimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, më datë 11.12.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. {\*\*\*} për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”<sup>34</sup>, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin me vendimin e datës 18.01.2020. Bashkëlidhur denoncimit, nuk rezultonte i paraqitur vendimi i mosfillimit të

<sup>33</sup> Denoncim nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 09.07.2021, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>34</sup> Sipas vërtetimit të datës 16.01.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

procedimit penal. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit<sup>35</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe dokumentuar se për kallëzimin nr. {\*\*\*}/2019, regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga Drejtoria e Policisë Tiranë, ka marrë vendim mosfillimi më datë 18.01.2020, kundër të cilit ka bërë ankim shtetasi V. M. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*} regj., datë 03.03.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës së shtetasit V. M. Komisionit i ka rezultuar, se ndryshe nga sa pretendon denoncuesi, ka ushtruar ankim dhe më tej ka vijuar procesi gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit.

**23.3.** Në vijim, bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>36</sup>, subjektit i është kërkuar të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e konstatimeve lidhur me: (i) marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal në tejkalim të afatit ligjor; (ii) bazuar në nenin 291 të K.Pr.Penale, ku thuhet se prokurori duhet t'i njoftojë menjëherë vendimin e mosfillimit kallëzuesit/ve, vendimi i mosfillimit është njoftuar në tejkalim të parashikimit ligjor [pas 10 ditëve të marrjes së vendimit], shkresa e prokurorisë për njoftimin e z. M. mban datën

---

<sup>35</sup> Me pyetësorin e datës 4.04.2023.

<sup>36</sup> Në gjetjen e datës 26.06.2023, vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur fakte dhe rrethana si vijojnë: “Më datë 11.12.2019, Prokuroria ka regjistruar kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, bazuar në kallëzimin e Seksionit kundër Pastrimit të Parave të DVP Tiranë, për pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, sipas nenit 287 të Kodit Penal. Policia iu referua informacionit mbi një kontratë dhurimi të pjesëve takuese të pasurisë së paluajtshme, të datës 2 tetor 2018, nga tre shtetas për një shtetas tjetër. Policia konstatoi se nuk kishte asnjë lidhje mes palëve në kontratë për të justifikuar dhurimin. Ndërsa gjatë muajit dhjetor 2018 - janar 2019, bashkëshorti i njëres prej dhuruesve (B.K) kishte depozituar në llogarinë e tij disa shuma parash, përafërsisht 45.000 euro. Sipas policisë, natyra reale e kontratës duhet të ishte ajo e shitjes. Policia ka dhënë gjithashtu informacione për disa transaksione bankare të dhuruesve, informacion për pasuritë e tyre të paluajtshme dhe informacion nga sistemi TIMS. Bazuar në sa më sipër, policia kërkoi fillimin e procedimit penal ndaj këtyre personave për pastrim të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale.

Më datë 18.1.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak të mungesës së bazës ligjore. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia nuk i referohej veprimtarisë kriminale apo veprës penale që gjeneronte paratë në fjalë. Referimi nga policia për “kontratën e shitjes së hartuar në formë dhurimi për arsye të panjohura”, sipas subjektit të rivlerësimit, ishte krejtësisht i pamjaftueshëm për të pasur dyshimin më të vogël të mundshëm për ekzistencën e veprës penale për fillimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit iu referua nenit 293, “Referimi i veprës penale në prokurori”, të K.Pr.Penale, sipas të cilit: “[...] policia gjyqësore [...] i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra”.

Sipas subjektit të rivlerësimit, policia nuk ka respektuar këtë dispozitë, nuk ka paraqitur asnjë element apo fakt apo hap hetimor për të provuar veprimtarinë kriminale që ka gjeneruar cash-in. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia gjyqësore duhet të veprojë me iniciativë për verifikimin e fakteve dhe fillimin e procedimit penal dhe referimin e faktit në Prokurori.

Subjekti i rivlerësimit iu referua edhe një rrethane tjetër që nuk lejonte fillimin e procedimit penal, konkretisht një vendimi të mëparshëm të Prokurorisë për të mos hetuar një kallëzim penal nga z. M., të datës 14.01.2019, për një kontratë dhurimi të pavlefshme sipas procedurës civile. Prokuroria arsyetoi në atë kohë (shkurt 2019) se kontrata e dhurimit, në thelb, duke qenë shitje, nuk përbënte vepër penale, nuk mund të cilësohej si e falsifikuar dhe mund të shfuqizohej nga një gjykatë civile.

Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit arsyetoi se nuk mund të fillonte procedimin pasi ishte vendosur tashmë nga Prokuroria për këtë fakt dhe pasi fakti i referuar nga policia gjyqësore nuk përmbante elementet e domosdoshme të veprës penale. Ai e bazoi vendimin e tij në nenet 290/1/e dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. I pyetur nga Komisioni për të dhënë shpjegime, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një kopje jo të plotë të vendimit të tij dhe një kopje të një vendimi gjyqësor në lidhje me çështjen. Gjykata, me sa duket, ka refuzuar ankimin e z. M. kundër vendimit për mosfillim e hetimit. Gjykata e refuzoi kërkesën, pasi z. M. u tërhoq nga ankimi, pasi synonte të bënte një tjetër kallëzim penal më konkret për këtë çështje.

28.10.2020; (iii) nuk përbën bazë ligjore për mosfillimin e procedimit penal, fakti që policia gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin/veprën ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, siç pretendon subjekti i rivlerësimit; (iv) subjekti ka neglizhuar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, që konsiston të paktën në evazion fiskal të mundshëm nga ana e palëve, mosdeklarim të të ardhurave, duke lënë mënjanë edhe pastrimin e të ardhurave nga vepra penale; (v) duket se kallëzimet e z. M. kanë adresuar dy vepra penale të ndryshme. Në rastin objekt hetimi, çështja është adresuar për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale sipas nenit 287 të Kodit Penal, për pasojë duket se ky kallëzim nuk mund të quhej i njëjtë apo i ndërvarur me kallëzimin e mëparshëm, datë 14.01.2019, ku akuza e kallëzuesit referonte veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

**23.4.** Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka shpjeguar si vijon.

(i) *Lidhur me gjetjen për njoftim tej afatit ligjor të vendimit të mosfillimit:* denoncuesi nuk gëzon cilësitë e “kallëzuesit”, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale. Kallëzimi është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë (në vijim “DVP Tiranë”). Nisur nga ky fakt, nuk ka pasur arsye t’ia komunikojë vendimin këtij shtetasi brenda 10 ditëve, nuk i ka cenuar atij asnjë të drejtë. Komunikimi i vendimit këtij shtetasi nga prokuroria më datë 28.01.2020, është bërë me kërkesë të veçantë të tij, të cilën ia ka pranuar si “person i interesuar”, por jo me cilësinë e kallëzuesit. Pikërisht për të shmangur rrëzimin e ankimit që kishte bërë në gjykatë për mungesë të legjitimitimit për të bërë ankim, ky shtetas hoqi dorë nga ankimi duke pretenduar se do të paraqiste një kallëzim tjetër në prokurori. Vendimin ia ka njoftuar policisë gjyqësore me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.01.2010, për ta njohur me vlerësimin që ka bërë për referimin e tyre. Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave, ku shtetasi M. pretendon se ka bërë kallëzim, në kuptim të nenit 238/2 të K.Pr.Penale, nuk gëzon atributet e organit ku shtetasi mund të drejtohet për të bërë kallëzim, për rrjedhojë lidhur me këtë kallëzim, ky shtetas nuk është subjekt dhe nuk gëzon të drejtat që i njeh neni 291/2 K.Pr.Penale.

(ii) *Lidhur me gjetjen se kallëzimet e z. M. kanë adresuar dy vepra penale të ndryshme, për pasojë duket se kallëzimi në rastin objekt hetimi, nuk mund të quhej i njëjtë apo i ndërvarur me të mëparshmin,* subjekti ka shpjeguar se çështja në thelb është një konflikt familjar që lidhet me mosdakordësinë për mënyrën e administrimit të një prone në bashkëpronësi të ndodhur në Durrës, mes V. M. dhe motrave të tij, V. C. dhe V. K., të cilat kanë lidhur një kontratë dhurimi me shtetasin K. M., për dhurimin e pjesëve takuese të tyre në këtë pronë. V. M. ka pretenduar se kontrata është fiktive dhe, në të vërtetë, ka qenë kontratë shitjeje, pasi mes palëve nuk kishte asnjë marrëdhënie që të motivonte dhurimin. Nga organi i prokurorisë, në dy kallëzime penale të bëra prej familjes M., është vlerësuar se ky veprim nuk përbën vepër penale, por konflikt civil, dhe është vendosur mosfillimi i procedimit, vendime këto të lëna në fuqi dhe nga gjykata<sup>37</sup>. I njëjti fakt, në mënyrë identike, është

---

<sup>37</sup> *Lidhur me kallëzimet e mëparshme të trajtuara prej prokurorisë, subjekti ka parashtruar:*

- *Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2019, sipas referimit të policisë gjyqësore lidhur me kallëzimin e datës 11.01.2019, të shtetases L. M. (bashkëshortja e V. M.) ndaj noterit S. Sh., V. C., V. K. (motrat e bashkëshortit të saj) dhe K. M., duke pretenduar se këta shtetas kishin kryer veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, lidhur me “kalimin*

referuar nga policia gjyqësore e DVP Tiranë: *dyshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitjeje të hartuar në formën e një kontrate dhurimi për arsye të panjohura, duke mos vënë në dispozicion asnjë informacion për lëvizje parash jashtë sistemit bankar, përveç disa veprimeve rutinë (shkresa ku kërkohet informacion për pasuritë e personave të kallëzuar), veprime hetimore të parakohshme për sa kohë nuk ishte saktësuar nëse ekzistonte apo jo fakti penal. Sado të ndryshohet emërtimi apo cilësimi ligjor i faktit dhe pavarësisht se nga cili vjen, qytetar/polici gjyqësore/institucion shtetëror, në thelb jemi para një kallëzimi “de facto” të kryer për të tretën herë nga bashkëshortët M. për të njëjtin fakt dhe parimi i “gjësë të gjykuar” e ndalon nisjen e hetimit. Për faktin e referuar, në mënyrë të përsëritur nga prokuroria dhe gjykata është konstatuar se nuk përbën veprë penale. Duke qenë se nuk ekziston asnjë veprimtari kriminale apo fakt penal, për rrjedhojë nuk mund të ketë veprë penale në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal.*

(iii) Lidhur me gjetjen: *nuk përbën bazë ligjore për mosfillimin e procedimit penal, fakti që policia gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin/veprën ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, subjekti ka shpjeguar se është deformuar thelbi i argumentit për mosfillimin e procedimit. Në vendim nuk flitet për punë të dobët të policisë, apo se ka qenë ky shkaku që ka vendosur mosfillimin, por ka konstatuar faktin se: nuk është vënë në dispozicion asnjë e dhënë, nuk është kryer asnjë veprim hetimor, apo informacion mbi elementet thelbësore të faktit.*

(iv) Lidhur me gjetjen për evazion fiskal të mundshëm, subjekti ka shpjeguar se nuk

---

*pa na pyetur në të pjesës së tyre komshiut K. M.”.*

*Për këtë kallëzim, në datën 11.02.2019, nga prokurorja S. M. është vendosur mosfillimi i procedimit, mbështetur në nenin 290, germa “ç” e K.Pr.Penale, për shkakun se “nuk ekzistojnë elementet e veprës penale dhe pretendimet e kallëzueses janë të një natyre juridiko-civile, të cilat janë objekt i gjykatës civile”. Nga verifikimet e tij, rezulton se kundër këtij vendimi, shtetasja L. M. nuk ka bërë ankim.*

*- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. {\*\*\*}, mbi bazën e kallëzimit të datës 17.12.2018, të shtetasit V. M. ndaj shtetasve S. Sh., noter publik, V. C., V. K. dhe K. M., duke pretenduar se këta shtetas kishin kryer veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. [Kallëzimi është paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila e ka përcjellë për kompetencë tokësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë].*

- *Prokurori i çështjes G. H., në datën 27.02.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit sipas nenit 290/1/ç të K.Pr.Penale, duke vlerësuar se “fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale dhe është mosmarrëveshje juridiko-civile”.*
- *Vendimi i prokurorit është ankimuar nga V. M. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. {\*\*\*} regj., datë 07.06.2019, ka rrëzuar kërkesën e tij me arsyetimin se “konflikti i pretenduar është i natyrës administrative civile” dhe “vijimi i hetimeve nga organi i Prokurorisë do të shërbente si mjet që palët në konflikt të siguronin prova në funksion të konflikteve civile, administrative etj.”. Në këtë vendim, konstatohet që ky kallëzim ishte bërë më parë nga shtetasja L. M., bashkëshortja e V. M., në DVP Tiranë, që e kishte referuar në Prokurorinë e Tiranës, e cila në datën 11.02.2019 kishte vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin e V. M. me nr. {\*\*\*}, dhe se “çështja për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. {\*\*\*} i vitit 2019 është e njëjtë me çështjen konkrete që po gjykon gjykata (me nr. {\*\*\*} e vitit 2019), duke e konsideruar këtë rast si “gjë të gjykuar”.*
- *Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ankimuar nga shtetasi V. M. në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2019, të Gjykatës së Shkallës të Parë Tiranë, duke konstatuar, ndër të tjera, se: “nga aktet e dosjes dhe pretendimet e ankueses, nuk rezulton ndonjë veprimtari e kundërligjshme e të kallëzuarve dhe shoqërisht e rrezikshme e cila plotëson elementet e ndonjë figure të veprës penale”, dhe se: “Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë e ka orientuar ankuesen që pretendimet e tyre që kanë të bëjnë me të drejtën subjektive të pronësisë, mund të shqyrtohen nga një gjykatë civile mbi bazën e një padie [...]”.*

qëndron. Sipas legjislacionit shqiptar, dhurimi i pasurive të paluajjtshme tatohet njësoj si shitja, pra nga ana e dhuruesve është paguar tatimi sipas referencës së zonës ku ndodhet pasuria, në rast të kundërt, AShK-ja nuk bën kalimin e pasurisë nga dhuruesi te përfituesi i dhurimit.

(v) Lidhur me gjetjen *se vendimi është marë në tejkalim të afatit 15 ditor të përcaktuar në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale*, subjekti ka pranuar që qëndron, ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe dhe rritjes së saj tej normales në fund të vitit, shkelje që mendon se duhet vlerësuar në kuadër të parimit të proporcionalitetit.

**23.5** Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni: (i) ka çmuar të argumentuara dhe të bazuara ligjërisht pretendimet e subjektit lidhur me çështjen e njoftimit të mosfillimit të procedimit penal; (ii) ka konsideruar të së njëjtës natyrë hetimin e çështjes nga prokurorë të tjerë për të njëjtën veprë penale, “Falsifikim i dokumenteve”, por referimi i adresuar në këtë rast, duket se i përket veprës penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal, edhe pse policia gjyqësore duket të jetë mjaftuar me kërkimin e denoncuesit pranë DIPPP-së, duke vënë shkresën e saj në dispozicion të organit të akuzës, pa investiguar vetë si referues i çështjes lidhur me të dhënat e administruara. Policia gjyqësore ka referuar vetëm dyshimin se kontrata është fiktive, por në vërtetimin e datës 16.01.2020 të organit të akuzës, depozituar nga denoncuesi, thuhet se materiali i policisë është regjistruar për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, për të cilën është vendosur mosfillimi; (iii) për shkak të konstatimit se denoncuesi ka qenë në përpjekje të vijueshme institucionale për të pasur informacion të thelluar lidhur me veprimet fiktive të pretenduara në pronën objekt konflikti deri në organin e akuzës, vënien e rivënien në lëvizje të çështjes, të disa kërkimeve të rezultuara nga organi referues në institucione, Komisioni nuk ka vlerësuar rolin e referuesit të kallëzimit si determinant në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, duke çmuar se çështja mund të ishte hetuar duke vlerësuar nën dritën e nenit 293/1 të K.Pr.Penale, dhe jo të mos fillohej nën dritën e “gjësë së gjykuar”. Për një konkludim më të plotë të çështjes dhe në kushtet e ndalimit për zëvendësim logjik të subjektit në vendimmarrje, pa i hyrë themelit të çështjes në diskrecion të prokurorit, Komisioni vlerësoi që ky rast t’i kalojë për shqyrtim të mëtejshëm organit kompetent.

**23.6** Komisioneri Publik, lidhur me këtë shkak të ankimit, sjell në pah si vijon.

(i) Lidhur me statusin e V. M., nga aktet e administruara në dosje, rezulton e provuar se procedimi penal, pavarësisht se është referuar si informacion nga DVP Tiranë, ka si bazë kallëzimin e V. M., dhe kërkesat e vazhdueshme të tij në disa institucione, fakt i pranuar nga subjekti. Ky shtetas duket se ka marrë dijeni për mosfillimin e procedimit më datë 28.01.2020, pas kërkesës së tij më datë 18.01.2020 *për zëvendësimin e prokurorit të çështjes/subjektit të rivlerësimit*, drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(ii) Nga aktet e administruara nuk duket se kallëzimet penale të përsëritura të V. M. janë “gjë e gjykuar”, për sa kohë u referohen veprave të ndryshme penale.

(iii) Materiali i përcjellë nga DVP Tiranë duket se kishte informacione dhe të dhëna të mjaftueshme për transaksionin dhe natyrën e dyshimtë të burimit, të cilat duhet të shërbenin si indicie për verifikime të mëtejshme gjatë periudhës (nëntor 2009 - janar 2020) që subjekti ka shqyrtuar çështjen. Kualifikimi i saktë i veprës penale është kompetencë e prokurorit, sikundër dhe fillimi i procedimit penal, dhe jo e policisë gjyqësore sikundër pretendon subjekti.

(iv) Fakti që policia gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin penal ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, siç pretendon subjekti, nuk përbën shkak ligjor të arsyeshëm për mosfillim procedimi.

(v) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e evazionit fiskal, *pasi sipas legjislacionit dhurimi i pasurive tatóhet njëlloj si shitja*, nuk qëndron pasi në të dyja rastet ndryshon vlera mbi të cilën llogaritet tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë, në varësi të referencës në rastin e kontratës së dhurimit me çmimin real të shitjes.

**23.6.1** Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrroi se referuar akteve të paraqitura prej subjektit me parashtrime, dhe të administruara në cilësinë e provës nga Kolegji, shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2024, duket se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me vonesë në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, referuar si datë të fillimit të afateve momentin kur kallëzimi është marrë në dorëzim prej tij, më datë 14.1.2020. Duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik ritheksoi qëndrimin për vlerësimin nga Kolegji të gjetjeve së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**23.7** Lidhur me sa pretenduar prej Komisionerit Publik, në parashtrime dhe në seancë gjyqësore në Kolegji, subjekti i rivlerësimit prapësoi:

**23.7.1** Lidhur me statusin e denoncuesit V. M. në këtë procedim penal, me të njëjtat argumente si në Komision [shih pikën 23.4/i më lart në këtë vendim], ritheksoi se sipas parashikimit të nenit 291/2 të K.Pr.Penale, në kallëzimin nr. {\*\*\*}/2019, ky shtetas nuk gëzon cilësi të subjekteve të këtij procedimi penal.

**23.7.2** Lidhur me pretendimin se kallëzimet penale të përsëritura të V. M. nuk duket se janë “gjë e gjykuar” për sa kohë u referohen veprave të ndryshme penale, duke shtjelluar të njëjtat argumente si në Komision [shih pikën 23.4/ii dhe poshtëshënimin 37 më lart në këtë vendim], subjekti potencoi edhe duke u mbështetur në aktet e paraqitura si provë në Kolegji. Konkretisht, referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2022, që ka lënë në fuqi vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2019, të Gjykatës së Shkallës të Parë Tiranë, i cili ka rrëzuar ankimin e shtetasit V. M. ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e tij nr. {\*\*\*}/201, subjekti i rivlerësimit citoi arsyetimin e Gjykatës së Apelit, “nga aktet e dosjes dhe pretendimet e ankueses nuk rezulton ndonjë veprimtari e kundërligjshme e të kallëzuarve dhe shoqërisht e rrezikshme, e cila plotëson elementet e ndonjë figure të veprës penale”, dhe se: “Gjykata e Shkallës të Parë më të drejtë e ka orientuar ankuesen që pretendimet e tyre që kanë të bëjnë me të drejtën subjektive të pronësisë, mund të shqyrtohen nga një gjykatë civile mbi bazën e një padie [...]”. Subjekti parashtrroi se përveç kallëzimit të V. M. me nr. {\*\*\*}/2018, kallëzimit të L. M. me nr. {\*\*\*}/2019, për të njëjtin fakt ka referuar seksioni kundër pastrimit të parave në DVP Tiranë në kallëzimin nr. {\*\*\*}/2020, referim i iniciuar nga shtetasja L. M. me ankesën në një platformë online të Këshillit të Ministrave, e të përcjellë DPPP-së dhe Policisë së Shtetit, e cila pa asnjë verifikim paraprak e ka referuar rastin në prokurori. Subjekti argumentoi se ky fakt provohet nga adresimi për shtetasen L. M. më datë 14.10.2019, i e-mail-it nga adresa elektronike e platformës [zyraebashkëqeverisjes@shqipëriaqëduam.al](mailto:zyraebashkëqeverisjes@shqipëriaqëduam.al), më datë 30.10.2019, e një shkresë nga Agjencia për



Bashkëqeverisje me Qytetarët, ku thuhet se ankesa e saj i ishte përcjellë Ministrisë së Financave, dhe nga DPPP-ja i ishte përcjellë një informacion Policisë së Shtetit. Gjithashtu, vetë kjo shtetase shkruan: “kam qenë unë që kam vënë në lëvizje DPPP dhe Policinë e Shtetit”. Referimi është identik si në dy kallëzimet e para, ku referohet se: “dysshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitjeje të hartuar në formën e një kontrate dhurimi për arsye të panjohura”, dhe prej tij është vendosur mosfillimi i procedimit për shkakun se “ky fakt nuk përbën veprë penale pasi ky fakt nuk është falsifikim. por një veprim që mund të shpallet nga gjykata si i pavlefshëm konform dispozitave të Kodit Civil, nisur nga fakti se vjen në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil mbi kontratën e dhurimit, neni 761 i Kodit Civil”, dhe se: “organi i prokurorisë është shprehur një herë me vendim mbi këtë fakt dhe se fakti i referuar nga policia gjyqësore nuk përmban elemente të domosdoshme të veprës penale”.

**23.7.3** Lidhur me pretendimet e Komisionerit Publik se të dhënat në materialin e referuar, që duhet të shërbenin si indicie për verifikime të mëtejshme; se nuk përbën shkak ligjor të arsyeshëm për mosfillimin e procedimit, mosdokumentimi plotësisht i faktit penal nga policia gjyqësore, apo lidhur me evazionin fiskal, subjekti parashtrori të njëjtat argumente si në përmbysje të barrës së provës në Komision, të pasqyruara gjerësisht më lart në këtë vendim [shih pikën 23.4/iii më lart në këtë vendim].

**23.7.4** Lidhur me afatin e marrjes së vendimit të mosfillimit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në Komision ka pohuar se është tejkalluar afati 15-ditor i përcaktuar në nenin 291/1 të K.Pr.Penale, si pasojë e ngarkesës në punë, referuar regjistrimit të kallëzimit më datë 12.11.2018 dhe vendimit për mosfillimin e procedimit penal të marrë më datë 18.01.2019, por pas verifikimit, i rezultoi se kallëzimi është tërhequr prej tij në datën 14.01.2019 dhe vetëm pas 4 ditësh, ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Rrethanat faktike tregojnë se tejkallimi i afatit ka ardhur për shkak të vonesës së dorëzimit të kallëzimit nga zyra e regjistrimit dhe jo prej tij, u shpreh subjekti.

**23.8** Lidhur me këtë shkak ankimi, referuar të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, si dhe provat e pranura prej Kolegjit, shpjegimeve dhe pretendimeve të palëve, trupi gjykues konstaton e analizon si vijon.

**23.8.1** Referuar shkresës së DVP Tiranë<sup>38</sup>, me lëndë “Dërgohen materiale për fillimin e procedimit penal”, janë përcjellë në prokurori materialet për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal për shtetasit B. K., V. K., V. C. dhe K. M., konkretisht: (i) informacioni i referimit të veprës penale, përpiluar prej OPGj-së Xh. S.; (ii) informacioni shkresor i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, se shtetasit e sipërcituar dhe fëmijët e tyre [lista mbyllet me nr. rendor 11] nuk figurojnë të regjistruar për veprimtari kriminale; (iii) informacioni shkresor i marrë nga DPSHTRR, se nga lista me 11 emra, automjet në pronësi kanë vetëm 3 prej tyre [K. dhe K. M. dhe K. C.]; (iv) informacioni shkresor dhe dokumentacioni nga AShK-ja lidhur me pasuri të paluajtshme në emër të B. e V. K. e dy fëmijëve të tyre, dhe në emër të V. C. e bashkëshortit dhe vajzës së tyre; (v) fotokopje të kërkesave të V. M.; (vi) printime nga sistemi TIMS. Në informacionin e përpiluar nga OPGj-ja, ndër të tjera referohet: [...] *Seksioni për Hetimin e Pastrimit të Parave, në Drejtorinë Vendore të Policisë, disponon informacion*

<sup>38</sup> Shkresa e DVP Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., datë 05.12.2019.

*lidhur me nënshkrimin e një kontrate dhurimi me nr. {\*\*\*}, datë 02.10.2018, mes palëve V. K., B. K. dhe V. C. në cilësinë e palës dhuruese, dhe shtetasit K. M. në cilësinë e pranuesit të dhurimit, me objekt pjesën takuese në pasurinë e paluajtshme nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, Z.K. {\*\*\*}, në Durrës. Nga të dhënat e siguruara nga ana jonë, dyshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitjeje, të hartuar në formën e një kontrate dhurimi, për arsye të panjohura, pasi midis palëve nuk rezultojnë lidhje të tilla që do të justifikonin këtë akt dhurimi. Pas lidhjes së kontratës së dhurimit më datë 02.10.2018, vërehen disa depozitime [45.000 euro] nga shtetasi B. K. në periudhën dhjetor 2018 - janar 2019, që mbështesin dyshimet për natyrën reale të kontratës së dhurimit. [...] bazuar në transaksionin e kryer linden dyshime mbi aktivitetin e këtyre shtetasve, dhe mbi burimin e shumave të depozituara dhe qëllimin e transferimit të tyre.*

**23.8.2** Referuar vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*/2019, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, arsyeton: [...] nga studimi i materialit, nuk ka bazë ligjore për fillimin e procedimit penal. Duke shqyrtuar referimin e bërë, nga policia gjyqësore nuk është bërë asnjë referim për veprën penale ose veprimtarinë kriminale nga janë gjeneruar këto të ardhura për të cilat është kryer hetim pasuror prej saj. Vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në çdo rast kryhet me dashje direkte nga personi që i ka siguruar të ardhurat nga një vepër penale ose një veprimtari kriminale konkrete, fakt që duhet të hetohet dhe provohet, dhe më pas i qarkullon ato duke fshehur origjinën e tyre me qëllim gëzimin e tyre si të ardhura të ligjshme. [...] Subjekti ka vijuar në vendim me argumente plotësuese që përgjithësisht identifikohen me shpjegimet dhe prapësimet që ai ka dhënë në këtë proces në lidhje me këtë çështje.

**23.8.3** Me vendimin nr. {\*\*\*} regj. themeltar, datë 03.03.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka pasur objekt *kërkesën e shtetasit V. M. kundër vendimit të prokurorit/subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019*, është vendosur mospranimi (pushimi) i kërkesës së paraqitur nga ankuesi V. M., për shkak se përfaqësuesja e ankuesit hoqi dorë nga gjykimi.

**23.8.4** Sipas vendimit nr. {\*\*\*} regj. themeltar, datë 07.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shqyrtuar kërkesën e shtetasit V. M., me objekt prishjen e vendimit të prokurorit G. H. për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, rezulton se kallëzuesi V. M. në kallëzim ka pretenduar se palët në kontratën e dhurimit, V. C., V. K. dhe K. M., kanë kryer një veprim juridik fiktiv pasi prona, objekt material i kësaj kontrate, nuk është dhuruar, por është shitur, se nuk është vënë në dijeni paraprakisht nga noteri për përpilimin e kësaj kontrate dhurimi, duke ia mohuar të drejtën e parablerjes së pjesëve takuese të dy kunatave meqenëse është bashkëpronar në të njëjtin objekt. Në vijim, pasi pasqyrohen veprimet e organit të akuzës për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, gjykata ka vlerësuar se kërkuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me të drejtat e tij të pronësisë së një objekti, veprimet e bashkëpronarëve, të noterëve etj. Në gjendjen që janë aktet, pretendimet nuk rezultojnë të kenë elemente të veprimeve apo mosveprimeve penale që duhet të hetohen nga ana e prokurorisë. Konflikti mes palëve është qartësisht i natyrës civile dhe/ose administrative, fakt i pretenduar jo vetëm nga palët në proces, por edhe i provuar nga ekzistenca e disa proceseve civile lidhur me këto pretendime. Gjykata në këtë procedim penal nuk mund t'u japë zgjidhje pretendimeve me natyrë civile, tregtare apo administrative, pasi do të kapërcente kompetencat e një gjykate me juridiksion penal. Mbështetur në këtë arsyetim, gjykata, bazuar

në nenin 291 të K.Pr.Penale, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit V. M. si të pabazuar në ligj.

**23.8.5** Rezulton se bashkëshortja e denoncuesit, L. M., ka paraqitur kallëzim për këtë fakt, i referuar prej policisë gjyqësore në prokurori, ku është regjistruar kallëzimi nr. {\*\*\*} në datën 24.01.2019. Për këtë kallëzim, prokurorja S. M., më datë 11.02.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit, mbështetur në nenin 290/ç të K.Pr.Penale, për shkakun se *nuk ekzistojnë elementet e veprës penale dhe pretendimet e kallëzueses janë të një natyre juridiko-civile, të cilat janë objekt i gjykatës civile*, vendim i cili nuk është ankimuar prej kallëzueses.

**23.9** Në kontekst të këtyre fakteve, trupi gjykues fillimisht mori në shqyrtim pretendimin lidhur me mënyrën e njoftimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal z. V. M. Thënë ndryshe, nëse subjektit të rivlerësimit i lindte detyrimi që t'i atribuonte shtetasit V. M. cilësinë e kallëzuesit, sipas parashikimit të nenit 283/2 të Kodit të Procedurës Penale, në rrethanat konkrete, ku materiali i referuar prej DVP Tiranë, i bazuar në materialin e përcjellë nga DPPP-ja, e cila nga ana e saj ka administruar kallëzimin/ankesën e paraqitur prej z. V. M. në adresën elektronike të strukturës së krijuar nga qeveria në emër të një plani për mirëqeverisjen, [zyraebashkëqeverisjes@shqipëriaqeduam.al](mailto:zyraebashkëqeverisjes@shqipëriaqeduam.al). *Së pari*, në këtë rast, ndryshe nga rastet e tjera të përshkruara më lart, z. V. M. rezultoi të ketë zgjedhur të ngrejë pretendimin e tij lidhur me hartimin e një kontrate dhurimi për të simuluar një kontratë shitjeje e për të shmangur atë nga gëzimi i së drejtës së parablerjes në një pronë të përbashkët, jo në organet që ushtrojnë ndjekjen penale po në struktura të tjera shtetërore. Për rrjedhojë të përdorimit të këtij mjeti ankimi, në kuptim të nenit 283/2 të K.Pr.Penale, denoncuesi në këtë rast nuk kualifikohet si kallëzues, për sa dispozita e sipërcituar dikton që një akt të konsiderohet si kallëzim, duhet të depozitohet pranë prokurorit ose oficerëve të policisë gjyqësore. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusi i subjektit kallëzues është i lidhur ngushtësisht me përgjegjësinë që shtetasit kanë për përdorimin e këtij mjeti sipas parashikimit ligjor dhe prodhon në vijim edhe të drejtat e tyre kundrejt veprimtarisë procedurale të kryer për shkak të kallëzimit të tyre, një prej të cilave është edhe ajo e parashikuar nga neni 291/2 i K.Pr. Penale<sup>39</sup>. Për sa më lart, ndonëse konstatohet se referimi i bërë prej policisë gjyqësore ka për bazë shqetësimin/ankesën e ngritur prej denoncuesit V. M., ky fakt nuk i jep këtij shtetasi cilësinë e kallëzuesit në kuptim të dispozitave të sipërreferuara, për pasojë nuk passjell detyrim ligjor për organin e akuzës për njoftimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Vetë shkakun për të cilin është hequr dorë nga ankimi kundër vendimit të prokurorit/subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2019, dhe dispozita e referuar – *për të paraqitur një kallëzim sipas kërkesave të nenit 283 të K.Pr.Penale* – tregon dijeninë e tij për mungesën e legjitimitetit për ngritje të pretendimeve lidhur me një vendim mosfillimi që nuk kishte pasur për verifikim kallëzimin e tij, por një referim të policisë gjyqësore.

**23.10** Lidhur me konstatimin e Komisionerit Publik se nga aktet e administruara nuk duket se kallëzimet penale të përsëritura të V. M. janë “gjë e gjykuar”, siç pretendon subjekti, për sa u referohen veprave të ndryshme penale, trupi gjykues, ndonëse vlerëson se parimi i “gjësë së

---

<sup>39</sup> Kodi i Procedurës Penale, në nenin 291, të titulluar “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, në pikën 2, parashikon: “2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”.

grykuar” është i lidhur ngushtësisht me procesin gjyqësor dhe jo atë verifikues apo hetimor, konstaton se në rastin konkret, të gjitha kallëzimet/prendimet e shtetasit V. M. dhe bashkëshortes së tij i referohen të njëjtit fakt, por të kualifikuar në mënyra të ndryshme në aktet e paraqitura. Në këtë kuptim, duke abstraguuar nga termi i përdorur, si “gjë e grykuar”, fakti se për të njëjtin pretendim, denoncuesit kishin marrë përgjigje edhe më parë prej disponimeve të prokurorëve të tjerë, por edhe të kontrolluar nga gjykata, në një rast, konstatohet se është i saktë dhe i vlefshëm si një argument shtesë për të mbështetur vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar arsyetimin për mosfillimin e procedimit penal në dy linja, ku së pari ka arsyetuar për mungesën totale të ndonjë elementi, fakti apo të dhëna në drejtim të të provuarit të ekzistencës së veprës penale që ka gjeneruar të ardhurat për të cilat hidhen dyshime se janë produkt i veprës penale sipas parashikimit të nenit 287 të Kodit Penal, fakt i cili evidentohet lehtësisht në informacionin për referimin e veprës penale, dhe në dokumentacionin shoqërues. Citimi në referim: *dyshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitjeje të hartuar në formën e një kontrate dhurimi për arsye ta panjohura*, duket të dëshmojë referimin e të njëjtit fakt sikundër në kallëzimin tjetër të depozituar nga ky shtetas po në vitin 2019, e për të cilin organi i akuzës ishte shprehur për mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2018, vendim i kontrolluar dhe lënë në fuqi edhe prej gjykatave, referuar këtu edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 24.03.2022, paraqitur si provë prej subjektit në Kolegj, dhe pranuar prej tij. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues konstaton se shtetasi V. M., në shkresën e datës 22.11.2019, drejtuar Prokurorisë Tiranë dhe Drejtorisë së Policisë Tiranë për marrje informacioni, referon *në vijim të kallëzimit të tyre për evazion fiskal dhe pastrim parash*, citon informacionin e marrë nëpërmjet portalit të bashkëqeverisjes lidhur me shkresën e DIPP-së nr. {\*\*\*}, datë 26.06.2019, referuar për ndjekje në Policinë e Shtetit, kërkon informacion nëse është regjistruar procedim penal lidhur me këtë çështje/emrin e prokurorit të ngarkuar me hetimin, dhe në fund sqaron me *post scriptum: Në thelb të kallëzimit, kam denoncuar se jemi përballë një evazioni fiskal dhe pastrim parash, duke qenë se është formuluar nga noteri S. Sh. dhe regjistruar nga ZVRPP Durrës një kontratë fiktive që mbulon një kontratë shitjeje, si dhe një qarkullim parash (të paguara në dorë në të zezë 75.000 euro, jashtë sistemit bankar. Për këto fakte kam depozituar si prova, së bashku me materialin kallëzues, dhe një CD me regjistrime ku të kallëzuarit pohojnë veprimet e kallëzuarit)*. Ky sqarim, si dhe fakti se CD-ja me biseda telefonike të regjistruara dhe incizime ishte paraqitur si provë në kallëzimet e mëparshme të këtij shtetasi, janë argumente shtesë për vlerësimin se kallëzimet/prendimet e shtetasit V. M. dhe bashkëshortes së tij i referohen të njëjtit fakt, por të kualifikuar në mënyra të ndryshme në aktet e paraqitura.

**23.11** Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit nuk është i detyruar të ndjekë kualifikimin ligjor të bërë në aktin e referimit të veprës penale nga policia gjyqësore, por duhet të bëjë ai vetë një përcaktim të saj, trupi gjykues, ndonëse e konfirmon këtë pretendim në nivelin teorik, konstaton se në rastin konkret, vendimi i mosfillimit, pavarësisht se ka elemente që duket se shprehin rezerva për materialin referues, është mbështetur në analizën e subjektit si prokuror i çështjes, se fakti i përcjellë për hetim, nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Vlerësimi i tij lidhet me analizën e rrethanave konkrete dhe nuk duket se vjen për shkak të mangësive të konstatuara në aktin e referimit të veprës, përcjellë nga policia. Ajo që në vendimin e subjektit të rivlerësimit pretendohet/ konsiderohet si një kritikë ndaj materialit

referues, vlerësohet se shpreh mosdakordësinë e tij me qëndrimin apo sugjerimin e bërë nga strukturat e policisë gjyqësore, lidhur si me faktet që referohen që, sipas vlerësimit, nuk janë penale, ashtu edhe me mungesën e një verifikimi apo hetimi paraprak për elementet thelbësore të figurës së veprës penale që referohet, si edhe me kualifikimin e ligjor të tyre. Këto qëndrime, si elemente diskrecionare të prokurorit që vlerëson një material referues, dhe duke abstruar nga pretendimet për konotacionin, pa dyshim hyjnë në kompetencën dhe të drejtën e prokurorit si për të mbajtur një qëndrim ndryshe nga policia, ashtu edhe për evidentimin e shkaqeve mbi të cilat mbështet ky qëndrim, qoftë në funksion të argumentit, por edhe në funksion të orientimit për strukturat e policisë gjyqësore për rastet e ardhshme.

**23.12** Lidhur me pretendimin për vlera të ndryshme fiskale për tatimin në rastet e dhurimit dhe shitjes, të cilat mund të kenë prodhuar shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore, element që do të duhej të vlerësohej nga subjekti, trupi gjykues konstaton se mbetet empirik përderisa nuk ekziston një kontratë shitblerjeje, e cila të kishte të përcaktuar çmimin e shitjes së pronës, mbi të cilin mund të bëheshin analiza të mëtejshme krahasimore me vlerën e referencës së përcaktueshme sipas një kontrate dhurimi, për të kuptuar nëse ka pasur elemente të ndonjë veprimtarie që ka synuar evazionin fiskal. Ajo që në thelb kanë konstatuar të gjithë magjistratët që kanë trajtuar pretendimet e këtij denoncuesi, rezulton se lidhet me kryerjen e një akti që ka synuar shmangien e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga një prej bashkëpronarëve të një prone, shkelje e ligjit e cila është parashikuar të zgjidhet nëpërmjet një konflikti civil dhe nuk është parashikuar të ngrihet në nivelin e një shkeljeje që passjell përgjegjësi penale.

- 24** Lidhur me pretendimin në ankim për humbje të një fashikulli penal të hetuar prej subjektit në vitin 2005, trupi gjykues vlerësoi se aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në gjykim<sup>40</sup>, i japin përgjigje shqetësimit të ngritur prej Komisionerit Publik, si në drejtim të faktit se kjo dosje hetimore ekziston, ashtu edhe të shkakut se përse ajo nuk është gjendur lehtësisht nga kërkimet e bëra prej Komisionit, si pasojë e një gabimi material në pasqyrimin e të dhënave të saj në regjistrat përkatës, nga nëpunësit që kryejnë veprimtari administrative në institucionin e prokurorisë.
- 25** Në përfundim, në analizë të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se nuk ekzistojnë problematika që do të çonin në konkluzionin se subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit që subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues lidhur me këtë kriter sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk gjendet në kushtet e nenit 61, pika 4 të këtij ligji, është i drejtë.

#### ***Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

- 26** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit për pasurinë *apartment banimi me sipërfaqe 41 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Golem*, në gjendjen që janë aktet, veprimet e vëllait të subjektit të rivlerësimit, të mbështetura edhe prej subjektit, paraqesin në mënyrë të pasaktë

---

<sup>40</sup> Subjekti ka paraqitur kopje të dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2005, me inventarin përkatës, dhe ka sqaruar se në procesverbalin e dorëzimit të dosjes nga sekretaria në arkivin e prokurorisë, ka pasur një gabim material në numrin e procedimit [shënuar {\*\*\*} dhe jo {\*\*\*}], për shkak të të cilit nuk është bërë e mundur që dosja të gjendej më parë.

rrethanat lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 41 m<sup>2</sup> në Kavajë, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

**26.1** Subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri ka deklaruar si më poshtë.

- Në deklaratën *vetting*: apartament banimi me sipërfaqe 41 m<sup>2</sup>, i ndodhur në {\*\*\*}, Kavajë. Blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.9.2005, në bashkëpronësi me vëllain I. H. Regjistruar pranë ZVRPP Kavajë me nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, zk. {\*\*\*}, Kavajë. Kontributi im ka qenë në shumën 200.000 lekë, të ardhura që burojnë nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 33,3%<sup>41</sup>.
- Në deklaratën e pasurisë të vitit 2005 (në vijim “DIPP”), apartament 41 m<sup>2</sup>, i ndodhur në {\*\*\*}, blerë në muajin gusht të vitit 2005. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 1/3 ose 33,3%.
- Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 15.03.2016<sup>42</sup>, ka shpjeguar: [...] *shtysë për blerjen e kësaj banese është bërë një marrëveshje midis vëllait tim I. H., rezident në Austri, i cili drejton një studio arkitekture {\*\*\*}. Ai kishte rënë në marrëveshje me shtetasin V. H., bashkëshorti i E. V., dhe A. V. për projektin e një hoteli në {\*\*\*} Vlorë, ku shpërblimi do të ishte 1.200.000 lekë. Nga im vëlla projekti është bërë në kohë dhe i është dorëzuar atij, por nuk i është likuiduar pagesa. Në vitin 2005 ata i kanë ofruar në këmbim të shumës një apartament garsionere në {\*\*\*} në kompleksin e ndërtuar nga “{\*\*\*}” ShPK. Nisur nga ky fakt, im vëlla më ofroi që unë të paguaja diferencën prej 200.000 lekësh dhe unë të isha b/pronar në këtë apartament me 1/3. Meqenëse ai është jashtë shtetit dhe unë merresha dhe me mirëmbajtjen dhe dokumentacionin e nevojshëm ramë dakord që edhe regjistrimi në hipotekë të bëhej me pjesë takuese, ai 2/3 kurse unë 1/3. Burimi i vlerës 200.000 lekë plus edhe ndonjë shpenzim për mobilimin janë nga të ardhurat nga paga. [...]*

**26.2** Komisionit, në rezultatet fillestare të hetimit administrativ, duke konsideruar si pagesë të kryer nga subjekti i rivlerësimit shumën 200.000 lekë, i ka rezultuar se ai ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, por ka kërkuar shpjegime nga subjekti lidhur me pagesën prej 200.000 lekësh, në raport me pjesën takuese 1/3, e cila i përket vlerës 466.667 lekë. Në vijim, lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>43</sup>, Komisioni ka riçelur hetimin administrativ, dhe në analizë të deklarimeve dhe

---

<sup>41</sup> Me deklaratën “vetting”, subjekti ka paraqitur: (i) Kontratë nr. {\*\*\*/{\*\*\*/rep./kol., datë 23.9.2005, në të cilën pasqyrohet se Saimir dhe I. H. blejnë apartamentin me sip. 41,6 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, zk {\*\*\*}, në Kavajë. Çmimi i shitjes në vlerën 1.400.000 lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht. Sipas kontratës, urdhërohet ZVRPP të bëjë regjistrimin e pasurisë ku Saimir Hysa zotëron 1/3 dhe I. H. 2/3. (ii) Kartelë pasurie për apartament me sip. 67 m<sup>2</sup>, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, në emër të shitësve L., E. dhe A. V. Harta treguese e regjistrimit. (iii) Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 4.10.2005, në emër të Saimir dhe I. H. për apartamentin me sip. 41,6 m<sup>2</sup>, nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, zk {\*\*\*}, në Kavajë dhe harta treguese e regjistrimit.

<sup>42</sup> Procesverbali është mbajtur në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, lidhur me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat e pasurisë deri më 31.12.2014. Për këtë pasuri, subjekti ka dhënë përgjigje për pyetjen nr. 1: “Në DPV 2005 keni deklaruar apt. banimi me sipërfaqe 41 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, blerë në gusht 2005, në vlerën 1.400.000 lekë, pjesa që zotëroni 33%. Sa është pjesa e paguar nga ana juaj dhe cili është burimi. Me shpjegimet, subjekti ka paraqitur certifikatën për vërtetim pronësie, datë 4.10.2005, si dhe kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 23.09.2005.

<sup>43</sup> Në gjetjen e datës 26.06.2013, vëzhguesi ndërkombëtar, në mënyrë të përmbledhur, ka konstatuar: (i) Komisioni ka kërkuar vetëm shpjegime, dhe nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës; (ii) nuk është hetuar për mundësitë e të vëllait të subjektit për investimin 1.200.000 lekë, ndërsa vëllai ka blerë një apartament tjetër në Tiranë për të cilin duket se ka paguar 58.000 euro [siç është deklaruar në vitin 2009]; (iii) kontributi i subjektit, sipas

dokumentacionit të paraqitur prej subjektit, në përfundim ka konkluduar: [...] *trupit gjykues, duke qenë se përgjatë gjithë procesit për këtë subjekt, kundrejt një hetimi gjithëpërfshirës dhe të thelluar, nuk evidentoi ndonjë fakt apo rrethanë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga subjekti apo dokumentacioni i administruar në dosje, pa pasur gjithashtu kurrfarë indicie apo dyshimi lidhur me raportin e subjektit në tërësi me këtë pasuri, si dhe në mungesë të çdo informacioni negativ nga organet ligjzbatuese për figurën e tij në çështjen objekt vlerësimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi e vërtetësi pjesën e tij takuese, përdorimin e kësaj pasurie, ka pasur mundësi financiare për të kontribuar në shumën 200.000 lekë për blerjen e saj, si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit për shkak të detyrës dhe, për pasojë, nuk ka asnjë rrethanë që afekton procesin e tij të rivlerësimit [...].*

**26.3** Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrime në seancë gjyqësore, pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse, për sa vijon.

(i) Mbetet e provuar se vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si kontribut në blerjen e kësaj pasurie, referuar çmimit të kontratës, korrespondon me 1/7 e pjesës takuese. Referuar kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 23.9.2005, duhej të bëhej regjistrimi i këtij apartamenti në emër të subjektit me 1/3 pjesë takuese, ndërkohë në ASHK<sup>44</sup> rezulton se kjo pasuri është regjistruar në bashkëpronësi në pjesë të barabarta me vëllain e tij. Referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit<sup>45</sup>, vërehet se, nëse pagesa e kryer nga subjekti për këtë pasuri do të llogaritej në vlerën 466.667 lekë (korrespondon me 1/3 e vlerës së kontratës) ose në vlerën 700.000 lekë (korrespondon me 50% të vlerës së kontratës), atëherë subjekti do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme.

(ii) Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti nuk ka dokumentuar (1) marrëdhënien e shërbimit (projektin e një hoteli në {\*\*\*}, Vlorë); (2) shumën që do të përfitonte nga ofrimi i këtij shërbimi, vëllai i subjektit të rivlerësimit nga shitësit e apartamentit në {\*\*\*}, Kavajë.

(iii) Sa më sipër, edhe përderisa gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk u paraqit dokumentacion provues lidhur me sa pretenduar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kontributin e tij për blerjen e pasurisë mbeten në nivel deklarativ dhe bien ndesh *me parashikimet e kontratës së shitjes së pasurisë të datës 23.09.2005, ku parashikohet se çmimi i apartamentit prej 1.400.000 lekësh është likuiduar tërësisht.*

---

*pretendimit, është 1/7 e çmimit të shitjes, shumë i ulët krahasuar me 1/3 e pjesës takuese në kontratën e shitjes, ndarja e pjesëve nuk është pasqyruar në vërtetimin e pronësisë, ku subjekti dhe vëllai janë të regjistruar si bashkëpronarë me 50%, duke i bërë shpjegimet e subjektit më pak të besueshme; (iv) çmimi i apartamentit është shumë i ulët krahasuar me të dhënat e EKB-së; (v) shpjegimi i subjektit për arsyet për të cilat vëllai e kishte përfituar apartamentin – shërbimet e ofruara dhe të papaguara që shlyheshin me blerjen e këtij apartamenti – nuk janë përmendur në kontratën e shitjes e nuk mbështeten nga ndonjë provë tjetër. Mbetet e paqartë se cili ka qenë çmimi i llogaritur i punëve të vëllait dhe cili ka qenë çmimi real i pasurisë në momentin e transferimit si dhe ndikimi në mundësitë financiare të secilit prej vëllezërve; (vi) në DIPP 2016, subjekti deklaroi se vëllai I. i ka dhuruar 1/6 pjesa takuese në një apartament të trashëguar, por se nuk ka vendosur lidhur me pranimin ose jo të dhurimit; (vii) në vitin 2018, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit i transferohet vëllait në mënyrë deklarative për të shlyer huanë pa interes prej 15.000 eurosh, duke deklaruar se do të hiqte dorë nga pasuria me vlerë 200.000 lekë [investimi fillestar i deklaruar]; 466.666 lekë [1/3 e investimit fillestar] ose dhe 700.000 lekë [50% e investimit]; (ix) nuk del qartë a ka banuar subjekti i rivlerësimit në këtë pasuri, a është dhënë me qira/kush i merrte qiratë, në emër të kujt janë regjistruar shërbimet utilitare.*

<sup>44</sup> Shkresa e ASHK-së me nr. {\*\*\*}, datë 25.11.2020.

<sup>45</sup> Analiza financiare në rezultatet e hetimit, datë 13.06.2023.

**26.4** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në seancë gjyqësore, kundërshton shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, duke pretenduar dhe shpjeguar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

(i) Deri në vitin 2018, prona figuron e regjistruar në ish-ZVRPP Kavajë, në bashkëpronësi mes tij dhe vëllait I. H., në raportin 1/3 dhe 2/3, pasqyruar në kontratën e shitjes të datës 23.09.2005, ku në bazë të nenit 11 të ligjit, urdhërohet ZVRPP Kavajë të bëjë regjistrimin e apartamentit në emër të blerësve Saimir Hysa me 1/3 pjesë dhe I. H. me 2/3 pjesë. Lidhur me shënimin prej punonjësve të ZVRPP-së, që prona është “Bashkëpronësi”, nuk ka pasur dijeni dhe nuk mund të japë shpjegime për mospasqyrimin e pjesëve sipas kontratës së shitjes, por jo domosdoshmërisht do të thotë se prona është regjistruar në bashkëpronësi me pjesë të barabarta.

(ii) Në mënyrë konsistente, edhe përpara procesit të rivlerësimit, ka deklaruar se për këtë pasuri ka kontribuar me një shumë prej 200.000 lekësh *cash*. Kontributi i tij nuk lidhej me mungesën e aftësisë së tij paguese për shumën prej 466.600 lekësh, por me plotësimin e diferencës mes çmimit të apartamentit prej 1.400.000 lekësh, dhe shumës prej 1.200.000 lekësh, vlerësuar si kompensim për pagesën për projektin e një hoteli në Vlorë të hartuar prej të vëllait, në marrëveshje mes tij dhe shtetasve A. H. dhe V. H. [porositësve të projektit].

(iii) Në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, e sheh jashtë procesit të rivlerësimit dhënien e shpjegimeve përse vëllai i tij nuk ka lidhur kontratë shërbimi për realizimin e projektit me një klientin e tij para 20 vjetësh, apo të vërtetojë marrëdhëniet mes tyre, pavarësisht se ka dorëzuar deklarata noteriale të këtyre shtetasve që konfirmojnë shpjegimet e tij. Nuk ka detyrim të provojë rrethanat lidhur me rënien dakord të vëllait të tij dhe shitësve të pronës, lidhur me kompensimin e pagesës së një projekti të porositur, ku nuk ka qenë palë në negociim. Ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e kontributit të vëllait edhe nëse pasuria do të ishte blerë me para në dorë, ku sipas analizës financiare të Komisionit, aftësitë paguese të vëllait kanë rezultuar në shumën 72.735 euro ose 9.142.789 lekë.

(iv) Vlerat e paguara, relativisht të ulëta për të dhe të vëllanë, nuk japin asnjë arsye për deformim të deklarimit, duke anashkaluar edhe kushtet e marrëdhënies së posaçme në këtë bashkëpronësi, shpjeguar prej tij imtësisht në Komision, e po ashtu deklaruar nga i vëllai në deklaratën e tij noteriale.

(v) Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, që sipas Komisionerit Publik është “shumë i ulët”, është sqaruar edhe në vendim se prona ndodhet në fshatin Kryemëdhenj, ndërkohë nga vëzhguesi ndërkombëtar në mënyrë të gabuar është marrë si referencë çmimi për qytetin e Durrësit, ndërkohë që me kontrata të paraqitura, ka provuar se apartamente në të njëjtin pallat janë blerë më lirë.

**26.5** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, se deklarimi i subjektit për kontributin e tij prej 200.000 lekësh në krijimin e kësaj pasurie, mbeti deklarativ dhe i paprovuar, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë, dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të pabazuara. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

**26.5.1** Në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, që në kuptim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, përdoret si provë në këtë proces, subjekti ka deklaruar vlerën e pasurisë prej 1.400.000 lekësh, pjesën takuese 1/3, pa deklaruar shumën e investuar prej tij dhe burimin e krijimit të saj. Në të kundërt me sa pretenduar, *se ka qenë konsistent lidhur shumën e paguar prej 200.000*



*lekësh*, deklarata e pasurisë e sipërcituar provon se prej tij nuk është deklaruar as shuma e paguar, dhe as nuk është bërë ndonjë deklarim lidhur me diferencën mes vlerës që i korrespondon pjesës takuese të deklaruar prej 1/3 – prej 466.667 lekësh – me atë të pretenduar të paguar prej 200.000 lekësh. Duke analizuar *a contrario*, sipas pretendimit të subjektit, diferenca mes vlerave të sipërcituara, në shumën prej 266.667 lekësh, duhej të deklarohet në formularin “Dhurata dhe trajtime preferenciale” të deklaratës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, qartësuar edhe në formularin në ndihmë të subjekteve deklaruese<sup>46</sup>. Lidhur me shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, sipas procesverbalit të mbajtur më datë 15.03.2016, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit për vlerën provuese të deklaratave të pasurisë në procesin e rivlerësimit, sipas parashikimit të ligjit nr. 84/2016, përkundrejt shpjegimeve të dhëna përpara ILDKPKI-së, të cilat synojnë ndreqjen e pasaktësive në deklarime të konstatuara nga ky organ, edhe në rastin e subjektit Saimir Hysa, trupi gjykues i vlerëson jobindëse shpjegimet e subjektit në këtë procesverbal lidhur me shumën e paguar për këtë pasuri, të dhëna prej pas 11 vitesh, në përgjigje të pyetjeve të këtij organi dhe jo të ndrequra në mënyrë vullnetare prej vetë subjektit.

**26.5.2** Në vijim të sa më sipër, citimi në kontratën e shitjes: [...] *Urdhërohet Zyra Qendrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që, në bazë të nenit 11 të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të bëjë regjistrimin e këtij apartamenti në emër të blerësve Saimir Hysa me 1/3 pjesë dhe I. H. me 2/3 pjesë [...]*, lexohet se raporti i kontributeve të blerësve ka qenë i njëjtë me raportin e pasurive të fituara përmes kësaj kontrate, përderisa në kohën kur është përpiluar kontrata, nuk ka gjurmë apo deklarime për vlera të ndryshme kontributi.

**26.5.3** Lidhur me pretendimin se pjesa takuese e subjektit në pasurinë objekt kontrolli mund të jetë edhe sa ½ e saj, përderisa si e tillë është përcaktuar në kartelën e pasurisë të lëshuar nga ZRPP-ja, trupi gjykues vlerëson se mbeti një pretendim i pabazuar. Me deklaratën *vetting*, si dokumentacion justifikues ligjor, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë të lëshuar më datë 04.10.2005, hartën treguese të regjistrimit më datë 03.10.2005, ku nuk pasqyrohen pjesët takuese të bashkëpronarëve, si dhe formularin e aplikimit, ku aplikant figuron Saimir Hysa. Kjo e dhënë, ndonëse mund të prezumojë bashkëpronësi në pjesë të barabarta, nuk është e mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ajo është e tillë, përderisa në kontratën që është akti mbi të cilin janë fituar të drejtat e bashkëpronësisë, është përcaktuar qartë pjesa takuese e secilit prej bashkëpronarëve. Fakti që zyra nuk ka përshtetur në certifikatën e pasurisë këtë raport, nuk mund të zhbëjë atë që palët kanë dakordësuar në marrëveshje me njëri-tjetrin dhe as të ngarkojë subjektin me ndonjë përgjegjësi në kuptim të këtij procesi. Në këtë kontekst, edhe pretendimi rreth dijenisë së subjektit mbi këtë fakt, mbetet pa relevancë përderisa nuk ka asnjë të dhënë që subjekti të ketë iniciuar apo synuar transformimin e pjesëve takuese, ndryshe nga sa kontrata që ai ka depozituar në ZRPP ka përcaktuar.

---

<sup>46</sup> Në këtë formular, për subjektet deklaruese, jepet sqarimi: “nëse keni marrë dhurata dhe trajtime preferenciale në vlera mbi 10.000 lekë, plotësoni tabelën. Për sqarime mund të lexoni nenin 15, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005. Në dispozitën e cituar, të titulluar “Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht”, parashikohet: “[...] Nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi”.

**26.5.4** Në rrethanat si më sipër analizuar dhe në referim të qëndrimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, se: *Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajjtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta*, trupi gjykues vlerësoi se analiza financiare për mundësinë e subjektit për të krijuar këtë pasuri, duhet të kryhet mbi vlerën e pjesës së tij takuese prej 1/3, përcaktuar në kontratën e shitblerjes, deklaruar në deklaratën vetting dhe atë periodike të vitit 2005. Mbi bazën e këtij vlerësimi, u krye analiza financiare për subjektin e rivlerësimit, nga e cila rezultoi se ai kishte pamjaftueshmëri në krijimin e shumës korresponduese prej 466.667 lekësh, për një vlerë negative në masën prej (-) 96.808 lekësh.

**26.6** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti nuk arriti të provojë marrëdhënien e shërbimit të vëllait tij me persona të tretë, si shpërblim për të cilin ai ka përfituar apartamentin prej 41 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim verifikohet si i drejtë, përderisa edhe vetë subjekti ka deklaruar se ai është në pamundësi për të sjellë aktet që provojnë katërçipërisht ekzistencën e marrëdhënies dhe përfitimet që kanë ardhur prej saj, dhe në këtë rast kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Në kushtet kur ky burim i pretenduar është atipik dhe i referohet aktivitetit tregtar/profesional të vëllait të subjektit për pjesën e tij takuese të bashkëpronësisë, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit se: *shtrirja e kontrollit mbi të gjitha pasuritë e personave që kanë marrëdhënie interesi do të përbënte një barrë disproporcionale dhe të pamundur për subjektet e rivlerësimit*<sup>47</sup> – trupi gjykues vlerëson se vëllai i subjektit nuk kualifikohet si ndonjë person me ndonjë status të posaçëm në këtë proces për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë, dhe subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi lidhur me këtë fakt. Për më tepër, edhe duke abstraguuar marrëdhënien e shërbimit të pretenduar, nga analiza financiare që është kryer për të kontrolluar mundësitë e vëllait të subjektit për të financuar drejtpërdrejt krijimin e kësaj pasurie nëpërmjet të ardhurave të tij, rezultoi se ai kishte mundësi ta krijonte atë me burime të ligjshme. Në këto kushte, në lidhje me krijimin e kësaj pasurie, për sa i përket pjesës takuese të vëllait të subjektit prej 2/3, nuk evidentohen dyshime apo problematika të cilat mund të ngarkojnë subjektin me përgjegjësi në kuptim të këtij procesi.

- 27 Lidhur me pasurinë *apartament me sip. 71,2 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*, Komisioneri Publik ngriti si shkaqe ankimi se subjekti i rivlerësimit (i) nuk ka paraqitur akte për të provuar mbulimin me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, përfitimin faktik të këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga personi i lidhur nga punësimi pranë “{\*\*\*}” ShPK, dhe Institutit të Politikave Efektive Publike, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Konstatohet po ashtu se, në vërtetimin e punësimit lëshuar nga “{\*\*\*}” ShPK, referohet se personi i lidhur ka punuar pranë kësaj shoqërie gjatë periudhës 03.03.1999 - 01.01.2001, ndërsa nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie, konstatohet se kjo shoqëri është regjistruar në datën 20.10.1999; (ii) nuk ka paraqitur ndonjë akt që të verifikojë transaksionin e dhënies së huasë në shumën 15.000 euro nga vëllai i tij, duke deklaruar se huaja është dhënë *cash*, dhe ka depozituar kontratë huaje të datës 21.11.2011, që daton disa muaj pas kohës kur pretendohet se është dhënë huaja, duke ngritur kështu dyshime lidhur me vërtetësinë

<sup>47</sup> *Shih vendime të Kolegjit, ndër të tjerë, nr. 31/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli, nr. 22/2022 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.*

e këtij transaksioni. Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik u qëndroi konstatimeve në ankimin e paraqitur dhe pretendoi që ato mbeten për t'u marrë në konsideratë nga Kolegji në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

**27.1** Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, deklaron: *Apartament me sipërfaqe 71,2 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*} kol., datë 15.10.2011, lidhur para noteres A. S., Tiranë. Në bashkëpronësi me bashkëshorten time E. T. Regjistruar pranë ZRPP Tiranë me nr. {\*\*\*} regjistri hipotekor, datë 21.10.2011. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimet e blerjes së kësaj prone janë:*

- [...]
- *Një shumë prej 17.000 eurosh, kursime të E. T. në Intesa Sanpaolo Bank, tërhequr më 05.08.2011. Kjo shumë, së bashku me shumën e mësipërme prej 400.000 lekësh, në datën 05.08.2011 i është dhënë “cash” në dorë shitësit A. L., sipas mandatit nr. {\*\*\*}, datë 05.08.2011, lëshuar prej tij.*
- [...]
- *Një hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi I. H. (vëllai), e cila i është paguar “cash” në dorë drejtuesit të “{\*\*\*}” ShPK, z. A. L. Për këtë hua, është lidhur kontrata e huasë nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*} kol., datë 21.11.2011, para noteres B. A.*

**27.2** Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, shkak ankimi prej Komisionerit Publik, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka analizuar dhe konkluduar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

**27.2.1** Për derdhjen prej bashkëshortes së subjektit të shumës 4000 euro në datën 31.07.2006<sup>48</sup>, subjekti ka shpjeguar se burim krijimi kanë qenë të ardhurat e saj nga punësimi, si dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës<sup>49</sup>. Nga dokumentacioni i administruar dhe nga analiza financiare për periudhën dhjetor 2004 - korrik 2006, periudhë kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në bashkëjetesë me bashkëshorten e tij, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur mundësi në shumën (-) 109.495 lekë për depozitimin e shumës së sipërcituar dhe për përballimin e shpenzimeve jetike. Pas analizimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në përmbushje të barrës së provës, Komisioni ka

---

<sup>48</sup> *Shkresa e Intesa Sanpaolo Bank nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2020, administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2020, me të cilën është dërguar informacion se prej E. T. është hapur një llogari bankare duke depozituar fillimisht shumën 4.000 euro më datë 31.7.2006, e në vijim janë kryer depozitime dhe tërheqje prej saj. Në datën 11.01.2011, shuma e akumuluar në këtë llogari, prej 10.000 eurosh, është investuar në depozitë, nga e cila janë përfutur interesa pas maturimit, në datën 4.08.2011 është depozituar shuma prej 4.000 eurosh dhe, më pas, në datë 5.08.2011, është tërhequr vlera prej 17.000 eurosh, e akumuluar deri në atë datë në këtë llogari.*

<sup>49</sup> *Pranë “{\*\*\*}” ShPK 03.03.1999 - 03.01.2001, me pagë mujore neto 25.000 lekë në muaj; pranë Institutit të Politikave Efektive Publike 05.01.2001, pagë mujore neto 15.000 lekë në muaj; dhe “{\*\*\*}” ShA 01.12.2004 - 01.11.2006, pagë mujore neto 30.000 lekë e më pas 35.000 lekë në muaj [të ardhura neto dhe shpërblime nga {\*\*\*} 900.000 lekë]. Përpos dokumentacionit të paraqitur me deklaratën “vetting” – vërtetime nga administratorët e “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShA, në përgjigje të kërkesës së Komisionit me pyetësorin 5, për paraqitje të dokumentacionit, subjekti ka depozituar kopje të librezës së punës së znj. T. dhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror, ku konfirmohen të ardhura për periudhën dhjetor 2004 - tetor 2006.*

konkluduar: [...] Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar, çmon të konsiderojë si dokumente provuese të marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit librezën e punës dhe vërtetimin e pagës mujore nga punëdhënësi i ngarkuar me pagimin e detyrimit tatimor. Në vlerësim të këtyre provave, faktit që të ardhurat nga punëdhënësi janë kaluar në rrugë bankare dhe, për pasojë, pagimi i kontributeve ka qenë detyrim i punëdhënësit, si dhe faktit se këto të ardhura datojnë përpara njohjes së subjektit me bashkëshorten e tij dhe se balanca negative e rezultuar është në një masë të papërfillshme, trupi gjykues i çmon këto fakte e rrethana në harmoni me njëra-tjetrën dhe, në përfundim, konkludon se nuk përbëjnë shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimit [...].

**27.2.2** Lidhur me burimin e deklaruar në deklaratën vetting: hua 15.000 euro, marrë nga shtetasi I. H. (vëllai), të cilën në DIPP-2011 subjekti e ka deklaruar: hua pa afat dhe pa interes nga shtetasi I. H. në shumën 15.000 euro – nga analiza e dokumentacionit të administruar, Komisionit i ka rezultuar se për dhënien e huasë në muajin gusht 2011, të ardhurat bruto të vëllait deri në korrik 2011, ishin në vlerën 46.949,2 euro, dhe shpenzimet e jetesës për dy të rritur me dy fëmijë, në shtetin austriak ku ai jeton, në shumën 15.775,08 euro<sup>50</sup>. Bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar<sup>51</sup>, Komisioni ka shtrirë hetimin administrativ në vijim të saj, dhe ka konkluduar: [...] Në përfundim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit dhe analiza financiare duket se nuk identifikojnë problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj huaje, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës [...].

**27.3** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, si më sipër cituar, duke parashtruar dhe argumentuar si vijon.

**27.3.1** Nga analiza financiare e kryer prej Komisionit për bashkëshorten, për periudhën dhjetor 2004 - korrik 2006, për shkak se nuk janë marrë parasysh të ardhurat nga punësimi i saj për periudhën mars 1999 - dhjetor 2004, të cilat nuk konfirmohen nga ISSH-ja, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën (-) 109.495 lekë për krijimin e shumës prej 4.000 eurosh. Komisioni ka konkluduar: *balanca negative e rezultuar është në një masë të papërfillshme, trupi gjykues i çmon këto fakte e rrethana në harmoni me njëra-tjetrën dhe në përfundim konkludon se nuk përbëjnë shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimit.* Lidhur me konstatimin se në librezën e punës, shënimi për punësimin në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK daton në mars 1999, ndërkohë që kjo shoqëri është themeluar në shtator të vitit 1999,

---

<sup>50</sup> Sipas Eurostat:

[https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/ILC\\_LI01\\_custom\\_6254640/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/ILC_LI01_custom_6254640/default/table?lang=en)

<sup>51</sup> Gjetja nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023, në të cilën vëzhguesi ndërkombëtar evidenton se mundësia financiare e vëllait për të dhënë huanë, sipas rezultateve të hetimit, nuk është e qartë: (i) Komisioni ka referuar në rezultatet e hetimit disa aktivitete dhe të ardhura të vëllait në Austri. Informacioni për të ardhurat e vëllait daton pas gushtit 2011. Domethënë, pasi huaja prej 15.000 eurosh është dhënë në mënyrë deklarative. (ii) Transferimi i shumës 15.000 euro nuk është sqaruar dhe dokumentuar. Subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësorin e 2-të se i janë dhënë 15.000 euro në gusht 2011. Nuk ka asnjë deklaratë të gjendjes cash të vëllait që ka hyrë në Shqipëri me më shumë se 10.000 euro. (iii) Dokumenti nga DPPP nr. {\*\*\*} prot., datë 22.10.2020, tregon lëvizjet e vlerave monetare nga vëllai dhe babai ndër vite, nga ku duket se këto lëvizje shumash ndikojnë në përlllogaritjet e kryera për të konkluduar nëse vëllai i subjektit kishte mjetet financiare për të dhënë huanë. (iv) Vëllai gjithashtu ka marrë një kredi në vitin 2006 në Austri, për të blerë një apartament në vlerën 234.000 euro, nga ku duket se ai ka pasur detyrime monetare ndaj të tjerëve. (v) Të dhënat nga organet tatimore shqiptare për aktivitetet private të vëllait tregojnë kryesisht aktivitete me humbje [shih përgjigjen e MFE nr. {\*\*\*} prot., datë 4.12.2020].

subjekti shpjegoi se shënimi është bërë në janar 2007, kohë kur bashkëshortja është punësuar në {\*\*\*}, ka hapur librezën e punës dhe ka marrë të dhënat e saj të punësimit për t'i pasqyruar në të. Gabimi në këtë shënim, që nuk ka lidhje me procesin e rivlerësimit, është bërë në momentin që bashkëshortja ka marrë të dhënat e punësimit të saj për t'i pasqyruar në librezën e punës nga administrata e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, krijuar në vitin 1999, e cila ka përthithur shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Dy shoqëritë kanë pasur të njëjtët administratorë, ortakë, punonjës dhe vend ushtrimi aktiviteti, dhe vërtetimi i vitit 2017 për të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK është përpiluar bazuar në të dhënat e librezës së punës dhe jo në dokumentacionin e shoqërisë që nuk eksitonte prej rreth 13 vjetësh e nuk disponohej asnjë dokument i saj. Sa parashtruar, provon se nuk ka paraqitje të të dhënave të rreme në kuadër të procesit të rivlerësimit, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në këtë shoqëri nuk janë përfshirë në analizën financiare. Paraqitja e këtij fakti si shkak i veçantë ankimi synon uljen e besueshmërisë së deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij.

**27.3.2** Lidhur me huanë 15.000 euro të marrë nga vëllai, në *cash*, subjekti i rivlerësimit parashtror: (i) ligji nuk e ndalon që një hua të jepet në *cash*, në kontratën e huasë, bërë me kërkesë të tij, pasi prej të vëllait nuk është kërkuar një akt i tillë, saktësohet koha e dhënies së huasë, muaji gusht 2011, qëllimi i saj, për blerje apartamenti të shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Nuk ka asnjë kusht që kontrata e huasë, që lidhet me vullnetin e lirë të palëve, duhet lidhur pikërisht ditën e dhënies së huasë, dhe jo kur palët ta çmojnë të arsyeshme; (ii) sipas analizës financiare të Komisionit, deri në gusht të vitit 2011, vëllai ka pasur mundësi kursimi në shumën 19 herë më shumë se huaja e dhënë, si dhe ka pasur gjendje *cash* në Shqipëri nga tërheqja në *cash* e shumës së përfituar nga shitja një banese, por edhe ka sjellë nga jashtë në hyrjet e shumta në Shqipëri [vetëm për vitin 2011, deri në muajin gusht ka pasur 6 hyrje-dalje]; (iii) shlyerja e huasë vërtetohet se është bërë përmes kalimit të një pasurie të paluajtshme të huadhënësi [pjesës takuese të apartamentit në {\*\*\*}], që tregon se veprimi i huadhënies është real.

**27.3.3** Trupi gjykues, *së pari*, mori në shqyrtim pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e shumës 4.000 euro prej bashkëshortes së subjektit. Gjatë hetimit administrativ, si burim të krijimit të kësaj shume, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortes E. T. nga punësimi në periudhën mars 1999 - korrik 2006, të cilat ajo i ka futur në një depozitë të vetme më datë 31.07.2006. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit për periudhën 1999-2006, deklaroi krijimin e të ardhurave neto si vijojnë: (i) shumën prej 550.000 lekësh, nga paga pranë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 03.03.1999 - 03.01.2001; (ii) shumën prej 640.000 lekësh nga puna pranë “IPEP” Publike për periudhën 05.01.2001 - 30.11.2004; (iii) shumën prej 900.000 lekësh, nga puna pranë “{\*\*\*}”, për periudhën 01.12.2004 -01.11.2006.

**27.3.4** Me deklaratën *vetting*, subjekti ka paraqitur si dokumentacion mbështetës: (i) kopje të librezës së punës së znj. T., që rezulton e hapur në janar 2007, e ku pasqyrohen periudhat e punësimit të mëparshëm të saj, pranë shoqërive “{\*\*\*}” ShPK, pranë Institutit të Politikave Efektive Publike, dhe pranë “{\*\*\*}”, por jo të ardhurat/paga mujore; (ii) vërtetime të lëshuara nga shoqëritë “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}”, respektivisht në datat 25.01.2017 dhe 24.10.2016. Referuar vërtetimit të lëshuar prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përpos datës së fillimit të marrëdhënieve të punës – 03.03.1999 – e cila rezulton disa muaj përpara se shoqëria të regjistrohej – 20.10.1999 – jepen të dhëna për pozicionin e znj. T., pagën mujore, pa sqaruar

nëse ka qenë neto, apo lidhur me pagimin e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore. Lidhur me punësimin e znj. T. pranë Institutit të Politikave Publike, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument lidhur me të ardhurat mujore. Referuar vërtetimit të lëshuar prej shoqërisë “{\*\*\*}”, jepet informacion për pagën mujore *neto* të znj. T., të ardhurat nga shpërblimet, dhe se kontributet shoqërore dhe shëndetësore të saj janë paguar rregullisht prej shoqërisë.

**27.3.5** Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur shkresën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, kthim përgjigje kërkesës së tij<sup>52</sup>, nga ku për E. T., rezulton se (i) emri i saj nuk figuron në listëpagesat e subjektit “{\*\*\*}” ShPK, me nr. dosje {\*\*\*} juridik, për periudhën tetor 1999 - janar 2001; (ii) me emërtimin “Instituti Politikave Efektive Publike” nuk figuron asnjë e dhënë në bazën e të dhënave elektronike dhe se për verifikime të mëtejshme duhet dërguar më shumë informacion, si p.sh., nr. NIPT-i, fotokopje libreze pune; (iii) për periudhën dhjetor 2004 - nëntor 2005; janar 2006 -tetor 2006, ka realizuar të ardhura bruto në vlerën 861.021 lekë, për të cilat është derdhur kontributi në subjektin “{\*\*\*}”.

**27.3.6** Shtirirja e hetimit lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të znj. T., pavarësisht se përkojnë me periudhën para fillimit të bashkëjetesës së saj me subjektin, vjen në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së burimit të pasurisë së krijuar gjatë martesës. Nën dritën e parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe vlerësimit të Kolegjit në jurisprudencën e konsoliduar prej tij për raste të ngjashme, standardi kushtetues kërkon që ato të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse<sup>53</sup>. Në kuptim të dispozitave të sipërreferuara, qartësimeve në udhëzimin e ILDKPKI-së për dokumentacionin justifikues që paraqitet me deklaratën *vetting*<sup>54</sup>, trupi gjykues vlerëson se lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe Institutit të Politikave Efektive Publike, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë me dokumentacion ligjshmërinë e tyre. Referuar vërtetimeve të lëshuara prej shoqërive, pasqyruar në pikën 41.3.4 më lart, ku ndryshimi në përmbajtje evidentohet qartësisht, pasi në vërtetimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nuk pasqyrohet që të ardhurat të kenë qenë neto. Përpos faktit se ky vërtetim nuk ka përmbushur kriteret ligjore për të mbështetur të ardhurat e deklaruara, e subjekti nuk ka dëshmuar së paku përpjekje për të kërkuar/paraqitur dokumentacionin e saktë, lidhur me sa parashtron Komisioneri për datën e pasqyruar në të për fillimin e marrëdhënies së punës prej bashkëshortes, vlerësohet prej trupit gjykues pa relevancë, për sa provat e paraqitura mbështesin deklaratimet e subjektit, duke krijuar bindjen se së paku në vërtetim, periudha e punësimit është “përputhur” me shënimin respektiv në librezën e punës, dokument i cili nuk është përpiluar në funksion të këtij procesi.

<sup>52</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 18.05.2023, bashkëlidhur së cilës janë tri vërtetime.

<sup>53</sup> Detyrime të buruara nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe nga ligji nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>54</sup> Udhëzimi i Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 16 parashikon: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë”.

**27.4** Lidhur me pretendimin për mungesën e besueshmërisë në ekzistencën e marrëdhënies së huasë që subjekti ka pasur me vëllain e tij për shumën prej 15.000 euro, të përdorur si një prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie, në analizë të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe nga gjykimi në Kolegj, si: (i) deklarimi i huasë si burim krijimi i pasurisë në deklaratën *vetting* dhe atë periodike të vitit 2011; (ii) dokumentimi me akt noterial i huasë, dhënia/marrja e huasë në muajin gusht 2011; (iii) mundësia financiare e vëllait të subjektit për krijimin shumës së dhënë hua; (iv) shlyerjen e huasë nëpërmjet një veprimi juridik<sup>55</sup>, si dhe në konsideratë edhe të standardeve të përdorura për vlerësimin e rrethanave të ngjashme për subjekte të tjera rivlerësimi, trupi gjykues nuk gjeti argumente për të cenuar besueshmërinë për ekzistencën e saj, siç pretendohet në ankim. Arsyetimi i trupit gjykues shtjellohet në detaj si vijon.

**27.4.1** Huanë 15.000 euro, marrë vëllait I. H., sipas kontratës noteriale me ekstremitetet përkatëse, subjekti e deklaroi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting* si burim të krijimit të pasurisë, si dhe në rubrikën e deklarimit të detyrimeve, si detyrim të mbetur pa shlyer; në DIPP-2011: *hua pa afat dhe pa interes nga vëllai I. H., një shumë 15.000 euro, në gusht 2011, me qëllim blerjen e apartamentit*; në DIPP-të e viteve vijuese, 2012-2016, deklaroi detyrimin ndaj I. H. [vëllait] për të gjithë shumën e huasë prej 15.000 eurosh. Me deklaratën *vetting*, subjekti ka depozituar kontratën e huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2011, me huadhënës I. H. dhe huamarrës Saimir Hysa, ku huadhënësi deklaroi se i ka dhënë në gusht 2011, jashtë zyrës noteriale, z. Saimir Hysa një hua me vlerë 15.000 euro, pa afat dhe pa interes, me qëllim blerjen nga ana e huamarrësit të një apartamenti pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

**27.4.2** Sa më sipër, *së pari*, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i subjektit në DIPP-2011, mbështet pretendimet për shumën dhe kohën e marrjes së huasë, në gusht të vitit 2011. *Së dyti*, kontrata e huasë, e përpiluar përpara noterit publik në muajin nëntor 2011 dhe e regjistruar në regjistrin noterial, sipas parashikimeve të nenit 1050 e vijues të Kodit Civil, provon ekzistencën e marrëdhënies së huasë mes subjektit dhe të vëllait, si dhe krijimin e kësaj marrëdhënieje në gusht të vitit 2011. Trupi gjykues mban në konsideratë se edhe në kushtet e marrëdhënies së posaçme dhe mjaft të mirë mes subjektit dhe vëllait të tij, sikundër dëshmohet nga aktet në dosje, palët nuk kanë zgjedhur të dokumentojnë huanë me shkresë të thjeshtë, pavarësisht se do të ishte e mjaftueshme për provueshmërinë e saj në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil. Nga përmbajtja e kontratës, duket se qëllimi i palëve nuk ka qenë marrja/dhënia e garancive për kthimin e huasë, por provueshmëria e kësaj marrëdhënieje. Në këtë kontekst, dokumentimi i marrëdhënies së huasë me akt publik, duket të jetë në mbështetje të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, që si subjekt deklarues i nënshtrohej kontrollit të pasurisë dhe interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin

---

<sup>55</sup> Subjekti ka depozituar: 1- “Deklaratë dhurimi pasurie të paluajtshme” nr. {\*\*\*}, datë 09.07.2018, ku deklaroi në mënyrë definitive dhe të përvokueshme dhurimin e pjesës së tij të pandarë prej 1/3 pjesë mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 41,6 m<sup>2</sup> të ndodhur në {\*\*\*}, vëllait të tij I. H., deklaratë që e lëshon për çdo përdorim të nevojshëm ligjor dhe për efekt paraqitjeje në ZVRPP Kavajë; 2- “Akt-pranimi dhurimi” me nr. {\*\*\*}, datë 12.07.2018, të I. H. [përfaqësuar nga vëllai N. H.], ku deklarohet se pranon dhurimin e disponuar nga vëllai i tij Saimir Hysa me deklaratën noteriale të shtetasit I. H. para noterës G. Sh., në të cilën deklarohet se vëllai i tij, z. Saimir Hysa, në pamundësi të shlyerjes në të holla të detyrimit financiar prej 15.000 eurosh, të marrë sipas kontratës së huasë, t’i dhurojë pjesën e tij takuese prej 1/3 titull bashkëpronësie mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 41,6 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Durrës.

e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar [në vijim “ligji nr. 9049/2003”]. Për rrjedhojë, në kontekst të rrethanave faktike, marrëdhënies së posaçme mes subjektit dhe të vëllait, mundësive financiare të vëllait të subjektit, konsiderueshëm më të mëdha se shumica e huasë<sup>56</sup>, si dhe dokumentimit të marrëdhënies së huasë me akt publik në vitin 2011, ngritja e pretendimeve lidhur me vërtetësinë e transaksionit bazuar në faktin se kontrata noteriale daton disa muaj pas dhënies së huasë, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

**27.4.3** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosparaqitja prej subjektit e ndonjë akti që të verifikojë transaksionin e dhënies së huasë, nuk përbën shkak për të ngritur dyshim lidhur me deklaratimet e subjektit se huaja është dhënë *cash*. Në udhëzimin e Inspektorit të ILDKPKI-së, dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e rregullave për mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, si dhe dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në pikën 15 parashikohet: *Deklarimi i huamarrjeve dhe huadhënieve në likuiditete të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor dhe me vërtetimet bankare, në rast se veprimi në kohën e kryerjes së tij, është kryer me transaksion bankar*. Nga ky parashikim, kuptohet që dokumenti që vërteton transaksionin bankar për kalimin e shumës së huasë nuk barasvleftësohet me dokumentet justifikuese ligjore, për sa as ligji nr. 9049/2003, të cilit subjekti i është nënshtruar si subjekt deklarues, nuk parashikonte detyrim për kalimin në rrugë bankare të shumave të deklaruara të huasë. Gjithashtu, për sa dokumentohen disa hyrje të vëllait të subjektit në Shqipëri<sup>57</sup>, duket të qëndrojë deklarimi se *një pjesë të shumës së huasë e ka sjellë nga Austria në gusht të vitit 2011, por ka qenë nën shumën për të cilën ka detyrimin ta deklarojë*, e për rrjedhojë edhe në këtë këndvështrim, duket e bazuar mungesa e ndonjë akti për të verifikuar transaksionin e shumës së huasë.

- 28** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit, për pasurinë *automjet tip “Renault Megane”, me targë {\*\*\*}*, subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën *vetting*, huanë e marrë nga vëllai i tij, sikundër pretendon gjatë hetimit administrativ, si dhe nuk provoi të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni; (ii) nuk arriti të dokumentojë këtë transaksion monetar të pretenduar, duke mbetur në nivel deklarativ, ashtu si dhe në rastin e huasë në shumën 15.000 euro, deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament me sip. 72,1 m<sup>2</sup>, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

**28.1** Kjo pasuri është deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, me vlerë 5.700 euro + 170.040 lekë detyrimi doganor; pjesa takuese: 100%; burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Renault Megane” me targë {\*\*\*}, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë

---

<sup>56</sup> Në vendimin e Komisionit, evidentohet kryerja e një hetimi të plotë dhe shterues, referuar edhe gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, lidhur me mundësitë vëllait të subjektit të rivlerësimit për dhënien e huasë me burime financiare të ligjshme, shih paragrafët 18.12.4 e vijues të vendimit të Komisionit.

<sup>57</sup> Nga verifikimi i sistemit TIMS, Komisionit i ka rezultuar se për vitin 2011, vëllai i subjektit kishte hyrë në Shqipëri, përkatësisht në datat: 3.4.2011, ora 14:38; 24.6.2011, ora 14:41; 19.8.2011, ora 17:52; 25.8.2011, ora 19:46; 18.11.2011, ora 15:14.



07.07.2016, lidhur para noteres A. Gj.<sup>58</sup>. Ndërsa, në DIPP-2015, subjekti deklaroi: (i) blerë automjeti tip “Renault Megane Scenic”, me targë {\*\*\*}, me të ardhurat nga shitja e makinës së vjetër dhe të ardhurat nga paga; vlera: 5.700 euro + 170.040 lekë detyrimi doganor; pjesa takuese: 100%; (ii) shitur automjeti “Renault Megane” me targë {\*\*\*}; vlera 4.000 euro; pjesa takuese: 100%.

**28.2** Për sa nga hetimi administrativ ka rezultuar se kontrata për blerjen e mjetit me targë {\*\*\*}<sup>59</sup>, është nënshkruar prej subjektit në Austri, më datë 04.04.2015, ndërsa kontrata e shitjes së mjetit “Renault Megane” me targë {\*\*\*}, është nënshkruar më datë 07.07.2015, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës: (i) dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën (-) 706.720 lekë për të investuar në pasurinë automjet, si dhe të për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {\*\*\*} nuk mund të kishin shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, pasi mjeti ishte shitur 3 muaj pasi ishte blerë mjeti me targë {\*\*\*}.

**28.3** Në analizë të parashtrimeve dhe dokumentacionit të paraqitur prej subjektit, në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Pretendimet e subjektit lidhur me pagesën e këtij mjeti se më parë është paguar nga vëllai i tij dhe shlyer më pas nga subjekti, nuk mund të merren në konsideratë, për sa kohë shpjegimi i dhënë pas nisjes së rezultateve, nuk është deklaruar në deklaratat periodike, në deklaratën “vetting” apo edhe gjatë hetimit. Për sa më sipër, balanca negative mbetet e pandryshueshme, në shumën 706.720 lekë. Nën këtë logjikë, arsyetimi se çdo pretendim tjetër i subjektit që lidhet me pamundësinë e provueshmërisë me dokumentacion për kryerje pagese nga i vëllai për mjetin etj., nuk vlerësohen për t’u arsyetuar. Në kushte të tilla, balanca negative mbetet e pandryshueshme në shumën 706.720 lekë. [...]*

**28.4** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në seanca, pretendoi që Kolegji të pranonte shumën 4.000 euro si burim të krijimit të pasurisë automjet tip “Renault Megane”, me targë {\*\*\*}, bashkë me shumën 350.000 lekë të tërhequr nga llogaria e bashkëshortes, që përfaqëson çmimin e plotë të blerjes së mjetit, duke parashtruar argumentet si vijojnë.

(i) Në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar se automjetin e ka parë në mënyrë rastësore gjatë qëndrimit në Austri, shumën prej 5.700 eurosh, me të cilën u ble mjeti, nuk e kishte me vete. Kanë rënë dakord që shumën ta paguante vëllai, dhe ai ta shlyente pasi të shiste dhe automjetin me targë {\*\*\*}. Mjeti që është sjellë në Shqipëri më datë 10.05.2015, është paguar nga të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm – 4.000 euro – dhe shuma prej 350.000 lekësh që bashkëshortja ka tërhequr nga llogaria në “Raiffeisen Bank” ShA më datë 15.05.2015. Të vëllait ia ka dhënë shumën e paguar prej tij, në verën e vitit 2015, në një prej ardhjeve të tij në Tiranë.

(ii) Është në pamundësi objektive, sipas parashikimit të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur dokumentacion për pagesën e kryer prej vëllait. Sipas legjislacionit austriak, pas kalimit të një periudhe 7-vjeçare, bankat nuk ruajnë dokumentet financiare, përfshirë dhe “statement”, vërtetuar edhe nga shkresa e “Sparkasse Bank”, në përgjigje të kërkesës së të vëllait.

<sup>58</sup> Gjatë hetimit administrativ, në pyetësin nr. 2, subjekti ka sqaruar se data e saktë e kontratës është 07.07.2015, dhe në plotësimin e deklaratës “vetting” është një lapsus vendosja e vitit 2016 (kontratë nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 07.07.2016).

<sup>59</sup> Pas zhdoganimit më datë 11.05.2015, automjeti ka marrë targën {\*\*\*}.

(iii) Nuk ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare për të blerë mjetin, për rrjedhojë nuk ka qenë në nevojë të injektonte para nga burime të panjohura dhe padeklaruar. Më datë 31.12.2014, bashkëshortja ka pasur të depozituar në bankë shumat prej 714.957 lekësh, 9.602 eurosh, 1.391.761 lekësh, të deklaruar në DIPP-të përkatëse, dhe një pjesë e vlerës së mjetit është paguar nga këto shuma. Si subjekt deklarues, nuk ka pasur detyrimin të deklarojë detyrimet e shlyera brenda vitit kalendarik, pasi lidhur me detyrimet, formulimi i pyetjes në DIPP ka qenë për detyrimet e mbetura në datën 31 dhjetor të vitit paraardhës. Për rrjedhojë, mendon se e shumta kjo duhet trajtuar si pasaktësi në deklaratën *vetting*, pa pasoja, dhe jo si mungesë burimesh financiare.

**28.5** Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me këtë pasuri, i gjeti ato të drejta, dhe prapësimet e subjektit për ekzistencën e një marrëdhënieje huaje të përkohshme mes tij dhe vëllait, që ka shërbyer si burim për pagimin fillestar të vlerës së blerjes së saj, si deklarative dhe të paprovuara. Subjekti i rivlerësimit, në këndvështrim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit të Inspektorit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, duhej të kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* këtë hua si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në mënyrë që të plotësonte detyrimet që vijnë sipas këtyre parashikimeve ligjore. Fakti që në deklaratën periodike të vitit 2015, në të cilin është fituar kjo pasuri, nuk është deklaruar si e tillë, përforcon konkluzionin se ajo nuk provohet të ketë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë automjet. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ajo ka qenë një hua e përkohshme, nuk vlerësohet me peshë në këtë rast, pasi nevoja për deklarimin e saj në deklaratën periodike vjetore vjen për shkak të përcaktimit të saj si burim krijimi i një pasurie në momentin e krijimit dhe jo si deklarimi i detyrimeve financiare. Trupi gjykues sjell në vëmendje se nuk rezultojnë as të dhëna të tjera që të provojnë në mënyrë indirekte ekzistencën e saj, për pasojë, arrihet në konkluzionin se është i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me të.

**28.6** Në vijim të sa më sipër dhe në të njëjtën linjë arsyetimi, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur dokumentacion lidhur me pagesën e bërë nga vëllai për blerjen e mjetit. Përpos që në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit të pasurisë *vetting*, e cila përfshihet në periudhën 7-vjeçare për të cilën bankat në Austri ruajnë dokumentacion financiar e, për rrjedhojë, i vëllai i subjektit nuk ka qenë në pamundësi për të siguruar dokumentacionin bankar e, për pasojë, as subjekti për ta paraqitur atë, konstatohet se subjekti ka pretenduar për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje duke e deklaruar vetëm me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, pra në nevojën e justifikimit të balancës negative të rezultuar lidhur me këtë pasuri.

**28.7** Në këto rrethana, trupi gjykues ia nënshtroi analizës për verifikimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat e dokumentuara të subjektit në momentin e krijimit të saj. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2015 - 04.04.2015, konstatohet se vlera e përlllogaritur për blerjen e automjetit përbëhet nga vlera e shitjes së tij prej 5.750 eurosh + 170.040 lekë pagesë e zhdoganimit. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikuj, rezulton se zhdoganimi i mjetit është kryer më datë 11.05.2015, për rrjedhojë në analizën financiare të kryer deri më datë 04.04.2015 (data e kontratës së blerjes së automjetit), nuk mund të përfshihet vlera e zhdoganimit si shpenzim i kryer jashtë periudhës

në analizë. Lidhur me mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e kësaj pasurie, në ndryshim nga Komisioni, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj analizoi më vete si për pagimin e vlerës së blerjes së automjetit në muajin prill të vitit 2014, ashtu dhe për vlerën e zhdoganimit në muajin maj të vitit 2015. Si pasojë e kësaj analize, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, u reduktua në vlerën prej (-) 575.554 lekësh.

29 Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, duke evidentuar se Komisioni ka hetuar dhe duket se nuk ka konstatuar problematika në drejtim të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi mes subjektit për shkak të funksionit, dhe shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK dhe administratorit A. L., me të cilën ka lidhur kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2011, për apartament me sipërfaqe 71,2 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}” në Tiranë, Komisioneri Publik konstaton se nga të dhënat e akteve të përcjella, duket se subjekti mund të ketë pasur në shqyrtim në vitin 2008, një çështje me shtetasin A. L.. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik vlerëson se mbetet e paqartë situata e konfliktit të interesit të subjektit me këtë shtetas dhe sjell në pah, ndër të tjera, si vijon.

(i) Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti ka deklaruar *se gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së prokurorit, nuk ka hetuar apo gjykuar çështje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe shtetasit I. H. dhe A. L. dhe ka depozituar shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku citohet se: nuk rezulton që ndaj shtetasit A. L. të jenë regjistruar kallëzime apo procedime të hetuara nga prokuror Saimir Hysa, pa numër protokolli dhe datë.*

(ii) Nisur nga fakti që shkresa e sipërcituar nuk ka pasur numër protokolli e datë, Komisioni, me pyetësorin 6, i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacionin e kërkuar për shpjegimet në pyetësorin nr. 2. Në vijim, subjekti ka depozituar shkresën e prokurorisë me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2022, ku citohet: *nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave penale për periudhën kohore 2008-2022, nuk rezulton që ndaj shtetasit A. L. të jenë regjistruar kallëzime apo procedime të hetuara nga prokuror Saimir Hysa. Së bashku me shkresën e sipërcituar, në aktet e përcjella, Komisioneri konstaton se rezulton e administruar edhe një shkresë me shkrim dore që përmban, ndër të tjera, të dhënë: [...] A. L., K. {\*\*\*}, S. Hysa, neni 90, mosfillim dt.15.12.2008, sigluar/nënshkruar dt. 07.04.2023 [...].*

29.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi, prapësoi duke paraqitur aktet që shoqërojnë kallëzimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2008, të pranuar si provë nga Kolegji, dhe parashtrori në mënyrë të përmbledhur si vijon.

(i) Nga verifikimi në Zyrën e Regjistrimit lidhur me kallëzimin nr. {\*\*\*} të vitit 2008, të cituar në ankim, rezulton se ky kallëzim është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në Komisarjatin e Policisë nr. 2 Tiranë, ku shtetasi A. L. ka bërë kallëzim se në datën 19.11.2008, është goditur me grushte në një lokal nga shtetasi E. D. duke pësuar dëmtime fizike. Në datën 21.11.2008, është administruar shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 21.11.2008, sipas së cilës viktima A. L. nuk ishte paraqitur për ekzaminim në Institutin e Mjekësisë Ligjore, Tiranë. Në këto rrethana ka vendosur mosfillimin e procedimit për shkakun se për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, viktima, mbështetur në nenin 59 të K.Pr.Penale, ankimin duhet ta paraqesë drejtpërdrejt në gjykatë.

(ii) Nga krahasimi i gjeneraliteteve të personit që ka bërë kallëzimin nr. {\*\*\*}/2008 dhe të shtetasit A. L., me të cilin kam nënshkruar kontratën e blerjes së apartamentit si administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në vitin 2011, rezulton se bëhet fjalë për të njëjtin person.

(iii) Në momentin që ka marrë vendimin e mosfillimit, nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit pasi nuk kishte asnjë njohje me shtetasin A. L., por edhe në nënshkrimin e kontratës së blerjes të apartamentit nuk ka qenë në dijeni të kësaj rrethane, që nuk përbën konflikt interesi në asnjë komponent të saj apo trajtim preferencial për shkak të funksionit të tij si prokuror pasi:

- Në kallëzimin nr. {\*\*\*}/2008, shtetasi A. L. nuk ka pasur cilësinë e autorit të veprës penale, por të viktimës, dhe vendimmarrja për mosfillimin e procedimit ka qenë formale, duke evidentuar faktin se ndodhemi para rasteve të parashikuara nga legjislacioni penal.
- Referuar rezultateve të hetimit, në blerjen e banesës nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka pasur asnjë trajtim preferencial ndaj tij, përkundrazi, është konstatuar se banesa është blerë me një çmim dukshëm më të lartë se çmimet referuese të përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave” për vitin 2011. Në total, ka paguar një shumë prej 1.754.720 lekësh mbi çmimin e referencës.

(iv) Shënimi që citon Komisioneri Publik është i punonjësve të administratës në kërkesën e tij për pajisje me vërtetim dhe që është dorëzuar dorazi prej tij në Komision, “pakujdesi” që tregon se nuk ka pasur asnjë veprim në drejtim të fshehjes së këtij fakti apo paraqitjes së të dhënave të rreme.

**29.2** Në seancën e datës 23.09.2024, referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 16.09.2024, si dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij, Komisioneri Publik vlerësoi se marrëdhënia e shitblerjes, e cila është nënshkruar në vitin 2011, në dukje nuk rezultoi të ketë rrethana për t’u trajtuar në kuptim të ekzistencës së kushteve për të pasur një trajtim preferencial sipas ligjit, apo për t’u arsyetuar më tej mbi çështjen e konfliktit të interesit.

**29.3** Në referim të vlerësimit të Komisionerit Publik, si edhe të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur për t’i mbështetur ato, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk rezulton asnjë fakt apo rrethanë lidhur me ndonjë konfliktit të mundshëm interesi mes tij dhe administratorit të shoqërisë ndërtuese. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkak për të vijuar me analizën në drejtim të konfliktit të interesit.

**30** Në përfundim, në analizë të konstatimeve të mësipërme që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk ekzistojnë problematika që do të çonin në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, duke mbajtur në konsideratë balancat negative modeste të rezultuara dhe rrethanat specifike që i kanë shkaktuar ato. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit që subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në krijimin e pasurisë, në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, ai nuk gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji, është i drejtë.

**31** Në përmbledhje të sa më sipër, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi nëse në tërësi subjekti do të mund të konsiderohej se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë për shkak të problematikave të konstatuara në kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale edhe atyre të vlerësimit të pasurisë. Në këtë kuadër, trupi gjykues konsideroi se e vetmja çështje që mund të ngrinte problematika të kësaj natyre, ishte mënyra se si subjekti ka trajtuar kallëzimin penal nr. {\*\*\*}/2022, i analizuar më lart. Ky procedim më vete, i shqyrtuar krahas një balance negative për pasurinë, në total prej (-) 781.857 lekësh, në zbatim të parimeve

të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk do të ishin të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 32 Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 693, datë 10.08.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa, është i bazuar dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 693, datë 10.08.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 25.09.2024, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*